



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 13

Tiranë – E martë, 24 janar 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 892, datë 27.12.2022	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, planit të veprimit dhe të pasaportës së indikatorëve..... 1719
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 289, datë 29.12.2022	Për një ndryshim në urdhrin nr. 99, datë 25.5.2021, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale”..... 1819
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 291, datë 30.12.2022	Për shpalljen e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 15, “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike” (SKK 15)..... 1820
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 13, datë 19.1.2023	Për delegim kompetencash..... 1821
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 22.12.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-288(64), datë 21.2.2022, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 1821
Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 1, datë 18.1.2023	Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve për ruajtje të përherëshme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre..... 1829
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare..... 1835
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 2, datë 10.1.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, në Povelçë, Bashkia Fier..... 1835

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 3, datë 10.1.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në Povelçë, Bashkia Fier	1837
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 5, datë 16.1.2023	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	1838
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 6, datë 16.1.2023	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 417, seria T18, së shoqërisë “Renrgy Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1840
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 7, datë 16.1.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, të ndryshuar.....	1841
	Korrigjim gabimi material në ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45/2015, ‘Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë’, të ndryshuar”, botuar në Fletore Zyrtare nr. 154, datë 17.11.2022.....	1842



VENDIM
Nr. 892, datë 27.12.2022

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË
PËR TË MITUR 2022–2026, PLANIT TË
VEPRIMIT DHE TË PASAPORTËS SË
INDIKATORËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, të planit të saj të

veprimit dhe të pasaportës së indikatorëve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse të përcaktuara në strategjinë dhe në planin e veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË PËR TË MITUR
(2022–2026)
Nëntor 2022

PËRMBAJTJA

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË PËR TË MITUR (2022–2026)
SHKURTIME

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik
2. Kuadri ligjor dhe institucional dhe lidhja me dokumentet strategjike të tjera
3. Arritjet, analiza dhe sfidat
4. Parimet themelore
5. Vizioni dhe misioni i dokumentit

**PJESA II. QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PARËSORE
TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022–2026**

Qëllimet e politikës së SDM 2022–2026

**PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA,
RAPORTIMI DHE MONITORIMI**

1. Përgjegjësia e institucioneve
2. Zbatimi, llogaridhënia dhe koordinimi
3. Sistemi i monitorimit dhe raportimit të “SDM 2022–2026”

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE



SHKURTIME

AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore
AP	Avokati i Popullit
AS	Akademia e Sigurisë
ASCA	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DM	Drejtësia për të Mitur
DNJF	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
DHASH	Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
GREVIO	Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Masat kundër Dhunës nda Grave dhe Dhunës në Familje
GRETA	Grupi i Ekspertëve mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
INSTAT	Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë
IDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
KiE	Këshilli i Evropës
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MB	Ministria e Brendshme



MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHRF	Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
M&V	Monitorim dhe Vlerësim
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
NJQV	Njësitë e qeverisjes vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
PKE	Plani Kombëtar të Integrimit Evropian
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PR	Parlamenti Rinor
PSHSDPM	Programi Shqiptar – Suedez i Drejtësisë Penale për të Mitur
SDM 2018–2021	Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018–2021
SDM 2022–2026	Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2022–2026
SIDhDPM	Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur
PV	Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
RSH	Republika e Shqipërisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SKZHIE III	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021–2030
SthCh	Save the Children
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TdH	Terre des homes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UP	Urdhri i Psikologut
UPS	Urdhri i Punonjësit Social
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar



PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Dokumenti strategjik “Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë”¹ dhe Planin i Veprimit i hartuar nga Komisioni i Posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë penale (2015) kishte si objektiv strategjik reformimin e sistemit të drejtësisë penale për të miturit (objektivi nr. 8) dhe përmirësimin e pozitës së viktimës në procesin penal (objektivi nr. 7).

Reformimi i drejtësisë penale për të mitur filloi me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe Planin e saj të Veprimit 2018–2021.

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 dhe Planin e saj i Veprimit është strategjia e dytë në fushën e drejtësisë për të mitur. Ajo u përgatit në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë² nga Ministria e Drejtësisë përmes një procesi të koordinuar dhe konsultimi të gjerë me ministritë e tjera përgjegjëse, organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, profesionistët e profesioneve të lira, përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile, partnerë ndërkombëtarë, si dhe studente e profesionistë të botës akademike të cilët punojnë me dhe për fëmijët, si dhe me Parlamentin Rinor.

“SDM 2018–2021” synonte krijimin e kuadrit ligjor dhe institucional të drejtësisë penale për fëmijët, hedhjen e bazës së aksesit në drejtësinë penale për të miturit, fillimin e trajnimit të profesionistëve në çështjet e drejtësisë penale për fëmijët; krijoi modelet e grupeve të profesionistëve për menaxhimin e rasteve në nivel vendor. Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) u krijua dhe funksionon.

“SDM 2022–2026”³ synon që në rezultatet e strategjisë së mëparshme, që tashmë ka përfunduar, të forcojë dhe të konsolidojë arritjet në fushën e

drejtësisë penale për të mitur, aksesin në drejtësinë penale për të miturit, me qëllim për t'i mbajtur ata larg nga ripërfshirja në kriminalitet dhe viktimizimin e tyre, që çdo fëmijë të ketë në çdo kohë akses te një sistem miqësor për të rivendosur të drejtat e tij/e saj të cenuara në fushën familjare, civile, administrative dhe penale.

“SDM 2022–2026” synon të adresojë problemet me të cilat përballen të miturit që përfshihen në kryerjen e një veprë penale, mes konsolidimit të një sistemi të drejtësisë penale që ka përparësi shmangien e privimit të lirisë së tyre, kur një gjë e tillë është e mundur; adreson faktorët kriminogjenë përmes ndërhyrjes së hershme për parandalimin parësor të përfshirjes së fëmijëve në kriminalitet dhe të veprave penale të kryera ndaj tyre, së pari mes informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të fëmijëve, prindërve, shoqërisë për nevojën e mbrojtjes së fëmijëve nga përfshirja në kryerjen e veprave penale ose nga viktimizimi prej tyre dhe së dyti mes zbatimit të programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit në rastet kur fëmijët përfshihen në konflikte ose vepra penale.

Sikurse në strategjinë e mëparshme, “SDM 2022–2026” synon mbajtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin jashtë proceseve penale dhe procedimeve gjyqësore, duke konsoliduar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale ose procedimi gjyqësor, mes zbatimit të programeve restauruese e ndërmjetësuese, këshillimit, mbikëqyrjes së fëmijës në rastet kur familja ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk mund ta ushtrojë këtë mbikëqyrje, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijës. Në rastet, kur mbikëqyrja e fëmijës është e nevojshme, theksi vihet te programet rehabilituese dhe riintegruese të të miturit, shërbimet psikosociale, juridike për fëmijët nën mbikëqyrje dhe kujdesi që duhet të tregohet për përgatitjen e të miturit për rikthimin në familje dhe në shoqëri dhe mbikëqyrjen e tij për riintegrimin në shoqëri.

“SDM 2022–2026”, në krahasim me strategjinë e mëparshme zgjeron objektivat e saj edhe në qasjen e çdo fëmije në një drejtësi miqësore në proceset civile, familjare dhe administrative. Arsyeja është se numri i fëmijëve që marrin pjesë në proceset gjyqësore të tjera, sidomos civile dhe familjare ose kur ka vendimmarrje që ndikojnë drejtpërdrejtë te fëmijët, është i lartë dhe se të drejtat e tyre cenohen shpesh.

¹ <https://rm.coe.int/strategjia-ne-refomen-e-sistemit-te-drejtësisë/16809eb53a>.

² https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverisës_2021–2025.pdf

³ Në këtë Strategji dhe Planin e saj të Veprimit termat “i/e mitur” dhe “fëmijë” janë përdorur si sinonime ekuivalente të njëri-tjetrit dhe nënkuptojnë individin që nuk ka mbushur ende moshën 18 vjeç.



Masat e parashikuara në “SDM 2022–2026” synojnë një drejtësi që udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në çdo veprim apo vendimarrje që ka të bëjë me fëmijën ose që ndikon te fëmija, në çdo fazë të proceseve civile, familjare, administrative dhe penale.

“SDM 2022–2026” adreson përparësitë e Qeverisë Shqiptare të mishëruara edhe në “Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026”. Ajo ka lidhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021–2030, me Programin Qeverisës 2021–2025 dhe një sërë strategjish të tjera që adresojnë të drejtat e grupeve të veçanta të fëmijëve, si: Strategjia Ndërsëktoriale e Drejtësisë 2021–2025, Strategjia e Edukimit Ligjor të Publikut 2019–2023, Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Terrorizmit dhe Planit të Veprimit 2021–2025, Strategjia Kombëtare për Barazë Gjimore 2021–2030, Strategjia Kombëtare për Migracionin 2019–2022, Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2020–2025, Plani Kombëtar i Veprimit për Barazë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, Plani Kombëtar për Personat LGBTI 2021–2027. “SDM 2022–2026” mban parasysh përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm 2030 (OZHQ)⁴ dhe Agjendën 2030.⁵

Përgatitja e “SDM 2022–2026” është planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2022 dhe është në përmbushje të angazhimeve të marra në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKE) 2021–2023, kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, konkretisht 23.7 ku si prioritetet janë: ngritja e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (e ngritur tashmë), ngritja e Institucionit të Kufizimit të Lirisë, si dhe Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale; forcimi i mëtejshëm i mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtja e viktimave të dhunës në familje, promovimi i të drejtave për personat me aftësi ndryshe, garantimi i barazisë gjimore dhe sigurimi i shërbimeve minimale sociale dhe shëndetësore, sidomos në nivel lokal; ngritja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetet e planifikuara duke synuar shtrirjen e

shërbimit të ndihmës juridike parësore në të gjithë territorin e vendit⁶, si dhe është në linjë me Marrëveshjen e Stabilizimit-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre anëtare (MSA), neni 2 “Respektimi për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut” dhe neni 78 “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”.

Në hartimin e “SDM 2022–2026” janë mbajtur parasysh gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian të dërguara nëpërmjet “Raportit për Shqipërinë 2022”⁷, rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, Strategjia e BE-së për Drejtësinë për të Mitur, rekomandimet e Këshillit të Evropës për një drejtësi miqësore për fëmijët⁸, rekomandimet e mekanizmave monitorues të konventave të OKB-së dhe Këshillit të Evropës ku shteti shqiptar është palë, veçanërisht të GREVIO-s⁹, GRETA-s¹⁰, CPT¹¹, direktivat e BE-së për një drejtësi miqësore për fëmijët dhe mbrojtjen e viktimave¹², si dhe rekomandimet e partnerëve vendës dhe ndërkombëtarë që punojnë me dhe për fëmijët¹³.

“SDM 2022–2026” u bazua në gjetjet dhe rekomandimet e analizës së zbatimit të “SDM 2018–2021”¹⁴.

Dokumenti strategjik dhe Plani i Veprimit i “SDM 2022–2026” vë theksin në aksesin në çdo kohë dhe për çdo fëmijë në një sistem drejtësie miqësore për ta dhe ku çdo veprim dhe vendimarrje synohet të udhëhiqet nga interesi më i lartë i fëmijës.

2. Kuadri ligjor dhe institucional dhe lidhja me dokumentet strategjike të tjera

2.1. Kuadri ligjor kombëtar

Legjislacioni shqiptar bazohet në parimet e drejtësisë miqësore për fëmijët, e cila ka në thelb të saj garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjitha të drejtave të fëmijëve, në

⁶ <https://www.drejtesia.gov.al/per-miratimin-e-planit-kombetar-per-integrimin-evropian-2021-2023/>

⁷ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

⁸ <https://rm.coe.int/16804b2cf3>

⁹ <https://rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al/2018/01/14/pjese-nga-raporti-fillestar-i-vleresimit-i-grevio-s/>

¹⁰ <https://rm.coe.int/greta-2020-09-fgr-alb-en/1680a0b84f>

¹¹ <https://rm.coe.int/168097986b>

¹² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32012L0029&from=EN>

¹³ https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/rights-child/child-friendly-justice_en

¹⁴ <https://drejtesia.gov.al/baza-ligjore-2/>

⁴ <https://sdgs.un.org/goals>

⁵ <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>



nivelin më maksimal të mundshëm. Kuadri ligjor vendës synon të garantojë elementët e domosdoshëm të drejtësisë miqësore, të tillë si: aksesueshmëria, përshtatshmëria, efektiviteti në raport të drejtë me nevojat dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Parime të tilla si pjesëmarrja dhe informimi, interesi më i lartë i fëmijës, dinjiteti, mbrojtja nga diskriminimi, shteti i së drejtës, qëndrojnë në themel të kuadrit ligjor shqiptar. Drejtësia miqësore përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit. Gjithashtu *“interesi më i lartë i fëmijës”* paraqitet si një parim me shtrirje kapilare në gjithë legjislacionin tonë të brendshëm. Kuadri ligjor i drejtësisë për të mitur i është përmbajtur instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara dhe është zhvilluar në përputhje me standardet e Konventës së OKB-së *“Për të drejtat e fëmijës”*, ato të BE-së dhe të Këshillit të Evropës.

“SDM 2022–2026” është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, dhe me konventat ndërkombëtare, si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;
- Ligji nr. 7510, datë 8.8.1991 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”;
- Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)”;
- Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993 “Për aderimin në Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”;
- Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut” dhe Protokollin nr. 7 i KEDNJ-së;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji nr. 8624, datë 15.6.2000 “Për aderimin në Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”;
- Ligji nr. 8774, datë 23.4.2001 “Për ratifikimin e Konventës nr. 182 ‘Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999’ të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”;
- Ligji nr. 9265, datë 29.7.2004 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane ‘Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”;

- Ligji nr. 9359, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane ‘Për marrëdhëniet me fëmijët”;

- Ligji nr. 9443, datë 16.11.2005 “Për aderimin e RSH-së në Konventën ‘Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”;

- Ligji nr. 9446, datë 24.11.2005 “Për aderimin e RSH-së në Konventën ‘Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”;

- Ligji nr. 9833, datë 22.11.2007 “Për aderimin e RSH-së në protokollin opsional të Konventës së OKB-së ‘Për të drejtat e fëmijëve’ për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”;

- Ligji nr. 9864, datë 22.11.2007 “Për aderimin e RSH-së në protokollin opsional të Konventës së OKB-së ‘Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe, pornografinë me fëmijë”;

- Ligji nr. 10 071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”;

- Ligji nr. 10 424, datë 2.6.2011 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”;

- Ligji nr. 10398, datë 17/3/2011 “Për ratifikimin e Konventës për njohjen dhe zbatimin e detyrimeve ushqimore”;

- Ligji nr. 10 425, datë 2/6/2011 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;

- Ligji nr. 63/2012 “Për ratifikimin e Konventës së Hagës ‘Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”.

- Ligji nr. 10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.

Lidhja e SDM-së me kuadrin ligjor kombëtar

“SDM 2022–2026” lidhet me kuadrin ligjor në fuqi që normon të drejtat e fëmijëve. Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe nënligjor thuajse të plotë e të qartë.

Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” (KDPM) ka sjellë një qasje të re në sistemin e drejtësisë penale duke vënë në qendër të miturin, duke forcuar sistemin e drejtësisë në përputhje me parimet e KKBDF-në dhe me



standardet dhe normat ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin, mbështetur në interesin e tyre më të lartë. Ligji garanton një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, promovon riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon riviktimizimin e fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një veprë penale ose viktimizimin dytësor të shkakuar si pasojë e pjesëmarrjes në proceset e drejtësisë. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018, i cili rregullon mënyrën e trajtimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për mbështetjen e fëmijëve dëshmitarë, viktimë apo të akuzuar në procesin penal, si dhe në trajtimin dhe mbrojtjen e të miturve. Ligji përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grupmosha 18–21 vjeç. Ky ligj me kaq shumë risi ka zhvilluar standardet e legjislacionit shqiptar dhe të praktikës së sistemit të drejtësisë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në tërësi dhe të të miturve në konflikt me ligjin në veçanti duke vendosur fëmijën në qendër të vëmendjes dhe garantuar standardet e drejtësisë miqësore dhe të interesit më të lartë të fëmijës. Kodi është një ligj i veçantë për shkak të përmbajtjes së tij, pasi përmbledh të gjitha dispozitat që referojnë të miturin në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe ligje të tjera referuese të sistemit të drejtësisë penale për të mitur. Ky Kod siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/93/BE, datë 13.12.2011, përveç përputhjes me standardet ndërkombëtare dhe rajonale.¹⁵

Në zbatim të plotë të këtij KDPM-je janë parashikuar një seri masash në “SDM 2022–2026” duke mundësuar forcimin e parandalimit parësor, dytësor dhe tretësor të kriminalitetit të të miturve, garantimin e aksesit në drejtësi, bashkëpunimin e

vazhdueshëm të organeve të sistemit të drejtësisë që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, jo vetëm në parandalimin e veprave penale, por edhe në përcaktimin e masave restauruese të përshtatshme për të miturit në konflikt me ligjin, si dhe për rehabilitimin e tyre; informim dhe edukim ligjor; garantimin e respektit dhe efektshmërinë në zbatimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet drejtësisë miqësore; respektimin e jetës private dhe familjare, bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërinstitucional për trajtimin e rasteve etj.

Në zbatim të KDPM-së janë hartuar 7 (shtatë) vendime të Këshillit të Ministrave, 2 (dy) udhëzime dhe 7 (shtatë) urdhra ministri:

1. Vendimi nr. 148, datë 20.3.2019 i Këshillit të Ministrave “Për procedurën që zbaton shërbimi i provës në rast të mospërmbushjes së masës alternative të shmangies nga ndjekja penale”;

2. Vendimi nr. 149, datë 20.3.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit të aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësien e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”;

3. Vendim nr. 655, datë 10.10.2022 “Për disa shtesa në vendimin nr. 149, datë 20.3.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit të aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësien e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”;

4. Vendimi nr. 207, datë 10.4.2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”;

5. Vendimi nr. 233, datë 17.4.2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve, të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit e të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve”;

6. Vendimi nr. 314, datë 15.5.2019 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”;

7. Vendimi nr. 314, datë 15.5.2019 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin, si dhe

¹⁵ Direktiva 2011/93 EU, datë 13.12.2011, Fletore Zyrtare nr. 335, datë 17.12.2011, si dhe standardet dhe rregullat për drejtësinë për të mitur në nivelin e OKB-së dhe Këshillit të Evropës.



përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, ndryshuar me VKM nr. 656, datë 10.10.2022;

Në zbatim të KDPM-së janë hartuar 2 (dy) udhëzime:

1. Udhëzim nr. 7640, datë 5.7.2018 i ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e formës dhe rregullave të përgatitjes së dokumentit për lirimin me kusht të të miturit të dënuar”;

2. Udhëzim i përbashkët nr. 650, datë 13.9.2019 i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal”;

Gjithashtu, në zbatim të KDPM-së janë hartuar 6 (gjashtë) urdhra të ministrit të drejtësisë dhe një urdhër i përbashkët i ministrit të drejtësisë dhe ministrit të arsimit dhe sportit (MAS) si më poshtë vijon:

1. Urdhër nr. 4950, datë 2.5.2018 i ministrit të drejtësisë “Për përcaktimin e formës së regjistrimit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, “paralajmërim me gojë”;

2. Urdhër nr. 4951, datë 2.5.2018 i ministrit të drejtësisë “Për miratimin e formatit dhe të dhënave për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale, “paralajmërim me shkrim”;

3. Urdhër nr. 7639, datë 5.7.2018 i ministrit të drejtësisë “Për miratimin e rregullave të detajuara për përdorimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës”;

4. Urdhër nr. 7641, datë 5.7.2018 i ministrit të drejtësisë “Për përcaktimin e elementëve të marrëveshjes për zbatimin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin”;

5. Urdhër nr. 367, datë 15.7.2019 i ministrit të drejtësisë “Për miratimin e formatit të planit individual për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”;

7. Urdhër nr. 368, datë 15.7.2019 i ministrit të drejtësisë “Për miratimin e formatit të raportit për mospërmbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturve në konflikt me ligjin”;

7. Urdhër i përbashkët nr. 3348/1, datë 18.4.2018 i ministrit të drejtësisë dhe ministrit të arsimit, sportit dhe rinisë “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”.

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, garanton ndihmë juridike falas parësore dhe dytësore për kategori të veçanta si: viktime të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore, të mitur/mitura në konflikt me ligjin, fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim etj.

Të tjera ligje me rëndësi janë:

1. Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

2. Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar. Për t’u nënvizuar se ndryshimet (ligji 35/2017 dhe jo vetëm) janë në koherencë me KDF-në dhe me standarde dhe norma të tjera ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me ligjin mbështetur në interesin e tyre më të lartë;

3. Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar;

4. Ligji nr. 9062 datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, i ndryshuar;

5. Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;

6. Ligji nr. 62/2022 “Për regjistrin kombëtar të të dënuarve për krime seksuale”;

7. Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;

8. Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

9. Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

10. Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

11. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;



12. Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

13. Ligji nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë”;

14. Ligji nr. 40/2016 “Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”;

15. Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;

16. Ligji nr. 9695 datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar.

17. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

18. Ligji nr. 129/2021 “Për statusin fëmijë në përkujdesje të republikës”.

2.2 Kuadri institucional

Në Shqipëri ka disa struktura që trajtojnë çështjet e të drejtave të fëmijëve dhe fëmijët në kontakt ose në konflikt me ligjin dhe pjesëmarrës në proceset gjyqësore.

Ligj nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, MD ka në kompetencë të saj, të ndjekë dhe të përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë. Në këtë kontekst, struktura përgjegjëse për hartimin e politikave për sistemin e drejtësisë, në MD, është Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë. Ky ligj përcakton në fushën e përgjegjësisë së MD mbështetjen për realizimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme në fushën përkatëse (neni 6, paragrafi 20).¹⁶

Me urdhrin nr. 94, datë 3.6.2022 të Kryeministrit është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës, për hartimin e “SDM 2022–2026”, planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve. Grupi Ndërinstitucional i Punës, gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të tij, është mbështetur nga Sekretariati Teknik, që është pjesë e Drejtorisë së

Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë në MD.

Komiteti Drejtues Sektorial, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, vepron në përputhje me urdhrin nr. 157 datë 22.10.2018 të Kryeministrit “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ ndërsektoriale dhe krijimin dhe funksionimin e një mekanizmi të integruar sektorial/ndërsektorial”. Komiteti Drejtues Sektorial, me anë të Rrjetit Ndërinstitucional në nivel qendror për çështjet fëmijëve, do të ushtrojë funksionin e tij, për çështjet lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit efektiv të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, Planit të Veprimit 2022–2026 dhe Pasaportës së Treguesve.

Institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë dhe institucionet shtetërore në nivel qendror, si dhe institucionet e varësisë së MD, bashkëpunojnë me MD që mbulon sistemin e drejtësisë për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës lidhur me realizimin e objektivave specifike, masave dhe aktiviteteteve strategjike në kuadër të “SDM 2022–2026”.

Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018 krijon struktura të specializuara për drejtësinë penale për të mitur. Bazuar në këtë ligj është krijuar dhe funksion Qendra për Parandalimin e Kriminalitetit të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), institucion në varësi të MD-së.

Duke qenë se të drejtat e fëmijëve adresohen në ligj të ndryshme dhe disa shërbime për fëmijët jepen nga institucione që janë në varësi të ministrive të tjera, sipas ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i miratuar më datë 23.2.2017, ministri është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Sipas ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organ këshillimor që ngrihet me urdher të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Sipas ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatit e Popullit”, janë krijuar seksione të specializuara dhe një prej tyre është Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Në Kuvendin e Shqipërisë, bazuar në Rezolutën e Kuvendit “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të

¹⁶ https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Ligj_8678_14052001_perditesu_ar_2017.pdf.



*fëmijëve në Shqipëri*¹⁷, miratuar në 2013, u ngrit dhe funksionin Grupi Parlamentar “Miq të Fëmijëve” i cili do të funksionojnë si një grup parlamentar vullnetar në Kuvendin e Shqipërisë. Ky grup mund të propozojë e të mbështesë nisma legislative të reja, të promovojë instrumente që kanë të bëjnë me parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj fëmijëve, përmirësimin e shërbimeve ekzistuese dhe shtimit të shërbimeve të reja për fëmijët, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. GPMF-ja është një mekanizëm shumë i mirë i mbështetjes, konsultimit dhe propozimit të nismave legislative që nxisin mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; ai duhet të udhëheqë procesin e përgatitjes së ligjeve të reja, ushtrimin të kontrollit parlamentar për punën që bëjnë institucionet për të zbatuar ligjet dhe mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës dhe t’i kërkojë Kuvendit të ndërmarrë masat e nevojshme për të rritur mirëqenien e fëmijëve në Shqipëri.

Një sërë institucionesh shtetërore në nivel qendror dhe vendor, bashkëpunojnë me ministrinë përkatëse që mbulon çështjet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës për të shkëmbyer informacion dhe për të lehtësuar përbushjen e funksionit të tij.

2.3 Lidhja e “SDM 2022–2026” me dokumentet strategjike

2.3.1 Lidhja e “SDM 2022–2026” me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021–2030 (SKZHIE)

“SDM 2022–2026” është e lidhur dhe e harmonizuar me qëllimet dhe objektivat e *Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021–2030* (SKZHIE III) dhe është mbështetur në shtyllën kryesore të sistemit të drejtësisë “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë”. “SDM 2022–2026” udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe parimi i një drejtësie miqësore për çdo fëmijë në kontakt/konflikt me ligjin dhe fëmijët që marrin pjesë në proceset civile, familjare, administrative. Në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik janë adresuar parimet themelore mbi të cilat udhëhiqet *Strategjia e BE “Për të Drejtat e Fëmijëve” (2021–2024)*¹⁷; *Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2022–2027)*¹⁸ dhe *Strategjia e Mbrojtjes së Fëmijës e*

*UNICEF (2021–2030) dhe Plani Strategjik 2022–2025*¹⁹.

Duke qenë se Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021–2030 (SKZHIE III) është një strategji ombrellë dhe përfshin strategjitë e tjera në nivel kombëtar, te nënfusha “Forcimi i të Drejtave të Njeriut”, parashikohet “SDM 2022–2026” e cila ka në fokus konsolidimin e mëtejshëm të reformës në drejtësi për të mitur. Thelbin e kësaj reforme e përbën drejtësia miqësore për fëmijët që adreson gjithë hallkat e sistemit të drejtësisë drejt qeverisjes prej parimeve themelore të të drejtave të fëmijëve. Mbi këto parime mbështeten dhe udhëhiqen edhe Strategjia e BE-së, e Këshillit të Evropës dhe UNICEF-it, të cituara më sipër.

2.3.2 Lidhja me Programin e Qeverisë

“SDM 2022–2026” lidhet me Programin Qeverisës 2021–2025, kryesisht me prioritetin “Shqipëria e së drejtës”.

2.3.3 Lidhja e “SDM 2022–2026” me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025

*Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 dhe Plani i saj i Veprimt*²⁰ përmban 4 (katër) qëllime politike për sistemin e drejtësisë. Qëllimi politik 3 i këtij dokumenti parashikon një sistem drejtësie penale që udhëhiqet nga parimet themelore të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe që garanton risocializimin, riintegrimin, rehabilitimin dhe parandalimin e veprave penale. Në funksion të këtij qëllimi politik, objektivi specifik 3.3, synon të përmirësojë drejtësinë për të mitur, me një qasje për një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të lartë të tyre. Ky objektivi specifik lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe me nenin 78 të *Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre*

child/1680a5ef27#:~:text=The%20Strategy%20for%20the%20Rights,at%20the%20same%20time%2C%20finding.

¹⁹ <https://www.unicef.org/documents/child-protection-strategy> dhe

<https://www.unicef.org/reports/unicef-strategic-plan-2022-2025>.

²⁰ Miratuar me vendimin nr. 823, datë 24.12.2021 të Këshillit të Ministrave. Shih:

<https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/02/Draft-Strategjia-Nd%C3%ABrsektoriale-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-2021-2025-p%C3%ABr-konsultim.pdf>.

¹⁷ https://ec.europa.eu/info/laeb/better-regulation/have-your-say/initiatives/12454-EU-strategy-on-the-rights-of-the-child-2021-24_en.

¹⁸ <https://rm.coe.int/council-of-europe-strategy-for-the-rights-of-the-child-2022-2027->



anëtare, “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”.

Duke mbetur brenda kornizave ligjore e institucionale të sistemit të drejtësisë miqësore për të mitur, “SDM 2022–2026” synon të garantojë një kuadër ligjor e institucional me dhe për fëmijët, të fuqizojë kapacitetet e profesionistëve të drejtësisë, të promovojë qasjen në çdo kohë të drejtësia miqësore për çdo fëmijë dhe të parandalojë përfshirjen/ripërfshirjen e fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërim, riintegrim të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

2.3.4 Lidhja e “SDM 2022–2026” me Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve

*Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve*²¹ është miratuar me vendimin nr. 659, datë 3.11.2021 të Këshillit të Ministrave. Ajo përbën një tjetër dokument strategjik të qeverisë shqiptare që adreson arritjet dhe sfidat në funksion të përmbushjes së të drejtave të fëmijëve, për periudhën kohore 2021–2026.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, citon se në kuadër të primeve të drejtësisë miqësore për fëmijët, është bërë “Përmirësim i legjislacionit penal, civil dhe administrativ në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve dhe është miratuar Strategjia e Drejtësisë për të Miturit e shoqëruar me Planin e Veprimit 2018–2021”. Sipas Agjendës, kjo strategji, përbën dokumentin e parë të politikave të qeverisë shqiptare që përcakton shtyllat bazë të reformës së drejtësisë për të mitur.

Përmes Agjendës janë parashikuar masat të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e fenomenit të martesës së hershme.

2.3.5. Lidhja e “SDM 2022–2026” me Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKE)

“SDM 2022–2026” lidhet me dy kapituj kryesorë të PKE 2022–2024, konkretisht me kriterin politik “Demokracia dhe Shteti i së Drejtës” “Të drejtat e njeriut” dhe me kapitullin 23: “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” ku parashikohen tre shtyllat kryesore për reformat e drejtësisë në këtë kapitull të cilat janë: 1) Sistemi

Gjyqësor; 2) Lufta kundër Korrupsionit; 3) Përmirësimi dhe Mbrojtja e të Drejtave dhe Lirive Themelore “Të drejtat e fëmijëve”.

2.3.6 Lidhja e “SDM 2022–2026” me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA)

“SDM 2022–2026” lidhet me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”, me përkatësisht me nenet respektiv: me nenin 2 i të MSA-së “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, respekti për parimet e së drejtëndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu “SDM 2022–2026” lidhet me nenin 78 “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës” të MSA-së, “Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme me palët i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe imponimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në përmirësimin e efikasitetit të tij, në përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera ligjzbatuese duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

“SDM 2022–2026” lidhet edhe me nenin 88 “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, “Bashkëpunimi midis palëve përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e statistikave. Ai synon veçanërisht zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna të krahueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Shqipëri. Ky sistem duhet gjithashtu të mundësojë

²¹ Miratuar me vendimin nr. 659, datë 3.11.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021–2026”. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Agjenda-Kombetare-per-te-Drejtat-e-Femijeve.docx>



Instituti Shqiptar të Statistikës për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve vendës dhe ndërkombëtarë (si të administratës publike ashtu dhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga OKB-ja dhe Kodi Statistikor Evropian i Praktikës dhe parashikimet e së drejtës Statistike Evropiane, dhe duhet të zhvillohet drejt acquis-së së Komunitetit”.

2.3.7 Lidhja e “SDM 2022–2026” me dokumentet e tjera strategjike kombëtare:

“SDM 2022–2026” lidhet me *Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut 2019–2023*, konkretisht me objektivin specifik 4.1 “Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike”; Objektivi specifik 4.2 “Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik”; me objektivin specifik 4.4 “Garantimi i informacionit ligjor në kohë reale dhe sa më pranë komunitetit” Objektivin specifik 4.5 “Nxitja e aktivizimit të publikut përmes informimit mbi përgjegjësitë e institucioneve dhe mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje”; me objektivin specifik 4.7 “Përmirësimi i programit të edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar dhe pasurimi i kurrikulave e aktiviteteve ekstra kurrikulare me elemente të edukimit ligjor”.

“SDM 2022–2026” lidhet me *Strategjinë Kombëtare për Barazi Gjinore 2021–2030*, konkretisht me politikën III “Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”.

“SDM 2022–2026” lidhet me *Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2019–2022*; konkretisht me objektivin B2.1 “Kthimi i suksesshëm i shtetasve të huaj në vendet e tyre të origjinës përmes ripranimit dhe kthimit vullnetar, ndër të cilat parashikohet që të zhvillohen procedura standarde të qarta për kthimin vullnetar të asistuar përfshirë për kategoritë vulnerabel si të miturit e pashoqëruar dhe rolin e çdo partneri të përfshirë” dhe me objektivin B3.2 “Mbështetja për kthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të ripranuar” sipas të cilit parashikohet të krijohet një mekanizëm i dedikuar për bashkëpunim ndërmjet Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit/ Ministria e Brendshme dhe

bashkive për ofrimin e asistencës për të miturit shqiptarë të pashoqëruar, të ripranuar”.

“SDM 2022–2026” lidhet me *Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planin e Veprimit 2020–2025*, konkretisht me Qëllimim e politikës 3 “Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht brezin e ri të aftë për të përfituar nga përparësitë e teknologjisë së informacionit dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit”.

“SDM 2022–2026” lidhet me *Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025*, konkretisht me objektivin I.1 “Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të Minoritetit Romë dhe Egjiptian me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile”; me objektivin 1.3 “Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi/shfrytëzimi, si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/shfrytëzuara” dhe objektivin VI.4 “Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi/shfrytëzimi, si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/shfrytëzuara”.

“SDM 2022–2026” lidhet me *Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025*, me qëllimin e politikës 2 “Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara”.

“SDM 2022–2026 lidhet me *Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Terrorizmit dhe Planin të Veprimit 2021–2025*, konkretisht me qëllimin e politikës 3 “Kuptimi i kërcenimeve të terrorizmit në vendin tonë përmes identifikimit të hershëm të grupeve të synuara dhe të metodave radikale”.

“SDM 2022–2026” lidhet me *Planin Kombëtar për Personat LGBTI+ 2021–2027*, konkretisht me qëllimin e politikës 2 “Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë”.

2.3.7 Lidhja e SDM-së me Strategjinë e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve 2022–2027

SDM 2022–2026, është përgatitur në frymën e Strategjisë së Këshillit të Evropës për të Drejtat e



Fëmijëve 2022–2027. Strategjia e Këshillit të Evropës bazohet në gjashtë fushat prioritare për të garantuar të drejtat e fëmijës të cilat janë: a) liri nga dhuna për të gjithë fëmijët; b) mundësi të barabarta dhe përfshirje sociale për të gjithë fëmijët; c) qasje dhe përdorim i sigurt i teknologjisë për të gjithë fëmijët; d) drejtësi miqësore për të gjithë fëmijët; e) t'i japim zë çdo fëmije; f) të drejtat e fëmijëve në situatë krize dhe emergjence.

Një nga fushat kryesore të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 është “Drejtësia miqësore për të gjithë fëmijët”, e cila konsiston se fëmijëve duhet t'u jepet mundësia të dëgjohen në çdo proces gjyqësor dhe administrativ që i prek ata dhe të kenë akses në mekanizmat kompetentë, të pavarur dhe të paanshëm kur të drejtat e tyre shkelen. Shtetet duhet t'i njohin të drejtën çdo fëmije në konflikt me ligjin për t'u trajtuar duke respektuar dinjitetin e tyre, në përputhje me moshën e fëmijës dhe me objektivin e riintegrit të tyre në shoqëri. Në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët, institucionet/organet duhet të kenë në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

Shtetet duhet të forcojnë aksesin në drejtësi të fëmijëve (civile, administrative, penale). Heqja e lirisë duhet të përdoret si masë e fundit dhe për periudhën më të shkurtër të përshtatshme kohore. Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës do të mbështeten në shmangien dhe parandalimin e privimit të lirisë dhe kriminalizimit të fëmijëve dhe përgatitjes së fëmijëve për riintegrim në shoqëri. Kushtet materiale dhe regjimet e paraburgimit duhet të përmirësohen në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës.

3. Arritjet, analiza dhe sfidat

Reforma “Drejtësi për të mitur” ishte pjesë e reformës në drejtësi të ndërmarrë nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2014. Për herë të parë u miratua një Kod i Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM).²² Risitë e KDPM-së dhe nevoja për të garantuar interesin më të lartë të fëmijës në praktikë diktuan nevojën e hartimit dhe miratimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe Planin e Veprimit 2018–2021 (“SDM 2018–2021”).²³ Tashmë, kjo strategji ka përfunduar.

“SDM 2018–2021” parashikonte 5 objektiva strategjikë, konkretisht:

1. Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi;
2. Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit;
3. Parandalimi i ripërfshirjes në krime të të miturve/të rinjve në krime;
4. Rishoqërizimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin;
5. Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të miturit.

“SDM 2018–2021”, u zbatua në një situatë të pafavorshme për disa shkaqe objektive si: dy tërmetet që goditën Shqipërinë në vitin 2019, pandemia e shkaktuar nga COVID-19; largimi nga sistemi i një pjese të magistratëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve; ngritja me vonesë e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, zbatimi i një reforme të gjerë dhe të thellë në sistemin e drejtësisë, mungesa e burimeve njerëzore të specializuara të mjaftueshme në fushën drejtësisë miqësore për fëmijët etj.

Për secilin objektiv strategjik ishin parashikuar objektiva specifike dhe aktivitete konkrete. “SDM 2018–2021” ishte më e fokusuar në drejtësinë penale për të mitur, më konkretisht në hedhjen e bazave për zbatimin e KDPM dhe fare pak të drejtat e fëmijës në proceset civile, familjare, administrative ose në vendimmarjet e gjykatave që ndikojnë tek të drejtat e fëmijës.

Analiza e zbatimit të “SDM 2018–2021”²⁴, tregoi se në përgjithësi ka pasur zhvillime pozitive në lidhje me drejtësinë penale për të mitur, kryesisht në miratimin e kuadrit nënlighor, krijimin e strukturave të reja që ofrojnë ndihmë ligjore të garantuar nga shteti; rritje graduale e mundësive për të pasur një proces miqësor për fëmijën, hartimi dhe fillimi i zbatimit të programeve të trajtimit, rehabilitimit dhe riintegrit të të miturve në konflikt me ligjin. Zbatimi i kësaj strategjie hodhi bazat e një drejtësie miqësore për fëmijët dhe përmbushur disa nga rekomandimet e mekanizmave monitorues të konventave për të drejtat e fëmijës dhe të angazhimeve të qeverisë shqiptare në zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 16 “Promovimi i shoqërisë paqësore dhe përfshirëse

²² Miratuar me ligjin nr. 37/2017.

²³ Miratuar me vendimin nr. 541, datë 19.9.2018, të Këshillit të Ministrave.

²⁴ <https://drejtesia.gov.al/baza-ligjore-2/>.



për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”.

Më poshtë, në mënyrë të përmblodhur paraqiten arritjet kryesore gjatë zbatimit të “SDM 2018–2021”. Më konkretisht:

Lidhur me objektivin strategjik 1: “Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi”, nga analiza rezultoi se:

- Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 11/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” u miratuan dhe filluan të zbatohen në praktikë.

- U ngritën dhe filluan të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore, përfshirë edhe për të miturit 10 (dhjetë) qendra të ndihmës juridike në: Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Gjirokastrë, Vlorë, Fier dhe Dibër; 12 OSHC të licencuara kanë marrëveshje për ofrim ndihme juridike parësore dhe operojnë në: Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Shkodër²⁵.

- 159 avokatë u regjistruan për të ofruar ndihmë juridike dytësore.

- 21 ndërmjetës të trajnuar për të ofruar shërbimin e ndërmjetësimit falas.

- U hartuan udhëzues dhe manuale për ofrimin e ndihmës juridike në mënyrë miqësore për të miturit dhe u zhvilluan trajtime të avokatëve dhe të ofruesve të tjerë të ndihmës juridike falas.

- U hartuan udhëzues dhe manuale për ofrimin e ndërmjetësimit, si alternativë e parë dhe garantimin e aksesit të të miturve në drejtësi.

- U zhvilluan veprimtari informuese, sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për drejtësinë penale për të mitur dhe shërbime e ndërmjetësimit nga DHKN-ja.

- U zhvilluan veprimtari informuese, sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për drejtësinë penale për të mitur dhe ndihmën juridike të garantuar nga shteti nga DNJF-ja, aktorë të ndryshëm, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë. Një strategji komunikimi u hartua dhe u zbatua.

- U krijuan mjedise miqësore për fëmijët, duke përshtatur mjediset ekzistuese ose duke krijuar mjedise të reja (6 mjedise në gjykata; 9 mjedise në prokurori pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të

shkallës së parë; 16 mjedise në drejtori vendore të policisë/komisariate).

Lidhur me objektivin strategjik 2: “Garantimi i procesit të rregullt ligjor” nga analiza rezultoi se:

- Filloi dhe vijoi puna për hartimin dhe miratimin e kuadrit rregullator për ngritjen e seksioneve për të miturit në gjykata dhe prokurori, një objektivi që ishte ende në proces. Disa masa të domosdoshme u morën për krijimin e mjediseve miqësore në disa prokurori dhe gjykata.

- Ka progres në lidhje me hartimin e programeve të formimit fillestar dhe vazhdues të personave që administrojnë dhe asistojnë drejtësinë penale për të mitur. Gjyqtarë, prokurorë, punonjës të policisë, avokatë, psikologë, ndërmjetës, punonjës të sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale, shërbimit të provës etj. u trajnuan për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

- Zhvillime pozitive u shënuan lidhur me garantimin e procesit të rregullt ligjor për të miturit kundrejt treguesve të përcaktuar në strategji; masa e arrestit në burg për të miturin po zbatohet më pak nga viti në vit.

- U hartuan dhe u miratuan manuale për hetimet në fushën e drejtësisë penale për të mitur për policinë; udhëzime, formate për ndërveprimin mes institucioneve dhe profesionistëve të disiplinave të ndryshme për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin, si dhe formate të dokumenteve që përdoren nga policia, prokuroria, gjykata, shërbimi i provës dhe burgjet.

- U hartuan dhe u miratuan manuale për ndërmjetësimin falas në fushën e drejtësisë penale për të mitur, kur referimi i parë është ndërmjetësimi në rastet e shmangies nga dënimi.

- Është ngritur Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, u hartuan procedurat për popullimin me të dhëna të sistemit nga institucione të ndryshme; ka progres në trajnimin për mbledhjen dhe hedhjen e të dhënave në sistem, por popullimi i sistemit është i ngadaltë.

- Janë kryer disa studime/analiza të pjesshme për përmirësime në aktet ligjore civile, penale dhe administrative sipas nevojave të identifikuara për fëmijët, por nuk ka një dokument ku të jenë përmblodhur të gjitha propozimet për përmirësime ligjore të nevojshme dhe nisma ligjore të ndërmarra.

²⁵Numri i OJF-ve variojnë nga viti në vit, bazuar në interesin e shprehur dhe marrëveshjet e nënshkruara me Ministrinë e Drejtësisë.



- Aktet nënligjore në zbatim të KDPM-së u miratuan; VKM në lidhje me financimin e shërbimit të mbikëqyrjes së fëmijëve në konflikt me ligjin, është hartuar dhe konsultuar publikisht, por nuk është miratuar ende.

Lidhur me objektivin strategjik 3: “Parandalimi i ripërfshirjes në krime të të miturve/të rinjve në krime”, nga analiza rezultoi, se:

- U krijua dhe filloi të funksionojë Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR).

- U miratuan dy programe për veprimtari rehabilituese që lidhen: a) me mbështetjen pas lirit të të miturit në konflikt me ligjin; dhe b) me mbikëqyrjen e të miturit në konflikt me ligjin pas kryerjes së dënimit ose lirit, duke mundësuar trajtimin e rasteve të para.

- Janë lidhur marrëveshje të QPKMR-së me institucione në nivel vendor që mund të kontribuojnë në riintegrimin dhe parandalimin e ripërfshirjes së të miturve/të rinjve në krim.

- Është kryer një vlerësim i mekanizmave të trajtimit të rasteve të fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale, por ka një studim kombëtar të kriminalitetit të të miturve nën moshën e përgjegjësisë penale dhe të faktorëve kriminogjenë.

Lidhur me objektivin strategjik 4: “Rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin”, nga analiza rezultoi se:

Politika penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin janë më sociale.

- Janë miratuar programe lidhur me arsimimin, formimin profesional, punësimin, sportin, argëtimin dhe programe të tjera për riintegrimin e të miturve në konflikt me ligjin në institucionin e ekzekutimit të dënimit me burgim, sipas standardeve më të mira.

- Numri i të miturve të dënuar me burgim, të vendosur në institucione të mbyllura është ulur dhe pak të mitur gjenden në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale.

- Alternativat e dënimit me burgim ndaj të miturve vijon të zbatohet, por nuk ka rritje, ndoshta për arsye të zbatimit të masës së shmangies nga ndjekja penale në formën e “paralajmërimit me shkrim”.

- Masa alternative e shmangies nga ndjekja penale është rritur. Referuar raporteve të

Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit, masa kryesore e zbatuar “Paralajmërimi me shkrim”, është një masë e cila ka ardhur në rritje, ndërsa masat e tjera alternative të shmangies janë zbatuar në raste të pakta.

- Të miturit ndaj të cilëve janë zbatuar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale u vendosen nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës, por numri i tyre është i pakët.

- 33 marrëveshje të nënshkruara nga MD-ja dhe bashkitë në lidhje me krijimin e kuadrit infrastrukturor për zbatimin e masës së shmangies për të miturit.

- Fëmijë në konflikt ose kontakt me ligjin në disa bashki u bënë pjesë e programeve të këshillimit; prindër dhe kujdestarët e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin përfituan përmes programeve të prindërimit; një numër fëmijësh u referuan për shërbime të integruara ose u përfshinë në programe mentorimi, riintegrimi, për drejtësi restauruese dhe ndërmjetësim.

- Ka programe/qendra të edukimit dhe riintegritit për fëmijë në nivel vendor, por të dhënat për to nuk janë të plota; harta e saktë e programeve/qendrave komunitare për rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe standardet që ofrojnë ato nuk u mundësua gjatë analizës.

- Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe përfaqësuesve proceduralë ka ardhur në rritje nga viti në vit, por në disa bashki përfaqësimi bëhet nga njësitë e mbrojtjes së fëmijës.

Lidhur me objektivin strategjik 5: “Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të miturit”, nga analiza rezultoi, se:

Në nivel qendror, u krijua Grupi Ndërinstitucional i Sistemit të Drejtësisë për të Mitur; u institucionalizuan komunitetet e praktikantëve në nivel vendor (Gjirokastrë, Berat, Pukë, Shkodër) dhe është punuar për t'i fuqizuar ato.

- Është hartuar një model marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe pjesëmarrëse në administrimin e drejtësisë penale për të mitur në nivel vendor me qëllim koordinimin e veprimtarisë për drejtësinë miqësore ndaj fëmijës në nivel vendor.

- Është hartuar një projekt udhërrëfyes për bashkërendimin vendor për drejtësinë miqësore për



fëmijën: menaxhimi i koordinuar i rastit të fëmijës në konflikt ose kontakt me ligjin.

Analiza e zbatimit të “SDM 2018–2021” evidentoi disa sfida në këtë fushë. Gjetjet më kryesore paraqiten më poshtë:

- Ka nevojë të adresohen më mirë të drejtat e fëmijës viktimë e veprave penale, dëshmitar, fëmijët në proceset civile, familjare dhe administrative ose në proceset ku veprimet ose vendimmarrjet ndikojnë te fëmijët.

- Mbledhja, përpunimi dhe raportimi i të dhënave statistikore për fëmijët që përfitojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti ka nevojë të përmirësohen.²⁶

- Nevoja e hartimit të një programi vjetor trajnimesh për ofruesit e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, sipas fushave specifike, natyrës së çështjeve me të mitur.

- Nevoja e hartimit të një kalendarit të detajuar me veprimtari edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi, i fokusuar tek institucionet arsimore parauniversitare dhe i hartuar në bashkëpunim me institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

- Fëmijët në risk do të duhet të jenë më shumë në fokus për t'u informuar për të drejtat e tyre dhe shërbimet që mund të përfitojnë mes këshillimit ligjor, në çështjet civile, familjare, penale dhe shërbimet që ofrohen nga mekanizmat vendorë. Programet informuese dhe ndërgjegjësuere për të parandaluar përfshirjen e tyre në kryerjen e veprave penale ose vikimizimin prej tyre do të duhet të jenë më mirë në fokus.

- Me gjithë progresin e bërë, të dhënat lidhur me përmbushjen e standardeve të kërkuara për një mjedis miqësor për fëmijët në prokurori dhe gjykata nuk janë të plota.

- Mosmiratimi i hartës gjyqësore brenda periudhës së shtrirjes së strategjisë ka ndikuar në përmbushjen e treguesit për krijimin e seksioneve me infrastrukturë miqësore për të miturit në gjykata. Është e nevojshme përmbyllja e këtij

procesi në gjykatat dhe prokuroritë e krijuara sipas hartës gjyqësore të miratuar.

- Të dhënat në lidhje me trajnimet e profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët në sistemin e drejtësisë janë të copëzuara, të mbivendosura nga raportimet e institucioneve; të dhënat sasiore dhe cilësore nuk janë të mbledhura dhe të përpunuara në mënyrë sistematike, sipas kategorive të profesionistëve të trajnuar, profesioneve dhe fushave të trajnimit.

- Me gjithë progresin e bërë për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve, ka ende shumë nevojë për njohjen dhe respektimin e standardeve për një drejtësi miqësore për fëmijët; për mbështetje me burime njerëzore dhe financiare të shërbimeve në drejtësinë për të mitur. Mungesa e qëndrueshmërisë së profesionistëve të trajnuar është sfida.

- Kriteret mbi trajnimin, licencimin, kreditimin e profesionistëve të ndryshëm që punojnë me dhe për fëmijët kanë nevojë të hartohen dhe të miratohen.

- Monitorimi i vendimeve të prokurorëve në prokuroritë Tiranë dhe Durrës në lidhje me zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale dhe të vendimeve gjyqësore në gjykatat Tiranë dhe Durrës në lidhje me zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur tregoi se nuk ka një kuptim dhe zbatim të njëjtë të ligjit. Monitorimi periodik i vendimeve ka nevojë të vijojë në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat ku ka seksione të të miturve.

- Vendimet e gjykatave për çështje të caktuara si: detyrimi ushqimor, ekzekutimet e vendimeve gjyqësore që ndikojnë tek të drejtat e fëmijës janë monitoruar pjesërisht dhe jo në mënyrë sistematike. Vlerësimi periodik i të gjitha vendimmarrjeve që lidhen me fëmijët ose ndikojnë te fëmijët është e rekomandueshme.

- Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në nivel të organeve të vetëqeverisjes vendore (NJMF²⁷) kanë një sërë përgjegjësish në lidhje me fëmijët në kontakt ose në konflikt me ligjin dhe fëmijët. Nga analiza nuk u arrit të sigurohen të dhëna të plota dhe të sakta për trajnimet dhe aftësimin e tyre profesional në lidhje me trajtimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin dhe të fëmijëve në nevojë mbrojtjeje që janë viktimat të veprave penale. Punonjësit proceduralë për fëmijët nuk janë

²⁶ Ky konstatim theksohet edhe në Raport Progresin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2022, duke rekomanduar se mbetet e rëndësishme të përmirësohet mbledhja dhe raportimi i të dhënave statistikore për ndihmën juridike falas. Raport Progresin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2022, f. 36. Shih: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022en>.



caktuar në të gjitha bashkitë dhe se këtë rol në disa bashki e kryejnë njësitë e mbrojtjes së fëmijës.

- Megjithëse në KDPM masa e shmangies në programet restauruese është parashikuar si masë e parë referimi i të miturve në kontakt dhe konflikt me ligjin nga institucionet e drejtësisë dhe posaçërisht nga prokuroria është zbatuar shumë rrallë. Do duhet të intensifikohet puna për të pasur ndërmjetës të trajnuar dhe specializuar për fëmijët jo vetëm në Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Durrës, ku ka degë vendore të ndërmjetësve, por edhe në qytetet e tjera të vendit.

- Është e nevojshme që zbatimi më i gjerë i qasjes së prokurorisë për të respektuar shmangien dhe zbatuar praktikën e drejtësisë restauruese të të miturve në kontakt/konflikt me ligjin si alternativë e parë e parashikuar në KDPM. Hartimi dhe miratimi një udhëzimi të Prokurorit të Përgjithshëm për ta bërë funksionale këtë qasje të politikës penale ndaj të miturve në konflikt me ligjin është i nevojshëm.

-Ndonëse në disa degë vendore të ndërmjetësimit ka ndërmjetësues të trajnuar dhe të specializuar është e nevojshme të fuqizohen programet e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të seksioneve të të miturve për të adresuar çështje në programet restauruese dhe të ndërmjetësimit, si dhe për mekanizmat e referimit të tyre.

-Ndonëse ka pak të mitur në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, programet që lidhen me arsimimin, formimin profesional, punësimin, sportin, argëtimin dhe programe të tjera në lidhje me fëmijët në konflikt me ligjin kanë nevojë të zbatohen sipas nevojave individuale të çdo të mituri. Zbatimi i formateve të vlerësimit dhe i planeve individuale kanë nevojë të vlerësohet në mënyrë periodike.

-Disa masa të parashikuara nga KDPM-ja nuk kanë gjetur zbatim në praktikë si: vendosja e të miturit nën mbikëqyrjen e një personi të specializuar (neni 83) ose vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar (neni 84). Është e nevojshme krijimi i kuadrit nënligjor dhe institucional për zbatimin e këtyre masave.

-Duhet të bëhet funksional roli i institucionit të Shërbimit të Provës për ndjekjen e zbatimit të masës së shmangies dhe përmbushjes së marrëveshjes së ndërmjetësimit.

-Ka nevojë për një qasje të re të punonjësve të shërbimit të provës në mbajtjen e kontakteve me fëmijët, duke shmangur takimet e tyre në zyrat e shërbimit të provës dhe duke mundësuar takimet me fëmijët në mjediset ku jetojnë, arsimohen ose mjedise të tjera miqësore. Kjo qasje kërkon rritje të burimeve njerëzore dhe financiare për shërbimin e provës dhe qëndrueshmëri të stafit të specializuar për fëmijët.

-Koordinimi dhe bashkërendimi i të gjitha institucioneve, partnerëve vendës dhe ndërkombëtarë që ofrojnë trajnime për profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët dhe që zbatojnë Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur është i nevojshëm të forcohet.

- Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe përfaqësuesve proceduralë nuk është plotësuar në të gjithë territorin. Qasja e barabartë e fëmijëve në drejtësi miqësore kërkon politika miqësore për çdo fëmijë, forcim të kapaciteteve, shërbime të shtrira në territor dhe disponueshme për çdo fëmijë, të ofruara nga profesionistë të specializuar në fushën e të drejtave të fëmijës.

-Sistemi i Integruar i të Dhënave është krijuar, por nuk popullohet me të dhëna në mënyrë sistematike nga të gjitha institucionet që punojnë me fëmijët në konflikt me ligjin. Evidentohen mungesa e qëndrueshmërisë së përdoruesve të Sistemit të Integruar të të Dhënave, duke evidentuar nevojën e trajnimeve të vazhdueshme për përdoruesit e rinj.

-Kuadri ligjor për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin është pothuajse i plotësuar, por ai ka nevojë të përmirësohet për të adresuar një mbrojtje më të mirë të fëmijëve nga kryerja e veprave penale dhe si viktimë të veprave penale, si dhe dëmshpërblimin e fëmijës viktimë nga autori ose shteti.

-Legjislacioni që rregullon aspekte të tjera në fushën e drejtësisë për të miturit, sidomos në çështjet civile e familjare ose në çështjet ku vendimmarrja ndikon drejtpërdrejtë ose indirekt te fëmijët ka nevojë të rishikohet dhe të përditësohet, bazuar në detyrimet që burojnë nga konventat ku shteti shqiptar është palë.

-Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin të përfshirë në programet e riintegritimit është ende i ulët dhe ka nevojë të rritet, fuqizohet dhe të shtrihet në të gjitha bashkitë. Programet për



prindërimin pozitiv kanë nevojë të zgjerohen dhe të fuqizohen.

-Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, koordinimi dhe bashkëpunimi efektiv, funksionimi i rrjetit ndërinstitucional për çështjet e drejtësisë për të miturit në nivel qendror ka qenë një sfidë. Është e nevojshme forcimi i kapaciteteve koordinuese bashkërenduese dhe monitoruese të Ministrisë së Drejtësisë dhe angazhimi i profesionistëve të dedikuar për fëmijët nga çdo institucion që punon me dhe për fëmijët në sistemin e drejtësisë.

-Krijimi i komuniteteve të profesionistëve në nivel vendor që mund të trajtojnë fëmijët në konflikt/kontakt me ligjin nuk është shtrirë tek të gjitha bashkitë. Praktikrat e grupeve të profesionistëve të krijuara në Berat, Gjirokastrë, Pukë dhe Shkodër kanë nevojë të vlerësohen dhe në varësi të gjetjeve, krijimi i tyre të shtrihet në bashkitë e tjera.

-Zbatimi i modelit *Barnabus* për trajtimin e fëmijëve viktime të dhunës seksuale është një model që ka nevojë të vlerësohet dhe në varësi të gjetjeve, zbatimi i tij rekomandohet të zbatohet më gjerësisht.

-Ministria e Drejtësisë dhe institucione të tjera përgjegjëse kanë alokuar burime njerëzore, por aktivitete të tilla si: ngritja e kapaciteteve, fushata ndërgjegjësuere dhe disa shërbime në nivel vendor janë financuar dhe zbatuar kryesisht nga organizatat partnere dhe/ose projekte. Zbatimi i KDPM-së kërkon masa shtesë, përfshirë burimet njerëzore dhe financiare.

- Drejtësia miqësore për çdo fëmijë ka nevojë për burime njerëzore dhe financiare për të siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit të ndihmës juridike falas, për shtrirjen dhe fuqizimin e shërbimeve për fëmijët viktime dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijët që në kontaktet e para të fëmijës me policinë ose gjykatën; për të fuqizuar strukturat e mbrojtjes së fëmijës që trajtojnë në vijimësi fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin; për të fuqizuar rolin e mësuesve, punonjësve socialë, psikologëve dhe profesionistëve të tjerë të komunitetit të cilët bashkëveprojnë me fëmijët.

- Përfshirja e shërbimeve sociale dhe ofrimi efektiv i shërbimeve për fëmijët, veçanërisht fëmijët në konflikt me ligjin para lirimit me kusht ose pas kryerjes së dënimit, si dhe mbikëqyrja për një periudhë kohe të caktuar më pas me qëllim riintegrimin, është thelbësore për të parandaluar

ripërfshirjen e të miturit në kriminalitet dhe që i mituri të pranohet në mënyrë të natyrshme në familje, shkollë dhe komunitet.

Krahas analizës së zbatimit të “SDM 2018–2021”, të dhënat zyrtare për të miturit në konflikt tregojnë se pas miratimit të KDPM, politika penale e zbatuar ndaj të miturve në konflikt me ligjin është më miqësore. Sipas raporteve vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit rezulton se zbatimi i masës së arrestit me burg për të miturit në konflikt me ligjin është ulur. Raporti konsultues me fëmijët dhe të rinj ka të dhënat për mjediset ku pyeten fëmijët që shoqërohen në polici dhe trajtimin e tyre. Fëmijët shprehen se njohin raste të bashkëmoshatarëve të tyre, të cilët keqtrajtohen në këto ambiente. Ata mendojnë se mjediset ku intervistohen fëmijët duhet të kenë më shumë kushte të përshtatshme për fëmijët dhe stafi duhet të jetë i trajnuar në komunikimin me miqësor dhe pranues me fëmijët.²⁷ “SDM 2022–2026” synon të adresojë këtë problem dhe të krijojë një sistem miqësor në çdo fazë të procedimit penal, duke filluar nga kontakti i parë me policinë.

Masa alternative e shmangies nga ndjekja penale është rritur. Masat alternative të shmangies nuk kanë zbatim të njëjtë, disa prej tyre janë zbatuar pak; masa më e zbatuar është paralajmërimi me shkrim. Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi si masa alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit janë tejet të nevojshme në rastet e veprave penale të kryera nga ta, por janë zbatuar në pak raste.

Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, gjatë periudhës 2015–2021 janë dënuar 2392 të mitur, kryesisht për krime (73%). Numri i të miturve të dënuar ka prirje drejt uljes në raport me vitin 2015.²⁸ Të miturit kanë përfituar nga amnistitë e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Një nga orientimet e politikës penale është zbatimi i alternativave të dënimit me burgim. Gjatë periudhës 2017–2021, gjykatat kanë zbatuar alternativa të dënimit me burgim për 1084 të mitur.

²⁷Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, e miratuar me vendimin nr. 659, datë 3.11.2021 të Këshillit të Ministrave.

²⁸Vjetari statistikor për vitin 2021, botimi Ministrisë së Drejtësisë, f. 128. Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/06/REPUBLIKA-E-SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B-VjetariStatistikor-2021-pdf.pdf>.



Tendenca e zbatimit të tyre për të miturit ka ardhur në rënie, respektivisht: 312 të dënuar të mitur (2017), 290 (2018), 218 (2019), 107 (2020) dhe 157 (2021).²⁹ Sipas Raport Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022 është bërë njëfarë progresi në përdorimin e alternativave ndaj paraburgimit dhe veçanërisht, në zhvillimin e shërbimit të provës, i cili mbetet plotësisht funksional, duke përfshirë edhe të miturit. Megjithatë mbetet ende shumë për të bërë. Ka nevojë për studime të plota dhe sistematike për ndikimin e politikës penale të zbatuar në ripërfshirjen ose jo në kriminalitet të të miturit, qoftë si përsëritës i përgjithshëm ose specifik.

“SDM 2022–2026” parashikon masa që synojnë të vlerësojnë në mënyrë periodike vendimet e prokurorëve dhe gjyqtarëve lidhur me zbatimin e masës së shmangies, bazuar në përvojat e krijuara në kuadër të Programit Shqiptaro-Suedeze të zbatuar gjatë periudhës 2017–2021.³⁰ Gjithashtu, “SDM 2022–2026” parashikon masa për popullimin e plotë dhe në kohë të Sistemit të Integruar të të Dhënave për çështjet penale me të mitur, si dhe studimin e kriminalitetit të të miturve dhe të rinjve (18–21 vjeç) për të vlerësuar efektivitetin e politikës penale, faktorët kriminogjenë dhe adresuar masa për parandalimin e ripërfshirjes së të miturit në kryerjen e veprave penale. Zbatimi i standardeve të vlerësimit të riskut dhe të nevojave të të miturit në konflikt me ligjin nga ekspertë ose grup ekspertësh të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe hartimi dhe mbikëqyrja e planit individual të rehabilitimit dhe riintegrit janë adresuar në “SDM 2022–2026”.

Mundësia e ofrimit të shërbimeve për viktimat fëmijë, përfshirë viktimat e huaja jo gjithnjë është e mundur. Për shembull, fëmijët viktimë të trafikimit nuk marrin shërbime për shkak të mos caktimit të kujdestarit për fëmijën kur nuk gjenden familja ose ajo nuk është e përshtatshme. Mosmarrja e shërbimeve riviktimizon fëmijën.³¹ Gjithashtu, drejtësia miqësore për çdo fëmijë ka nevojë të

domosdoshme mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të detajuara për fëmijët viktimë të çdo veprave penale, marrëdhëniet autorë-viktimë, llogaritjen e dëmeve të pësuar dhe kostove të veprës penale të pësuar, si dhe dëmshpërblimet e dhëna.

“SDM 2022–2026” adreson masa për përmirësime ligjore dhe forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët në raste të tilla dhe përmirësime thelbësore të statistikave veçanërisht për fëmijët viktimat dhe dëshmitarë.

Krahas shërbimeve për viktimat, e drejta e viktimës për dëmshpërblim nga autori ose shteti është parashikuar nga KDPM-ja dhe Kodi i Procedurës Penale. Kjo e drejtë nuk është respektuar dhe në ato pak raste që gjykata ka vendosur dëmshpërblimin për viktimën (jo të mitur) nuk është bërë ekzekutimi i vendimit penal. Gjithashtu, në raportin për Shqipërinë, GREVIO i kërkon autoriteteve shqiptare të krijojnë një skemë kompensimi shtetëror të arritshme për viktimat e krimeve të dhunës në familje.³²

Numri i fëmijëve që janë riviktimizuar nga vendimmarrjet në proceset familjare ose civile, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore është i lartë. Referuar statistikave zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë çdo vit ka një numër të konsiderueshëm të padive për detyrimin ushqimor, për njohje atësie, për kundërshtim atësie, kërkesa për lëshim autorizimi për të miturit, por numri i çështjeve civile të përfunduara në shkallë të parë gjatë pesë viteve të fundit ku vendimmarrja ndikon te fëmija është e ulët.³³

Në krahasim me strategjinë e mëparshme, “SDM 2022–2026” synon të adresojë disa aspekte të viktimizimit të fëmijëve në rastet e zgjidhjeve të martesës së prindërve/prindit të tyre dhe mospërmblidhjes së detyrimit ushqimor nga prindi që me vendim të gjykatës detyrohet ta përmbushë atë. Ka një hendek mes të drejtave të fëmijës, rregulimeve ligjore dhe garantimit të të drejtave të fëmijës në praktikë, veçanërisht në çështjet civile

²⁹Po, aty.

³⁰https://cdn.sida.se/app/uploads/2022/08/22083629/DE2022_25_62558en.pdf

³¹Raport mbi Monitorimin e Politikave kundër Trafikimit në Shqipëri (2020–2021), botim i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2021.

Shih: https://www.qag-al.org/publikime/raport_antitrafikimi.pdf.

³²Shih: <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/01/14/pjese-nga-raporti-fillestar-i-vleresimit-i-grevio-s/#more-112>.

³³Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/06/REPUBLIKA-E-SHIQIP%C3%8BRIS%C3%8B-VjetariStatistikor-2021-pdf.pdf>.



dhe familjare. Në mënyrë të përmbledhur disa sfida kanë nevojë të adresohen si: a) parandalimi i vendimeve gjyqësore të cilat nuk i përgjigjen interesit më të lartë të fëmijës sidomos në rastet e kujdestarisë së fëmijës, ose në rastet e detyrimit ushqimor; b) refuzimi nga kreditori i parapagimit të shpenzimeve për psikologjen/psikologun, duke mosrealizuar ekzekutimet me objekt “takim me fëmijën”; c) vështirësitë në verifikimin e vërtetimit të të ardhurave të prindit debitor i cili/e cila duhet të paguajë detyrimin për ushqim për shkak të mosregjistrimit të aktivitetit të tij/saj ose moslidhje të kontratës për punën; d) emigrimi i debitorëve dhe mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore në interes të fëmijës; e) kohëzgjatja e vendimmarrjeve që ndikojnë te fëmijët.

Studimet³⁴ dhe raport progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022 vënë në pah se praktika e martesës së fëmijëve ende ekziston dhe është e nxitur kryesisht nga pabarazia gjinore, varfëria dhe përjashtimi social. Ligjet për mbrojtjen e adoleshentëve nga martesat e fëmijëve janë joefektive ose zbatohen në mënyrë jokonsistente. Ky problem është adresuar edhe në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Objektivi II.1.1. duke sugjeruar një sërë masash për parandalimin e tyre. Harmonizimi i Kodit të Familjes me ligjet e tjera është i nevojshëm.

Nisur nga arritjet, dhe sfidat që duhet të zgjidhen, “SDM 2022–2026” synon të konsolidojë reformën e ndërmarrë në sistemin e drejtësisë për të mitur dhe të mundësojë drejtësi miqësore për çdo fëmijë në proceset civile, familjare, penale dhe procedurat administrative.

4. Parimet themelore

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 do të udhëhiqet nga disa parime bazë të sanksionuara në Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës, në aktet e tjera ndërkombëtare, në legjislacionin kombëtar, në veçanti, në ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur në Republikën e Shqipërisë.

Krahas parimeve, “SDM 2022–2026”, mban parasysh të drejtat e fëmijës, konkretisht:

- Parimi i interesit më të lartë të fëmijës;
- Parimi i respektimit të dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës;
- Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi;
- Parimi i ligjshmërisë;
- Parimi i konfidencialitetit;
- Parimi i garantimit të një drejtësie miqësore për fëmijët;
- Parimi i mbrojtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqenien e fëmijës;
- Parimi i respektimit të mbrojtjes, promovimit të të drejtave të fëmijëve në kuadër të parimeve themelore të të drejtave të njeriut;
- Parimi i proporcionalitetit;
- Parimi i prezumimit të pafajësisë;
- Parimi i ofrimit i shërbimit të specializuar për çdo fëmijë nga profesionistë të trajnuar/specializuar për drejtësinë për të mitur;
- E drejta për qasje të barabartë te ndihma juridike;
- E drejta për t’u informuar në një gjuhë miqësore;
- E drejta për të marrë pjesë dhe për t’u dëgjuar në çdo procedurë gjyqësore ose administrative në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar;
- E drejta për të shprehur pikëpamjet në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar;
- E drejta për një proces të rregullt ligjor dhe shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi;
- E drejta e mbrojtjes kundër ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e fëmijës; respektimit të jetës private dhe familjare dhe e mbrojtjes së të dhënave personale;
- E drejta për zhvillim harmonik të fëmijës;
- Përparësia e zbatimit të masave alternative të shmangies;
- Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit dhe për kohën më të shkurtër të mundshme;

Interesi më i lartë i fëmijës do të udhëheqë zbatimin e të gjitha masave të parashikuara për përmbushjen e objektivave të “SDM 2022–2026”. Bazuar në parimet e mësipërme, synohet të krijohet një sistem drejtësie plotësisht funksional i ndjeshëm ndaj fëmijëve. Kjo do të jetë e mundur, nëse institucionet e ndryshme, biznesi, shoqëria, media, vetë fëmijët do të angazhohen dhe do të

³⁴ Martesa e fëmijëve, njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet në komunitetet e prekura në Shqipëri, botim UNECEF dhe UNFPA. Shih:

<https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/njohurit%C3%AB-q%C3%ABndrimet-dhe-perceptimet-p%C3%ABr-martestat-e-f%C3%ABmij%C3%ABve-n%C3%AB-komunitetet-e>



bashkëpunojnë mes tyre në nivel qendror dhe vendor.

Hartimi dhe zbatimi i “SDM 2022–2026”, dhe Plani i Veprimit është bazuar në bashkëpunimin midis qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, organizatat e shoqërisë civile, partnerëve vendës dhe ndërkombëtarë.

Politika bazuar në evidenca dhe matjen e progresit është një parim që ka udhëhequr procesin e hartimit të “SDM 2022–2026”. Plani i Veprimit është pajisur me tregues për matjen e progresit të zbatimit dhe treguesit fillestarë (nga ku do të nisë puna), aty ku është e mundur. Zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve të përfshirjes së të miturve dhe për të miturit do të krijojë një bazë të mirë të të dhënave socio-ekonomike të cilat do të mblidhen rregullisht.

Përfshirja e shoqërisë civile ka qenë e rëndësishme në zbatimin e “SDM 2018–2021”. Bashkëpunimi me organizata jofitimprurëse (OJF), partnerë socialë, akademikë/studiues është esenciale në hartimin dhe zbatimin e “SDM 2022–2026”. Këta aktorë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e Planit të Veprimit dhe do të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij. OJF-të, ekspertë të botës akademike kanë jo vetëm ekspertizë të vlefshme për të ofruar, por ato gjithashtu do të jenë aktorë të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit tek të tjerët. Të rinjtë profesionistë, fëmijët dhe organizatat që i përfaqësojnë ata kanë qenë pjesë e hartimit të strategjisë dhe do të jenë pjesë e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të saj.

Buxhetimi për zbatimin është parimi që ka udhëhequr hartimin e kësaj strategjie. Ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura kanë identifikuar buxhetet përkatëse për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, ministritë kanë identifikuar hendeqet e financimit ku mund të kërkohet ndihmë nga donatorë e partner vendës dhe ndërkombëtar.

5. Vizioni dhe misioni

Vizioni i “SDM 2022–2026”: “Garantimi i një drejtësie më miqësore për fëmijët që mbrojnë interesat e tyre më të larta”

Misioni i “SDM 2022–2026”: “Të gjitha institucionet shtetërore do të punojmë së bashku me shoqërinë civile e partnerët e tjerë që punojnë me dhe për fëmijët, si dhe me anëtarët e shoqërisë për të siguruar një shoqëri që parandalon

përfshirjen e fëmijëve në vepra penale dhe viktimizimin e tyre, për të mundësuar një sistem drejtësie miqësor që rivendos të drejtat të cenuara dhe i përgjigjet nevojave të çdo fëmije, si dhe që kontribuon në rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve në konflikt ose kontakt me ligjin dhe në sigurinë dhe paqen shoqërore në bashkësitë tona”.

“SDM 2022– 2026” synon të ofrojë një platformë kombëtare për të gjithë profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët dhe partnerët ndërkombëtarë që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve për të siguruar një shoqëri që parandalon përfshirjen e fëmijëve në vepra penale dhe viktimizimin e tyre, kryesisht mes edukimit, informimit, ndërgjegjësimit, konsolidimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të programeve parandaluese, programeve restauruese dhe ndërmjetësimit, si dhe krijimit të një mjedisi të sigurt për çdo fëmijë.

“SDM 2022– 2026” synon të mundësojë një sistem drejtësie miqësor që rivendos të drejtat të cenuara dhe i përgjigjet nevojave të çdo fëmije në çdo proces ku fëmija është pjesëmarrës ose interesi më i lartë i tij ndikohet nga vendimarrjet.

“SDM 2022– 2026” do t’i mundësojë gjithë institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, partnerëve strategjikë ndërkombëtarë dhe anëtarëve të shoqërisë, profesionistëve të tjerë që punojnë me dhe për fëmijët që të përcaktojnë zgjedhjet/fushat prioritare ku puna, energjitë dhe burimet do të përqendrohen për të zhvilluar, përmirësuar dhe konsoliduar më tej kuadrin normativ, kapacitetet profesionale dhe praktikat e vendosura nga Strategjia Kombëtare e Drejtësisë për të Mitur (2018–2021), si dhe për të ofruar zgjidhje çështjeve të reja të adresuara në këtë strategji.

“SDM 2022–2026” synon të afrojë më tej garantimin e së drejtës së fëmijës për të marrë drejtësi me standardet ndërkombëtare (OKB) dhe rajonale (BE, KE) në këtë fushë dhe të kontribuojë në sigurinë dhe paqen shoqërore në bashkësitë tona.



PJESA II. QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PARËSORE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022–2026

Qëllimet e politikës së SDM 2022–2026

“SDM 2022–2026” përmban 4 (katër) qëllime kryesore:

Qëllimi i Parë: Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve;

Qëllimi i Dytë: Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë;

Qëllimi i Tretë: Garantimi i qasjes në çdo kohë të drejtësisë miqësore për çdo fëmijë;

Qëllimi i Katërt: Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

Arritja e qëllimeve të mësipërme do të përmbushet mes disa objektivave specifikë që synojnë rezultate konkrete në fusha me rëndësi për aksesin në një drejtësi miqësore për çdo fëmijë dhe zvogëlimin e rasteve të cenimit të të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu, përmbushja e këtyre qëllimeve kërkon përfshirjen dhe përpjekje të bashkërenduara nga ministrinë, institucionet në nivel qendror e vendor, institucionet e pavarura, të krijuara me kushtetutë ose me ligj, nga organet e vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, profesionistë të botës akademike, media, komuniteti dhe vetë fëmijët.

Qëllimi i politikës I

Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve.

Qëllimi i politikës I synon të krijojë një kulturë të përgjithshme ligjore të të gjithë aktorëve socialë, përfshirë fëmijët dhe të fuqizojë mekanizmat institucionalë, për të kontribuar nëpërmjet informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit në parandalimin e hershëm të përfshirjes së fëmijëve në veprimtari të paligjshme dhe në kriminalitet, si edhe ndaj veprave penale të kryera ndaj tyre.

Ndryshe nga “SDM 2018–2021”, e cila si strategji e parë e hartuar pas miratimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, kishte në fokus

fëmijët që ishin në kontakt/konflikt me ligjin, SDM 2022–2026” adreson një sërë problematikash të evidentuara në lidhje me drejtësinë miqësore për çdo fëmijë, jo vetëm në çështjet penale, por edhe familjare, civile, administrative. Kjo qasje u bazua në: a) analizën e gjendjes së fëmijëve në risk; b) të dhënat zyrtare dhe të anketave për fëmijët viktime të veprave penale, c) tendencat dhe përhapjen e kriminalitetit të fëmijëve dhe ndaj fëmijëve; ç) riviktimizmi i fëmijëve për shkak të cenimit të të drejtave të tyre në proceset civile dhe familjare ku fëmijët marrin pjesë ose të vendimmarrjeve të gjykatave në proceset civile, familjare, administrative që ndikojnë te fëmijët (zgjidhje martesë, kujdestaria e fëmijës, mospërmbushja e detyrimit ushqimor etj.).

Në këtë kuadër, “SDM 2022–2026”, parashikon një qëllim politik të dedikuar vetëm parandalimit të hershëm të kriminalitetit ndaj fëmijëve dhe përfshirjes së tyre në të përmes edukimit / informimit/ndërgjegjësimit. Ky parandalim synohet të arrihet së pari, mes forcimit të edukimit ligjor në sistemin parauniversitar, në përmirësime të programeve mësimore në të gjitha nivelet si edhe nëpërmjet fushatave të dedikuara për këtë qëllim me fokus: informimin e fëmijëve për njohjen e ligjit, të të drejtave dhe detyrimeve të tyre, për mekanizmat e rivendosjes së të drejtave të cenuara, aksesin në një drejtësi miqësore për çdo fëmijë, si dhe nxitja e aktivizimit të fëmijëve për të marrë pjesë dhe për t’u dëgjuar për të drejtat dhe rivendosjen e tyre, për kontribuar për parandalimin e konflikteve dhe rreziqeve dhe krijimin e një mjedisi miqësor për çdo fëmijë. Edukimi i fëmijëve me tolerancën dhe zgjidhjen e situatave konfliktuale ka rëndësi, veçanërisht për adresimin e nevojave të fëmijëve të ngujuar për shkak të zakonit të vjetër të gjakmarrjes. Në Përmbledhjen e Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, Komiteti i sugjeroi Qeverisë Shqiptare që “të marrë masa të rrepta për t’i dhënë fund gjakmarrjes dhe ngujimit, përmes ndjekjes penale, por edhe duke lehtësuar forma efektive të pajtimit”.³⁵

³⁵ Përmbledhja e Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës bazuar në shqyrtimin e raporteve të kombinuara të dytë, të tretë dhe të katërt të Shqipërisë, tetor 2012, paragrafi 32. Për më shumë shih: Consideration of reports submitted by States parties under article 44 of the Convention Concluding observations: Albania <https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org/albania/f>



Gjithashtu, nëpërmjet këtij qëllimi synohet të pasurohen programet mësimore të arsimit parauniversitar që trajtojnë rreziqet me të cilat fëmijët përballen në ditët e sotme si: abuzimi dhe dhuna në të gjitha format e saj në familje dhe jashtë saj, braktisja e fëmijës, mospërbushja e detyrimeve ndaj fëmijës, shfrytëzimi i fëmijëve në veprimtari të paligjshme, seksuale dhe/ose të tjera kriminale, shfrytëzimi në punë, emigrimi i parregullt, fëmijët e pashoqëruar dhe mundësitë e trafikimit ose shfrytëzimit për qëllime kriminale të tyre, ekspozimi ndaj materialeve të dëmshme për fëmijët, si dhe mekanizmat e parandalimit të tyre.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucione, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përbushjen e dy objektivave specifikë.

Objektivi specifik 1.1: Informim / edukim / ndërgjegjësim në bashkitë e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë.

Objektivi specifik 1.2: Fuqizimi i mekanizmave të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve ku janë përfshirë fëmijë.

Lidhja midis qëllimit të politikës I dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i politikës I lidhet me OZHQ 16, i cili promovon shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, ky qëllim lidhet me nën objektivin 16.10. i cili synon “Të sigurojë aksesin e publikut në informacion dhe të mbrojë liritë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare” dhe 16.2 “Dhënia fund e abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturimit të fëmijëve”.

Objektivi specifik 1.1: Informim / edukim / ndërgjegjësim në bashkitë e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë.

Sipas raporteve 60 për qind e të gjithëve rasteve të abuzimit seksual kryhen ndaj fëmijëve; 48 për qind e fëmijëve në Shqipëri kanë qenë subjekt i të paktën një forme të agresionit psikologjik ose fizik; 33.9 për qind e fëmijëve raportojnë se janë përfshirë në përlëshje fizike në të paktën një herë në vitin e kaluar, djemtë më shumë se vajzat; 83 për qind e fëmijëve të shkollës raportuan se kishin përjetuar lloje të ndryshme të dhunës, me 20 për qind të ngacmuar të paktën dy herë në dy muajt e mëparshëm. Çdo vit policia merr ndërmjet 5, 000 dhe 20, 000 referime për materialet e abuzimit seksual të fëmijëve në internet nga agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit. Megjithatë, vetëm 12 raste të ashtuquajturës “pornografi për fëmijë” janë hetuar nga policia e shtetit në tre vitet e fundit dhe vetëm një është zbuluar me sukses. Një në dhjetë fëmijë raportuan të paktën një përvojë seksuale të padëshiruar përmes internetit, shumë prej tyre të iniciuara nga dikush që fëmija e njihnte tashmë.³⁶

Referuar raportit të prokurorit të përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021, procedimet penale për ngacmim seksual të regjistruara në prokurori janë rritur gjatë periudhës 2017, ndërsa krimet seksuale ndaj të miturit (neni 100 i KP-së), me gjithë luhatjet ndër vite, kanë shënuar rritje në vitin 2021, në krahasim me vitin 2017. Në vitin 2021, 77.27 për qind e viktimave të krimeve seksuale ishin nën moshën 18 vjeç, nga të cilët 94.12 për qind ishin të mitura. Në vitin 2021, prokuroria ka regjistruar procedime penale për braktisje të fëmijës së mitur (26 raste) dhe për keqtrajtim të të miturit (32 raste).³⁷

Pavarësisht numrit të procedimeve penale për këto vepra, referuar statistikave zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2021, vetëm 18 persona janë dënuar për marrëdhënie seksuale me ose pa dhunë me të mitur (neni 100 dhe 101 i KP-së), 12 të

³⁶ UNICEF and Government of Albania Country Programme 2022–2026 Programme Strategy Note, Protecting children from poverty and violence, UNICEF, gusht 2021.

³⁷ Raporti Vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në vitin 2021, faqe 96 dhe 239.



dënuar për ngacmime seksuale, 11 persona për braktisje të fëmijës së mitur dhe 23 të dënuar për keqtrajtim të të miturit.³⁸ Aktualisht, funksionojnë tre qendra për trajtimin e fëmijëve viktimë të dhunës ose abuzimit seksual. Njëkohësisht shërbime për fëmijë ofrohen nga qendra të tjera me tipologji të ndryshme shërbimesh për fëmijët në nevojë mbrojtje. Megjithatë një ndër sfidat me të cilën përballen viktimat është mosraportimi i rasteve dhe nevoja për shërbime të të shtrira në territor për viktimat fëmijë.

Sa më sipër, bazuar në analizën e gjendjes së fëmijëve në risk, të dhënat zyrtare për fëmijët viktimë të veprave penale dhe të rasteve të gjykuara dhe të dënuara, parandalimi parësor i përfshirjes së fëmijëve në kryerjen e veprave penale ose të kryera ndaj tyre është i domosdoshëm. Ndër elementët e parandalimit parësor, u parashikua si objektiv specifik informimi i fëmijëve dhe prindërve të tyre, veçanërisht i fëmijëve që nuk ndjekin arsimin, lidhur me të drejtat e fëmijës, mekanizmat e ushtrimit dhe të mbrojtjes së tyre, përfshirë informimi për një qasje të një sistem drejtësie miqësor për çdo fëmijë me qëllim parandalimin e veprave penale ndaj fëmijës dhe të kryera prej tij.

Ky objektiv specifik është menduar të realizohet nëpërmjet pasurimit të programeve mësimore të nivelit parauniversitar me njohuri të edukimit ligjor dhe hartimit të kalendarëve të detajuar të veprimtarive ndërgjegjësuere sipas viteve, i fokusuar në institucionet arsimore parauniversitare, në bashkëpunim me institucione arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Për fëmijët që nuk ndjekin arsimin, në bashkëpunim me punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, do të organizohen veprimtari njohëse dhe sensibilizuese. Ky plan do të mundësonte mbulimin më të mirë të territorit, planifikimin e burimeve njerëzore dhe financiare, lidhjet e marrëveshjeve me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë (OJF-të, organizatat ndërkombëtare që punojnë me dhe për fëmijët).

Gjithashtu, vëmendje e shtuar do të tregohet për fëmijët në risk, me qëllim informimin e tyre për të drejtat, shërbimet dhe mekanizmat vendorë, rivendosja e të drejtave mes qasjes në proceset

civile, familjare, administrative dhe penale. Një rekomandim i tillë është adresuar që në vitin 2018 nga Komisioneria e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës.³⁹ Një risi e kësaj strategjie është rritja e kontributit dhe qasja proaktive e skuadrave *pro bono* dhe qendrave të këshillimit ligjor në zonat e targetura.

Rezultatet e pritshme

i. Deri në fund të vitit 2026, 40 për qind më shumë fëmijë dhe prindër do të kenë njohuri mbi çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve për parandalimin e veprave penale ndaj tyre dhe të kryera prej tyre, si dhe të drejtën për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekivi specifik 1.1 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, nenin 2 dhe nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2022.

Masat

I.1.1 Përmirësimi dhe pasurimi i programeve mësimore të lëndëve të fushës “Shoqëria dhe mjedisi” të arsimit parauniversitar në lidhje me njohuritë për të drejtat e fëmijës, për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, si dhe të drejtën për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.

I.1.2 Monitorimi i zbatimit të programeve mësimore të përmirësuara në lidhje me të drejtat e fëmijëve me fokus: të drejtat e fëmijës, parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, e drejta e çdo fëmije për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për ta.

I.1.3 Programe informuese e ndërgjegjësuere, që u mundësojnë fëmijëve të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën

³⁸ Vjetari statistikor 2021, botim i Ministrisë së Drejtësisë, f. 35-36. Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/06/REPUBLIKA-E-SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B-VjetariStatistikor-2021.pdf>

³⁹ Report by Dunja Mijatović Commissioner for Human Rights of the Council of Europe, 2 CommDH (2018) 15 2018. Shih: <https://rm.coe.int/09000016808d5652>.



duke propozuar të ashtuquajturat “strategjitë e daljes”.

I.1.4 Promovimi dhe fuqizimi i programeve me një fokus të veçantë të prezencës virtuale e fëmijëve/të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta dhe mbrojtja ndaj bullizimit online.

I.1.5 Fuqizimi i sigurisë në shkollë.

I.1.6 Zbatimi i programeve informuese dhe ndërgjegjësuere me fokus fëmijët që nuk ndjekin arsimin dhe prindërit e tyre, si dhe fëmijët në rrezik braktisje të arsimit të detyruar për të drejtat e tyre, për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe për shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.

I.1.7 Përmirësimi i instrumenteve për dhënien e informacionit online me një gjuhë miqësore për çdo fëmijë nga të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime për fëmijë, duke marrë në konsideratë veçanërisht nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

I.1.8 Zhvillimi i programeve informuese dhe edukuese në mediat audiovizive për fëmijët dhe me fëmijët mbi të drejtat e tyre, parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, si dhe për shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.

I.1.9 Veprimtari informuese dhe ndërgjegjësuere të organizuara nga fëmijët (parlamenti rinor, grupimet e tjera të fëmijëve) në lidhje me parandalim i përshkallëzimit të konflikteve në shkollë, në komunitet, si dhe të një mjedisi pranues për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin.

I.1.10 Fushata ndërgjegjësuere kombëtare për promovimin e të drejtave të fëmijëve me qëllim parandalimin e viktimizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe diskriminimi i fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

Treguesit kryesorë

I.1.a Përqindja e fëmijëve, si dhe atyre në risk braktisje të arsimit të detyruar në zonat e targetuara të cilët kanë njohuri mbi çështjet që lidhen me të drejtat e tyre, për parandalimin e veprave penale ndaj tyre dhe të kryera prej tyre, si dhe të drejtën për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.

I.1.b Numri i programeve mësimore të arsimit parauniversitar në të cilën janë të përfshirë informacione në lidhje me njohuritë për të drejtat e fëmijës, për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, si dhe të drejtën për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.

I.1.c Numri i institucioneve që punojnë me dhe për fëmijët të cilët kanë informacione online të përditësuara e të publikuara me një gjuhë miqësore për fëmijët, si dhe për të drejtat dhe shërbimet e drejtësisë miqësore për ta.

I.1.d Përqindja e prindërve/fëmijëve në zonat e targetuara që marrin dhe përdorin informacionin online në faqet zyrtare të institucioneve që punojnë me dhe për fëmijët.

Objektivi specifik 1.2: Fuqizimi i mekanizmave të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve ku janë përfshirë fëmijë.

Referuar analizës së zbatimit të “SDM 2018–2021” del si domosdoshmëri fuqizimi i programeve të drejtësisë restauruese, instrumentit të rrethave paqebërëse në shkollë dhe të ndërmjetësimit me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve ku përfshihen fëmijë, me qëllim zgjidhjen paqësore dhe parandalimin ose zbutjen e pasojave të tyre.

Referuar statistikave zyrtare të prokurorisë, gjatë vitit 2021, të miturit janë përfshirë në krime kundër jetës (vrasje) dhe kanosje ndonëse në raste të pakta (1.67 për qind), krime kundër shëndetit, kryesisht plagosje dhe rrahje (4.8 për qind dhe në vepra penale kundër moralit, kryesisht në krimin e përndjekjes. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 fëmijët ishin viktimë të krimeve kundër jetës nga pakujdesia (33 për qind), të plagosjeve të rënda dhe të rrahjeve (1.78 për qind), të shkaktimit të vetëvrasjes (14.81 për qind).⁴⁰

Ligji nr. 10375, datë 24.2.2022, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar sjell një qasje të re në sistemin e drejtësisë penale duke vënë në qendër fëmijën në kontakt/konflikt me ligjin duke parashikuar si alternativë të parë ndërmjetësimin në rastet e të miturit në konflikt me të miturit.

Një nga sfidat që ka nevojë të adresohet është parandalimi i konflikteve të vogla, të parëndësishme në dukje, por nëse nuk adresohen në kohë dhe mes programeve restauruese, të rrethave paqebërëse në shkollë dhe/ose ndërmjetësimit mund të precipitojnë në vepra penale të rënda ku fëmija mund të përfshihet si

⁴⁰ Raporti Vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në vitin 2021, faqe 85-93 dhe 101-104.



autorë ose viktimë. Për këtë, në vijim të gjetjeve të analizës së strategjisë së mëparshme dhe të dhënave të veprave penale të kryera ndaj fëmijëve dhe nga ata, ky objektivi specifik synon promovimin dhe zbatimin e programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit në shkolla dhe në komunitet, për zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve, përmes këtyre instrumenteve.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave të cilat lidhen me objektivin specifik 1.2

i. Deri në fund të vitit 2026, 70 për qind më shumë shkolla në zonat e targetuara do të kenë ngritur rrethet e paqes, grupet e ndërmjetësve për fëmijët me përbërje të mësuesve, nxënësve dhe prindërve.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA

Objektivi specifik 1.2 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” nenin 2 dhe me nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat

I.2.1 Promovimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit në shkolla dhe në komunitet.

I.2.2 Zbatimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit në shkolla dhe në komunitet.

Treguesit kryesorë

I.2.a Numri i shkollave në zonat e targetuara të cilët kanë ngritur rrethet paqebërëse, grupin e ndërmjetësve për fëmijët në shkolla me përbërje të mësuesve, nxënësve dhe prindërve në zonat e targetuara.

I.2.b Numri i aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuere dhe promovuese me nxënësit dhe mësuesit në zonat e targetuara për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në shkolla dhe komunitet.

I.2.c Numri i mësuesve, oficerëve të sigurisë dhe të policisë në komunitet, në zonat e targetuara, të trajnuar mbi adresimin e konflikteve përmes ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese.

I.2.d Numri i rasteve të suksesshme të zgjidhjes së konflikteve në shkolla dhe komunitet përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit të promovuara.

Qëllimi i politikës II

Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë.

Qëllimi i politikës II synon të konsolidojë zbatimin e kuadrit rregullator dhe institucional për një drejtësi miqësore për çdo fëmijë, duke adresuar çështje të legjislacionit penal, si dhe disa çështje të legjislacionit civil, familjar etj. në lidhje me pjesëmarrjen dhe dëgjimin e fëmijës në proces (si për shembull në proceset familjare), rritjen e vendimmarrjeve të institucioneve të bazuara në interesin më të lartë të fëmijës si dhe rritjen e efektivitetit të procedimeve dhe e proceseve ku vendimmarrja i institucioneve ndikon te fëmija. Një synim tjetër i rëndësishëm i këtij qëllimi është konsolidimi dhe specializimi i trupës së profesionistëve të cilët punojnë me dhe për fëmijët, si dhe kapacitetet monitoruese të kësaj strategjie nga institucionet përgjegjëse.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucione, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e tre objektivave specifikë:

Objektivi specifik 2.1: Kuadri ligjor dhe politikat institucionale garantojnë akses te një drejtësi miqësore për çdo fëmijë.

Objektivi specifik 2.2: Koordinimi dhe bashkërendimi mes institucioneve me qëllim forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët.

Objektivi specifik 2.3: Forcimi i rolit koordinues të Ministrisë së Drejtësisë për çështjet që lidhen me fëmijët dhe mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon te fëmijët, bazuar në standardet ndërkombëtare.

Lidhja midis qëllimit të politikës II dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i politikës II synon të konsolidojë një kuadër ligjor dhe institucional që mundëson një drejtësi miqësore për çdo fëmijë. Ai synon në të njëjtën kohë që brenda këtij kuadri, drejtësia



miqësore të ofrohet nga profesionistë të specializuar në fushën e të drejtave të fëmijëve. Ky qëllim lidhet me objektivin 16 të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ngritjen e institucioneve të dobishme, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, qëllimi lidhet me nënobjektivin 16.2 “Mbrotja e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe dhuna”; 16.a “Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin”, si dhe nënobjektivin 16.b “Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve jodiskriminuese”.

Objektivi specifik 2.1 Kuadri ligjor dhe politikat institucionale garantojnë akses te një drejtësi miqësore për çdo fëmijë.

KDPM parashikon hartimin dhe miratimin e disa akteve nënligjore për zbatimin e tij. Referuar analizës së zbatimit të “SDM 2018–2021” aktet nënligjore të parashikuara nga Kodi u miratuan dhe vetëm një akt është konsultuar, po nuk është miratuar ende. Ekspertë të fushës dhe partnerë ndërkombëtarë që u angazhuan në zbatimin e Programit Shqiptaro-Suedez për Drejtësinë e të Miturve kanë adresuar disa rekomandime për përmirësime në KDPM.⁴¹

Gjithashtu, mbetet ende për të bërë në drejtëm të plotësisht dhe përmirësimit të kuadrit rregullator në fushën penale, në veçanti për adresimin e krimeve online ndaj me fëmijëve dhe krimet seksuale, të adresuara nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës⁴², GREVIO dhe Raport Progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2022.⁴³ Raporti i GRETA-s për

Shqipërinë rekomandon ndryshime në Kodin Penal për dënimin e trafikimit të brendshëm të fëmijëve.⁴⁴

Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022) nënvizon se fenomeni i abuzimit seksual të fëmijëve në internet mbetet shqetësues⁴⁵. Të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet duhet të kriminalizohen dhe të hetohen. Duhet të forcohen kapacitetet për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve kundër fëmijëve të kryera përmes internetit. Mbeten për t'u miratuar ndryshimet legislative për të kriminalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet.

Krahas përmirësimeve në legjislacionin penal, “SDM 2022–2026” synon të adresojë disa përmirësime të legjislacionit civil dhe familjar që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës në vendimmarrjet e gjykatave, si dhe ekzekutimi i detyrimit ushqimor për fëmijën, kompensimi i viktimës së mitur nga autori/shteti, çështje që lidhen me kujdestarinë për fëmijët. Të dhënat zyrtare tregojnë se numri i zgjidhjeve të martesave ka ardhur në rritje gjatë pesë viteve të fundit (2017–2021)⁴⁶ dhe se kryesisht gratë dhe fëmijët janë viktimë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore me objekt “detyrim ushqimor”, “takim me fëmijë”, “kujdestari fëmijë”, “urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes” dhe “urdhëra të mbrojtjes”. Këto çështje trajtohen nga shërbimi përmbartimor shtetëror dhe privat.

bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrimin e përdorimit të forcës apo rezistencës. Për vlerësimin e pëlqimit të plotë e të lirë të fëmijës, duhet t'i kushtohet rëndësi diferencës së moshës ndërmjet dhunuesit dhe viktimës; b) të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur, të moshës 14–18 vjeç, në mënyrë që të mos varet nëse viktimë ka arritur moshën e pjekurisë apo jo. Shih: Pjesë nga Raporti fillestar i Vlerësimit të GREVIO-s - Grupi i Ekspertëve për masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje – për Shqipërinë, në lidhje me masat legislative dhe të tjera të ndërmarra në zbatim të dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (24 dhjetor 2017).

⁴⁴ Access to justice and effective remedies for victims of trafficking in human beings, raporti i tretë i vlerësimit të Shqipërisë, GRETA (2020) 09, publikuar më 15 dhjetor 2020. Shih: <https://rm.coe.int/greta-2020-09-fgr-alb-en/1680a0b84f>.

⁴⁵ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

⁴⁶ Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/statistika/>.

⁴¹ Summary of legal and practical uncertainties/challenges/gaps discovered by practitioners when applying the CCJC, dokument pune.

⁴² Sipas raportit të Komitetit për të drejtat e fëmijës qeveria shqiptare duhet të rishikojë legjislacionin penal, me qëllim që t'i mbrojë më mirë fëmijët nga mosha 14 në 18 vjeç nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual. Për më shumë shih: Consideration of reports submitted by States parties under article 44 of the Convention Concluding observations: Albania, vep. e cit.

⁴³ Sipas paragrafit 34, GREVIO u kërkon autoriteteve shqiptare: a) të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur, të moshës 14–18 vjeç, në mënyrë që ky përkufizim të



Tabela nr. 1. Të dhënat mbi çështje të “detyrimit ushqimor” (2016–1.9.2020)

Viti	Totali i çështjeve për detyrim ushqimor	Çështje për detyrimin ushqimor të paekzekutuara	Padi penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë
2016	6100	1593	70
2017	6132	1758	80
2018	6547	2488	65
2019	7221	2754	55
Deri 1.9. 2020	7205	2932	43

Për periudhën 2016–30.9.2020 janë regjistruar 33205 çështje, nga të cilat në 11525 (35%) çështje nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe janë kallëzuar penalisht 313 debitorë për mosdhënie të mjeteve për jetesë.

Janë kryer disa studime/analiza për përmirësime në aktet ligjore familjare, civile, penale lidhur me çështjet që kanë të bëjnë të drejtat e fëmijës, por nuk ka përmblendje dhe vlerësim të të gjitha propozimeve për përmirësime ligjore, si dhe nevojitet diskutimi i këtyre studimeve mes profesionistëve, nëpërmjet forumeve të institucionalizuara. Po kështu, botimet e praktikave më të mira do të plotësojnë kuadrin udhëzues për çështjet gjyqësore, ku fëmija merr pjesë.

Mes masave të propozuara nën këtë objektiv synohet të përmbushen detyrimet që burojnë nga vendimi nr. 24, datë 21.4.2014 i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së⁴⁷ në rastet kur prindi nuk e përmbush detyrimin pasi ai jeton jashtë shtetit. Sipas ekspertëve të fushës, ekzekutimi i detyrimit ushqimor është i mundur të kryhet nëse merren disa masa.⁴⁸

⁴⁷ Shih vendimin në adresën: në www.gjk.gov.al. Gjykata eidenton faktin se “ky organ, edhe pse nuk mund të investojë drejtpërdrejt nga kërkesja në procesin e nisjes së një procedure për njohje dhe zbatim vendimi gjyqësor në territorin grek, nëpërmjet ekspertizës dhe praktikës që kjo ministri ndjek në zbatim të këtyre konventave, ka pasur të gjitha mundësitë për të orientuar drejt kërkesës mbi bazën ligjore të përshtatshme, të zbatueshme në këtë rast, si dhe hapat që duhet të ndërmerret për paraqitjen e kërkesës për njohje dhe ekzekutim vendimi në shtetin grek”.

⁴⁸ Ekspertët propozojnë masa të tilla si: rritja e efektivitetit dhe kapacitetit profesional të nëpunësve dhe zyrtarëve të përbarimit gjyqësor, me qëllim ekzekutimin e vendimeve të kësaj kategorie; monitorimi në mënyrë sistematike i situatës së përbarimit gjyqësor shtetëror e privat për këtë çështje; rishikimi i dispozitave të Kodit të Familjes me qëllim përmirësimin e garancive ligjore për ekzekutimin e vendimeve mbi detyrimet ushqimore, brenda një afati të

“SDM 2022–2026” adreson për herë të parë disa hapa në drejtim të garantimit të së drejtës për dëmshpërblimin e viktimës së mitur mes vlerësimit të përvojave më të mira ndërkombëtare në fushë, adresimit të rekomandimeve të profesionistëve shqiptarë⁴⁹ dhe fuqizimit të kapaciteteve të avokatëve dhe ekspertëve, si dhe i marrjes së masave për krijimin e fondit të përgjithshëm të kompensimit; marrja e masave për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për kompensimin viktimave; nevoja e monitorimit të procesit të kompensimit të viktimave në praktikë; pilotimi në rastet e fëmijëve viktimë të trafikimit dhe dhunës seksuale.

Rezultatet e pritshme

i. Deri në fund të vitit 2026, legjislacioni në fushën penale, civile, familjare, administrative, lidhur me garantimin e të drejtave të fëmijës, do të jetë përmirësuar në përputhje me standardeve ndërkombëtare.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objekti i specifik 2.1 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, dhe nenin 2

arsyeshëm; nevoja për plotësime në aktet ligjore e nënligjore shqiptare, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga konventat ndërkombëtare në këtë fushë, mes nismave ligjore që duhet të ndërmarrë Këshilli i Ministrave; analiza e mundësive të zbatimit të praktikave të mira që zbatohen në vende të tjera si për shembull Mundësia për zëvendësimin nga shteti të kreditorit për një periudhë emergjente dhe më tej, shteti mund të kërkojë nga kreditori të gjithë masën e detyrimit që duhet të kishte paguar. Shih: Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, botim i Qendrës për nisma ligjore qytetare, Tiranë 2015. Raporti mund të aksesohet në adresën:

<https://www.qag-al.org/> / publikime / Raporti_mbi_gjetjet_kryesore.pdf.

⁴⁹ Raport mbi Monitorimin e Politikave kundër Trafikimit në Shqipëri (2020–2021), vep. e cit. f.50.



dhe 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Komunitetit Evropian e shteteve anëtare dhe Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ky objektiv lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, bazuar edhe në rekomandimet e raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022 dhe prioritetet për kapitullin 23 të MSA-së.

Masat

II.1.1 Vlerësimi dhe përmirësimi i legjislacionit në fushën civile, familjare, administrative, lidhur me garantimin e të drejtave të fëmijës në përputhje me standardet ndërkombëtare.

II.1.2 Përmirësimi i legjislacionit në fushën penale lidhur me të drejtat e fëmijës në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së.

II.1.3 Krijimi i praktikave të mira për mbrojtjen e fëmijës dhe marrjen e masave të duhura të mbrojtjes së fëmijës lidhur me kujdestarinë, detyrimin për ushqim dhe ekzekutimin e tij, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, rastet e fëmijëve viktimë të dhunës në familje ose formave të tjera të dhunës ndaj fëmijës.

II.1.4 Rekomandime miqësore për gjykatat nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në çështjet që janë në interes të fëmijës.

II.1.5 Ngritja dhe funksionimi i rrjetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që punojnë në seksionet për të mitur me qëllim shkëmbimin e përvojave pozitive dhe për të diskutuar problematikat e hasura në praktikë.

II.1.6 Evidentimi dhe promovimi i praktikave më të mira për çështjet gjyqësore për të miturit.

II.1.7 Përditësimi i udhëzimeve të miratuara nga prokurori i përgjithshëm në lidhje me hetimin e çështjeve e të miturve dhe trajtimin e fëmijëve viktimë.

II.1.8 Rishikimi i Kodit të Transmetimit për Mediat Audiovizive në lidhje me zgjerimin e programeve informuese dhe ndërgjegjësuere për të drejtat e fëmijës në kontakt/konflikt me ligjin, parashikimin e parimeve dhe rregullave për parandalimin e shkeljes së të drejtave të çdo fëmije, përfshirë të drejtat e fëmijës në kontakt/konflikt me ligjin.

II.1.9 Ndërmarrja e nismës ligjore për të adresuar parandalimin e cenimit e të drejtave të

fëmijës në kontakt/konflikt me ligjin në median online.

II.1.10 Hartimi i një udhëzuesi e cili përcakton qartësisht definicionin e interesit më të lartë të fëmijëve.

Treguesit kryesorë

II.1/a Përqindja në rritje e fëmijëve të cilët marrin një drejtësi miqësore nga institucionet e drejtësisë dhe profesionistët e fushës në zona të targetuara.

II.1/b Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore në fushën penale, civile, familjare, administrative të përmirësuara, të miratuara dhe të publikuara.

II.1/c Numri i vendimeve të detyrimeve ushqimore të ekzekutuara.

II.1/d Numri i rekomandimeve për përmirësim të praktikave të drejtësisë miqësore për fëmijët të adresuara nga rrjeti i gjyqtarëve dhe prokurorëve që punojnë në seksione/çështjet për të. mitur.

II.1/e Udhëzuesi i praktikave më të mira lidhur me drejtësinë miqësore për të miturit i miratuar.

Objektivi specifik 2.2: Koordinimi dhe bashkërendimi mes institucioneve me qëllim forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët

Konsolidimi dhe specializimi i trupës së profesionistëve mbetet një nga synimet më të rëndësishme të kësaj strategjie. Në zbatim të SDM 2018–2021, ka pasur progres në trajnimin e specialistëve që punojnë me dhe për fëmijën, në të gjitha hallkat e sistemit, por ka ende shumë nevojë për njohjen, respektimin e standardeve për një drejtësi miqësore për fëmijët, si dhe kuptimin dhe zbatimin e drejtë dhe të njëjtë të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Gjithashtu, është e nevojshme të përcaktohet qartë numri i personave të trajnuar dhe kategoritë e tyre sipas profesionit dhe fushave të trajnimit. Në lidhje me këtë objektiv specifik, janë parashikuar masa për vlerësimin e nevojave, hartimin e regjistrave të trajnimit dhe kalendarëve vjetorë, për çdo institucion.

Rezultatet e pritshme

i. Deri në fund të vitit 2026, të gjithë profesionistët që punojnë me ose për fëmijët, janë trajnuar/specializuar për trajtimin e rasteve që përfshijnë fëmijët.



Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 2.2 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe nenin 2 dhe 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Komunitetit Evropian e shteteve anëtare dhe Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, bazuar edhe në rekomandimet e raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022 dhe prioritetet për kapitullin 23 të MSA-së.

Masat

II.2.1 Vlerësimi dhe përditësimi i programeve të formimit fillestar dhe formimit vazhdues nga secili institucion që punon me ose për fëmijët duke specifikuar trajnimet sipas fushave të përcaktuara në KDPM (neni 26 KDPM) dhe bërja transparente e tyre në faqen zyrtare të institucionit.

II.2.2 Krijimi/përditësimi i regjistrave të profesionistëve të trajnuar/specializuar në të drejtat e fëmijës dhe sistemin e drejtësisë miqësore për fëmijët nga çdo organ që administron sistemin e drejtësisë ose e mbështet atë dhe profesionistëve në kontakt me fëmijën (në zbatim të nenit 32 të KDPM dhe neneve 25-31 të KDPM).

II.2.3 Trajnimi i punonjësve të policisë, policisë gjyqësore dhe ndihmës specialistëve për hetimin e veprave penale në lidhje me të drejtat e fëmijës, nevojat, për përdorimin e teknologjisë audio-video, teknikat e komunikimit dhe intervistimit dhe aspektet psikologjike etj.

II.2.4 Ngritja dhe funksionimi i seksioneve për të mitur në prokuroritë dhe në dhomat penale, civile të gjykatave, sipas hartës gjyqësore, sipas një kalendarit të ndërhyrjeve dhe lista e gjykatave pilot ku do të krijohen mjediset miqësore.

II.2.5 Forcimi i kapaciteteve të mbrojtësve ligjore të zgjedhur ose të caktuar në teknikat e mbrojtjes miqësore të fëmijës dhe metodologjinë e komunikimit.

II.2.6 Forcimi i kapaciteteve të psikologëve ndihmës/ asistues/ trajtues të rasteve në pyetjet për fëmijët dhe formulimin e tyre.

II.2.7 Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.

II.2.8 Fuqizimi i kapaciteteve të mjaftueshme të Njësiave për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Grupeve Teknike Ndërsektoriale (GTN) në bashkitë e

targetuara⁵⁰ (Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Vlorë, Elbasan, Kamëz, Korçë, Lezhë, Pogradec, Fier, Berat, Gjirokastrë, Pukë, Lushnjë) dhe përfshirja e tyre në trajnimet e grupeve shumëdisiplinore.

II.2.9 Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit të provës që trajtojnë çështje të tëmiturve.

II. 2.10 Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit përmbarimit gjyqësor që trajtojnë çështje të fëmijëve

II.2.11 Publikimi në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse të botimeve të përgatitura dhe shpërndarja të profesionistët.

Treguesit kryesorë

II.2/a Programet e formimit fillestar dhe formimit vazhdues të përmirësuar nga secili institucion që punon me ose për fëmijët duke specifikuar trajnimet sipas fushave të përcaktuara në KDPM (neni 26 KDPM) dhe transparente në faqen zyrtare të institucionit.

II.2/b Regjistra të profesionistëve të trajnuar/specializuar, të krijuar dhe të përditësuar.

II.2/c Numri i profesionistëve që punojnë me ose për fëmijët të trajnuar/specializuar në lidhje me drejtësinë miqësore për të mitur.

II.2.d. Numri i seksioneve për të mitur në prokuroritë dhe në dhomat penale, civile të gjykatave sipas hartës gjyqësore të ngritura dhe funksionale.

Objektivi specifik 2.3: Forcimi i rolit koordinues të Ministrisë së Drejtësisë për çështjet që lidhen me fëmijët dhe mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon te fëmijët, bazuar në standardet ndërkombëtare.

Monitorimi dhe koordinimi i zbatimit të masave dhe bashkëpunimit ndërinstitutional, nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, si ministria përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të “SDM 2022–2026”, vlerësohet shumë i rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të strategjisë. Procesi i monitorimit i parashikuar në këtë objektivi shihet i lidhur ngushtë me mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e

⁵⁰ Bashkitë e targetuara të cituara në këtë masë e më tej në këtë dokument strategjik janë: Bashkia Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Vlorë, Elbasan, Kamëz, Korçë, Lezhë, Pogradec, Fier, Berat, Gjirokastrë, Pukë, Lushnjë.



statistikave, të cilat do të ndihmojnë krijimin e dokumenteve analitike në fushën e drejtësisë për të mitur dhe orientimin e politikave dhe përmirësimet në legjislacion, bazuar në gjetjet e studimeve dhe mbi bazën e të dhënave.

Analiza vuri në pah se statistikatat për të miturit në kontakt ose në konflikt me ligjin janë fragmentare, të pastandardizuara dhe të pakta. Ka pak të dhëna për të miturit e përfshirë në kriminalitet; ato janë herë të përpunuara sipas klasifikimit të veprave penale në Kodin Penal dhe herë sipas grupeve të veprave penale. Të dhënat e detajuara për gjininë, arsimin, pozitën sociale, përvojat e mëparshme të të miturit në vepra penale pothuajse mungojnë. Të dhënat për viktimat në proceset penale janë të pakta dhe nuk mundësojnë studimin dhe krahasimin e tyre, ndërsa të dhënat për fëmijët dëshmitarë mungojnë. Nuk ka të dhëna të publikuara për fëmijën që marrin pjesë në proceset civile, familjare dhe administrative ose që ndikohen nga vendimarrjet në këto procese.

Një bazë e të dhënave të drejtësisë penale për të mitur është krijuar në zbatim të nenit 136 të KDPM e cila duhet të përmbajë të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë ekzekutimin e vendimit penal për të miturit. Një sistem elektronik i teknologjisë së informacionit është duke i krijuar dhe menaxhohet nga KLGJ-ja, bazuar në nenin 92 të ligjit të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në RSH-së. Udhëzimet specifike janë miratuar nga KLGJ-ja dhe PP në lidhje me statistikatat për të miturit dhe efektivitetin e drejtësisë për të mitur.

Ky objektivi adreson disa sfida si: a) rishikimin e metodologjisë për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimarrja ndikon te fëmijët, bazuar në standardet ndërkombëtare të miratuara ë fushë; b) popullimin e bazës së të dhënave të drejtësisë penale për të mitur në kohë reale dhe hartimi i raporteve vjetore; c) standardizimi i statistikave të policisë, prokurorisë, gjykatës, shërbimit provës dhe burgjeve në lidhje me të miturit në konflikt dhe/ose në kontakt me ligjin; d) qëndrueshmëria dhe trajnimi i stafit të sektorit të përpunimit të statistikave dhe studimeve.

Rezultatet e pritshme:

Deri në fund të vitit 2026 mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile,

familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimarrja ndikon te fëmijët, do të jenë përmirësuar bazuar në standardet ndërkombëtare.

i. Stafi i Ministrisë së Drejtësisë dhe QKPMR-ja do të jenë aftësuar mjaftueshëm për të qenë aktorë koordinues mes institucioneve që punojnë me ose për fëmijën në gjenerimin e statistikave cilësore bazuar në standardet ndërkombëtare.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 2.3 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe nenin 78 të MSA-së, “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, si dhe me nenin 88 të saj “*Bashkëpunimi statistikor*” e nënshkruar midis Komunitetit Evropian e shteteve anëtare dhe Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, bazohet në rekomandimet e raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022 dhe prioritetet për kapitullin 23 të MSA-së.

Masat

II.3.1 Forcimi i rolit koordinues të stafit të Ministrisë së Drejtësisë që punon me çështje që lidhen me dhe për të mitur.

II.3.2 Përmirësimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimarrja ndikon te fëmijët.

Treguesit kryesorë

II.3.a Stafi i MD i trajnuar dhe specializuar për çështje të drejtësisë së të miturve, si dhe për gjenerimin e statistikave cilësore për të mitur të cilët kanë qenë të përfshirë në çështje penale, civile, administrative dhe familjare.

II.3.b Numri i raporteve statistikore të prodhuara çdo vit nga MD që lidhen me çështje të drejtësisë penale, administrative, familjare, civile të të miturve dhe që publikohen nga INSTAT-i.

Qëllimi i politikës III

Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë.

Bazuar në qëllimet strategjike të SDM 2018–2021 “Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi” dhe “Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit”, ky qëllim strategjik zgjerohet duke synuar të kalojë nga krijimi i kuadrit ligjor dhe institucional për ofrimin e ndihmës juridike të garantuara nga shteti dhe për mjediset miqësore në polici,



prokurori, gjykata dhe në institucione të tjera ligjzbatuese, në garatimin në çdo kohë dhe për çdo fëmijë të një qasjeje në drejtësi miqësore për ta, duke ofruar ndihmë juridike dhe informacione në gjuhë miqësore për çdo fëmijë, nga profesionistë të trajnuar/specializuar në çështjet e fëmijëve, duke përcaktuar dhe krijuar standardet e mjedisve miqësore për fëmijët dhe aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara në gjykatat dhe në prokuroritë e përcaktuara me hartën e re gjyqësore të miratuar.

Risi të këtij qëllimi politik është garantimi i procesi të rregullt ligjor, jo vetëm për çdo fëmijë në kontakt/konflikt me ligjin, por edhe në proceset civile, familjare dhe administrative, vëmendja e shtuar të fëmijët viktimë të veprave penale dhe të vendimmarrjeve që ndikojnë te fëmijët dhe çështja e kompensimit të viktimave të veprave nga autori ose shteti.

Për të mundur shërbime miqësore për fëmijët në sistemin e drejtësisë penale është parashikuar të përdoren të gjitha manualët, udhëzuesit, formatet dhe teknikat të intervistimit, të vlerësimit të fëmijës, të hartuara dhe të miratuara gjatë zbatimit të strategjisë së mëparshme (në polici, prokurori dhe gjykata), teknologjia audio-video nga të gjithë profesionistët, si dhe të plotësohen me profesionistë të trajnuar/specializuar të gjitha institucionet e drejtësisë që punojnë me dhe për fëmijët dhe shërbimet mbështetëse të tyre.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucione, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e tre objektivave specifikë:

Objektivi specifik 3.1: Qasje për çdo fëmijë në ndihmën juridike të ofruar nga profesionistë të trajnuar dhe informacioni me gjuhë miqësore për çdo fëmijë.

Objektivi specifik 3.2: Shërbime të drejtësisë miqësore për çdo fëmijë të ofruara në mjedise të aksesueshme për ta.

Objektivi specifik 3.3: Shërbime mbështetëse të standardizuara, të arritshme për çdo fëmijë.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i politikës III lidhet me objektivin 16 të zhvillimit të qëndrueshëm i cili promovon shoqëri

paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe krijimi i institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet dhe me objektivin 10. “Ulja e pabarazive brenda dhe ndërmjet shteteve”. Në veçanti, ky qëllim lidhet me nënobjektivin nr. 16.3 “Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë”, me nënobjektivin nr. 16.6 Zhvillimi i institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet dhe me nënobjektivin 10.2. “Deri në vitin 2030, fuqizimi dhe promovimi i përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve, pavarësisht moshës, gjinisë, aftësive të kufizuara, racës, përkatësisë etnike, origjinës, fesë, gjendjes ekonomike ose ndonjë gjendjeje tjetër”.

Objektivi specifik 3.1: Qasje për çdo fëmijë në ndihmën juridike të ofruar nga profesionistë të trajnuar dhe informacioni me gjuhë miqësore për çdo fëmijë.

Nga analiza e zbatimit të strategjisë së mëparshme rezulton se janë ngritur 10 (dhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore, janë licencuar 12 organizata të shoqërisë civile (OSHC) dhe klinika të ligjit pranë institucioneve të Arsimit të Lartë që ofrojnë ndihmë juridike parësore, si dhe kanë ofruar ndihmë juridike dytësore 159 avokatë. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) në bashkëpunim me institucione dhe partnerë të tjerë kanë organizuar aktivitete sensibilizuese me fokus njohjen e drejtësisë penale për të mitur. Me gjithë progresin e bërë në funksion të këtij objekti, disa sfida adresohen për zgjidhje si: përcaktimi i një numri të mjaftueshëm të profesionistëve të trajnuar/specializuar që ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore për të miturit, trajnimet vazhduese të tyre me qëllim ofrimin e ndihmës juridike, që udhëhiqet nga interesi më i lartë i fëmijës, dhënia e informacioneve me një gjuhë miqësore për çdo fëmijë. Duke qenë se mbrojtja e viktimës së mitur është risi në KDPM, ndihma juridike për viktimat, ofrimi i informacioneve të nevojshme për to është në fokus të veçantë.

Vlerësohet e nevojshme organizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere për fëmijët dhe prindërit në lidhje me ndihmën juridike, të fokusuar te fëmijët në risk për të qenë në të



ardhmen, fëmijë në kontakt/konflikt me ligjin. Në funksion të përmbushjes së këtij objekti, DNJF duhet të mbledhë dhe të përpunojë në mënyrë sistematike të dhëna të detajuara për fëmijët që marrin ndihmë juridike parësore/dytësore, të disagreguara sipas moshës, gjinisë, pozitës së tyre në procedimet dhe proceset gjyqësore, si dhe të dhëna të tjera demografike.

Përmbushja e këtij objekti do të sjellë fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve që ofrojnë ndihmë juridike parësore/dytësore; rritje të njohurive të fëmijëve për të drejtat dhe mekanizmat ligjorë, rritje të kërkesës për zbatimin e garancive ligjore, pjesëmarrje dhe dëgjimi më i mirë i fëmijës në proceset gjyqësore.

Rezultati i pritshëm

i. Deri në fund të vitit 2026, ndihma juridike cilësore falas do të ofrohet për çdo fëmijë që do të ketë nevojë për këtë shërbim.

Lidhja e objektit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekti specifik 3.1 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” nenin 2 dhe me nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat

III.1.1. Fuqizimi i kapaciteteve të ndihmës juridike parësore/dytësore falas për çdo fëmijë me fokus të veçantë fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të veprave penale fëmijët e prekur dhe të përfshirë në procese familjare, civile, ose që ndikohen nga vendimmarrja e gjykatave në zonat ku ky shërbim është ngritur.

III.1.2. Përcaktimi në listën e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore, të avokatëve të specializuar në të drejtat e fëmijës dhe drejtësinë miqësore për fëmijët dhe bërja publike e listës në faqen zyrtare të Dhomës Avokatisë së Shqipërisë dhe në prokurori dhe gjykata.

Treguesit kryesorë

III.1.a Përqindja në rritje e fëmijëve të cilët marrin ndihmë juridike cilësore falas.

III.1.b Numri i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere në terren në lidhje me ofrimin e

ndihmës ligjore falas në zona ku ka fëmijë më të riskuar për të qenë në kontakt/konflikt me ligjin.

III.1.c Numri i ekipeve të lëvizshme në terren që ofrojnë ndihmë juridike falas.

Objekti specifik 3.2: Shërbime të drejtësisë miqësore për çdo fëmijë të ofruara në mjedise të aksesueshme për ta.

Nga analiza e zbatimit të SDM 2018–2021 rezultoi se është bërë progres lidhur me këtë objekt, janë përshtatur mjedise miqësore në 16 struktura të policisë;⁵¹ janë trajnuar një pjesë e punonjësve të policisë për teknikat e intervistimit dhe çështjet e të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin. Përshtatja e mjedisve miqësore për të mitur është kryer në 6 gjykata⁵² dhe në 9 prokurori⁵³ pranë gjykatës së shkallës së parë.

Me gjithë progresin e bërë, në funksion të këtij objekti parashikohet vijimi i krijimit të mjedisve miqësore në polici, gjykata dhe prokuroritë e krijuara sipas hartës gjyqësore të miratuar, duke i kushtuar vëmendje aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, fokusi do të jetë mirëmbajtja e mjedisve të intervistimit të krijuara dhe përdorimi i tyre; përdorimi i teknologjisë audio-video në pyetjen e të miturve dëshmitarë, viktimë ose autorë të veprave penale; respektimi i udhëzimeve, teknikave të intervistimit dhe të vlerësimit të fëmijës, të hartuara në kuadër të Programit Shqiptaro–Suedez të Drejtësisë Penale për të Mitur në polici, prokurori dhe gjykata, burgje dhe në shërbimin e provës; shërbime mbështetëse nga psikologë dhe punonjës socialë të specializuar për fëmijët të disponueshëm në çdo kohë, në çdo institucion dhe për çdo fëmijë.

Përmbushja e këtij objekti do të sjellë shërbime të specializuara të drejtësisë miqësore të ofruara në mjedise, që miqësore dhe të

⁵¹ Komisariati i Policisë nr. 3 Tiranë, DVP Durrës, DVP Shkodër, DVP Vlorë, Komisariati i Policisë nr. 5 Tiranë, Komisariati i Policisë nr. 6 Tiranë, DVP Lezhë, Komisariati i Policisë Kurbin, DVP Elbasan, DVP Berat, DVP Gjirokastrë, DVP Dibër, DVP Kukës, DVP Fier, Komisariati i Policisë Sarandë, Komisariati i Policisë Korçë.

⁵² Gjykata e Apelit Gjirokastrë, Gjykata e Apelit kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Gjykata e Shkallës së Parë kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵³ Elbasan, Shkodër, Durrës, Fier, Korçë, Berat dhe Tiranë.



aksesueshme për çdo fëmijë që është në kontakt ose konflikt me ligjin; zgjerimin e shërbimeve miqësore në territor dhe marrjen e shërbimeve nga çdo fëmijë. Rritja e cilësisë së intervistimit të fëmijës në çdo status që ka sipas KDPM-së nga policia, do të mundësojë shmangien e ripyetjes së tij dhe përdorimin e regjistrimit audio dhe video si provë në fazat e tjera në prokurori dhe gjykatë. Duke u nisur nga e drejta e fëmijës të marrë pjesë dhe të dëgjohet në proces, është e vlerësuar e domosdoshme matja e nivelit të kënaqësisë së fëmijëve lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara ndaj tyre në polici, prokurori dhe gjykata.

Rezultati i pritshëm

i. Deri në fund të vitit 2026, në të gjitha komisaritet e policisë, gjykatat dhe prokuroritë do të kenë përfunduar dhe do të jenë funksionale mjediset miqësore për fëmijët.

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së sipas MSA

Objekti i specifik 3.2 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” nenin 2 dhe me nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat

III.2.1 Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin të ofruara në mjediset miqësore në komisaritet e policisë.

III.2.2 Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin të ofruara në mjediset miqësore në gjykata e krijuara sipas hartës gjyqësore të miratuar.

III.2.3 Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin të ofruara në mjediset miqësore në prokuroritë e krijuara nga harta gjyqësore e miratuar.

III.2.4 Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin të ofruara në mjediset miqësore në zyrat territoriale të shërbimit të provës.

III.2.5 Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët të ofruara në mjediset miqësore në zyrat e shërbimit përmbarrimor gjyqësor.

Treguesit kryesorë të rezultateve për objektivin specifik 3.2:

III.2/a Numri i institucioneve, polici, prokurori, gjykata, zyra territoriale të shërbimit të provës, zyrat e shërbimit përmbarrimor gjyqësor, të cilët ofrojnë shërbime për fëmijët në kontakt/ konflikt me ligjin në mjediset miqësore në zonat e targetuara.

Objekti i specifik 3.3: Shërbime mbështetëse të standardizuara dhe të arritshme për çdo fëmijë.

Bazuar në gjetjet e analizës së zbatimit të SDM-së 2018–2021 në lidhje me numri i profesionistëve të trajnuar për çështjet e të miturve, udhëzime dhe manualeve të hartuara për rolin e psikologut në procesin penal ku përfshihet i mituri në konflikt/ kontakt me ligjin, në proceset civile dhe familjare ku fëmija merr pjesë, në këtë objektiv është vënë theksi në vijimin e trajnimit të gjithë profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët; në krijimin e kushteve që ata të jenë të pranishëm në çdo moment që fëmija paraqitet në polici, prokurori ose gjykatë ose aty ka ai nevojë për mbështetje nga persona të specializuar.

Me gjithë progresin e bërë, shërbimet mbështetëse për çdo fëmijë duhet të shtrihen në territor dhe të mundësohen për çdo fëmijë, veçanërisht fëmijëve viktimë të veprave penale; këto shërbime duhet të jenë të plotësuara me burimet e njerëzore të nevojshme dhe me profesionistë të trajnuar/specializuar (avokatë, psikologë, punonjës socialë, punonjës në njësitë e mbrojtjes së fëmijës, përfaqësues procedural, mjekë ligjor të specializuar), për të ofruar shërbime të drejtësisë miqësore për fëmijët në institucionet që punojnë me dhe për fëmijën dhe sipas nevojave të çdo fëmije. E drejta e viktimës për dëmshpërblim nga autori ose shteti vijon të mbetet e përcaktuar në praktikë.

Drejtësia miqësore për fëmijët përfshin qasje në shërbime mbështetëse me standarde, të arritshme në çdo kohë dhe për çdo fëmijë. Me qëllim lehtësimin e procedurave për marrjen e shërbimeve mbështetëse nga fëmijët në procesin civil, familjar dhe penal, në çdo status të fëmijës, veçanërisht fëmijët viktimë, parashikohet krijimi i një grupi psikologësh dhe punonjësish socialë, të specializuar për drejtësinë e të miturve si pjesë e strukturës së policisë, prokurorisë, gjykatës që mbështesin fëmijën në çdo proces. Gjithashtu, risi është hartimi



i programit të kompensimit të viktimës së mitur të veprës penale nga autori ose shteti.

Përmbushja e këtij objekti do të sjellë respektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, mbështetje psikologjike për fëmijët në çdo status që fëmija ka në proces; vendimmarrje do të jenë në interesin më të lartë të fëmijës dhe do të parandalohet riviktimizimi jo vetëm i fëmijës që është në kontakt ose konflikt me ligjin, por edhe në proceset civile, familjare ose administrative. Gjithashtu, e drejta e fëmijës për pjesëmarrje dhe për t'u dëgjuar në proces do të mundësohet për më shumë fëmijë.

Rezultati i pritshëm

i. Të gjitha institucionet që punojnë me ose për fëmijët, deri në fund të vitit 2026 do të kenë kapacitet të plotë për të punësuar profesionistë të trajnuar për të ofruar shërbime të drejtësisë miqësore për fëmijët.

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekti specifik 3.3 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” nenin 2 dhe me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2022.

Masat

III.3.1 Plotësimi me burimet e nevojshme njerëzore (avokatë, psikologë asistues, punonjës socialë të specializuar, mjekë e infermierë ligjorë, përmbarues gjyqësor etj.) dhe të trajnuar për të ofruar shërbime të drejtësisë miqësore për fëmijët tek institucionet që punojnë me dhe për fëmijën.

III.3.2 Krijimi i një grupi psikologësh dhe punonjësish socialë të specializuar si pjesë e strukturës së policisë, prokurorisë dhe gjykatës që asistojnë fëmijën në çdo proces ku fëmija merr pjesë.

III.3.3 Hartimi i një programi për shpërblimin e dëmit shkaktuar fëmijës viktimë nga autori e veprës penale ose shteti.

Treguesit kryesorë të rezultateve:

III.3/a Numri i institucioneve të drejtësisë penale për të mitur në zonat e targetuara: polici,

gjykatë, prokurori të cilat kanë ngritur një strukturë të dedikuar pranë tyre për ofrimin e shërbimeve psikologjike

III.3/b Programi për shpërblimin e dëmit shkaktuar fëmijës viktimë nga autori i veprës penale ose shteti i përfunduar dhe miratuar.

III.3/c Numri i fëmijëve të cilët janë kompensuar si fëmijë viktimë e veprave penale nga autori ose shteti në zona të targetuara.

III.3/d Numri fëmijëve viktime të veprave penale regjistruar nga policia.

III.3/e Numri fëmijëve autorë të dyshuar të veprave penale regjistruar nga policia.

III.3/f Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të pandehur nën hetim të raportuar nga prokuroria.

III.3/g Numri i fëmijëve viktime të veprave penale të raportuar nga prokuroria.

III.3/h Numri i fëmijëve autorë të dyshuar të veprave penale të trajtuar në gjykatë.

III.3/i Numri i fëmijëve viktime të veprave penale të trajtuara në gjykatë.

Qëllimi i politikës IV

Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

Bazuar në arritjet e objektivit 3 të SDM 2018–2021, “Parandalimi i ripërfshirjes së të miturve/të rinjve në krime”, në këtë qëllim politik është vënë theksi te ngritja e programeve të riintegritit dhe rishoqërimit të të miturit në konflikt me ligjin të parashikuara nga KDPM-ja që ende nuk janë funksionale, si dhe fuqizimin e QPKMR-së dhe programeve ekzistuese në nivel vendor. Gjithashtu, përmbushja e këtij qëllimi synon konsolidimin e praktikave të mira të shmangies së të miturit nga ndjekja penale dhe zbatimin e të gjitha masave alternative të shmangies të parashikuara nga KDPM-ja me fokus fuqizimin e programeve të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit për të miturit në konflikt me ligjin dhe mirë menaxhimit të rasteve të fëmijëve në kontakt ose në konflikt të ligjit nga grupi i profesionistëve në nivel vendor.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucione tjera, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e katër objektivave specifikë:



Objektivi specifik 4.1: Zgjerimi i mundësive të mbikëqyrjes së fëmijëve në konflikt me ligjin, përmes shmangies nga ndjekja penale/dënimi.

Objektivi specifik 4.2: Programe të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit të mundësuar për fëmijën në konflikt me ligjin ose viktimë e veprave penale, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Objektivi specifik 4.3: Struktura mbikëqyrëse që garantojnë trajtimin miqësor, rishoqërimin, rehabilitimin e fëmijës në konflikt me ligjin.

Objektivi specifik 4.4: Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve ka kapacitetet e duhura në fushën e parandalimit të ripërfshirjes së të miturit në kryerjen e veprave penale.

Objektivi specifik 4.5: Fuqizimi i rrjetit të bashkëpunimit ndërinstitucional të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijën.

Lidhja midis qëllimit të politikës IV dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i politikës IV lidhet me objektivin nr. 16 (OZHQ), i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ngritjen e institucioneve të dobishme, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, lidhet me nënobjektivin 16.2 “Mbrotjtja e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe dhuna”; nënobjektivi 16.a “Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin”, si dhe nënobjektivin nr. 16.b “Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve jodiskriminuese”.

Objektivi specifik 4.1: Zgjerimi i mundësive të mbikëqyrjes së fëmijëve në konflikt me ligjin, përmes shmangies nga ndjekja penale/dënimi.

Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2021, tregon se 704 të mitur janë proceduar penalisht për kryerjen e një veprave penale; për 251 çështje me 283 të pandehur të mitur është vendosur pushimi i procedimit penal për shkak të zbatimit të masës së shmangies, ndër të cilat për 1 (një) të mitur me konfliktin me ligjin është vendosur ndërmjetësimi; për 4 (katër) të mitur

është vendosur paralajmërimi me gojë dhe për 233 të mitur është zbatuar paralajmërimi me shkrim.⁵⁴ Gjatë vitit 2020 rezultoi se janë regjistruar 525 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale dhe ndaj 31 prej tyre është vendosur masë sigurimi arrest në burg, ose për rreth 5, 90 për qind e të miturve; prokurori ka vendosur mosfillimi e procedimit penal për 39 referime/kallëzime penale; janë pushuar 199 çështje dhe janë dërguar për gjykim 146 çështje. 87, 44 për qind e çështjeve të pushuara janë pushuar për shkak të zbatimit të masës alternative të shmangies.⁵⁵ Për sa i përket aplikimit të llojeve të masave alternative të shmangies, nga të dhënat rezultoi se shmangia është zbatuar në 213 raste, ndër të cilat në 7 raste është vendosur ndërmjetësimi, në 4 raste këshillim për të miturin dhe familjen, në 13 raste është vendosur paralajmërim me gojë dhe në 189 raste është vendosur paralajmërim me shkrim.

Në zbatim të objektivave të strategjisë së mëparshme, Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje me disa bashki për trajtimin e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin, ndaj të cilëve është dhënë masa alternative e shmangies nga dënimi dhe ndjekja penale. Shërbimi i Provës si pjesë ka bashkëpunuar me qendrat sociale për trajtimin e të miturve për të cilët ishte vendosur masa e shmangies e dhënë nga Prokuroria/Gjykata. UNICEF-i dhe Save the Children në bashkëpunim me Bashkinë Berat dhe Gjyrokastër identifikuan dy qendra komunitare të cilat të mund të përdoren për të lehtësuar masën e shmangies për disa të mitur dhe që këto mjedise të përdoren edhe si vendtakime mes fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin dhe profesionistët e ndryshëm që merreshin me menaxhimin e rasteve të tyre duke vendosur në Berat dhe Gjyrokastër fillesat konceptit të Barnahus. Ndërhyrje të tilla u realizuan në Pukë dhe Shkodër.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, shihet qartë se masat alternative të shmangies nuk kanë zbatim të njëjtë dhe disa prej tyre janë zbatuar shumë pak. Një nga masat më të zbatuara është paralajmërimi me shkrim i të miturit nga prokurori dhe shumë më

⁵⁴ Shih Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit 2021, f. 185-186.

⁵⁵ Shih Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit 2020, f. 205-206.



pak masat e tjera, sidomos drejtësia restauruese/ndërmjetësimi dhe menaxhimi i rastit nga një grup profesionistësh për të adresuar më efektivitet të gjitha nevojat e fëmijës dhe parandalimin e rifutjes së tij në kryerjen e veprave penale.

Në dallim nga strategjia e mëparshme që synonte promovimin e zbatimit të masës së shmangies nga ndjekja penale, ky objektivi specifik synon zbatimin gjerësisht të masave alternative të shmangies, në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat e vendit, bazuar në vlerësimin e individual të të miturit nga ekspert ose grup shumëdisiplinor ose shërbimi i provës me qëllim adresimin e faktorëve kriminogjenë, rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve, si dhe të parandalojnë ripërfshirjen e tyre në vepra penale. Në këtë objektivi synohet të fuqizohen mekanizmat dhe strukturat për zbatimin e masave alternative të dënimit. Është e nevojshme të vlerësohet ndikimi i masës së shmangies në rifutjen në krim të të miturit dhe arsyeve të moszbatimit të masave të tjera të shmangies, të ndryshme nga ajo e paralajmërimit të shkrim.

Me përmbushjen e këtij objektivi synohet që të gjitha masat që parashikohen në ligj të zbatohet kur interesi më i lartë i fëmijës e kërkon atë dhe vendimmarrja të jetë e bazuar në një vlerësim të gjithanshëm të rrethanave dhe nevojave individuale të çdo fëmije. Gjithashtu, mbikëqyrja e të miturit nga një institucion i specializuar e pazbatuar deri tani të zbatohet kur interesi më i lartë i fëmijës e kërkon atë. Për rrjedhojë, numri i të miturve përsëritës të përgjithshëm ose specifikë do të ulet dhe të miturit në konflikt me ligjin do të jenë më të pranuar në familje, shkollë dhe shoqëri.

Rezultatet e pritshme

i. Deri në fund të vitit 2026, 90 për qind e fëmijëve në konflikt me ligjin kanë kaluar përmes shmangies nga ndjekja penale.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4.1 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, nenin 2 dhe me nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat

IV.1.1 Përmirësimi i informimit me një gjuhë miqësore për çdo fëmijë lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga zbatimi i masës alternative të shmangies nga ndjekja penale/dënimi.

IV.1.2 Konsolidimi i praktikave të mira në lidhje me zbatimin e kërkesave të KDPM për hartimin e raportit të vlerësimit të rrethanave individuale, familjare, shëndetësore, sociale etj. të të miturit në konflikt me ligjin nga eksperti ose grupi ekspertëve ose Shërbimi i Provës (kërkesë e nenit 22&3 të KDPM) ose Shërbimi i Provës (kërkesë e nenit 47 i KDPM-së).

IV.1.3 Vlerësimi një herë në vit i efektivitetit të zbatimit të standardeve të unifikuar, të hartimit të raportit dhe marrjes së mendimit të Njësisë për Mbrojtjen e Drejtave të Fëmijës në lidhje me përgatitjen e vlerësimit individual të fëmijës (bazuar në nenin 47&9 i KDPM-së).

IV.1.4 Forcimi i kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të zbatimit të masave alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale dhe referimi në programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin.

Treguesit kryesorë të rezultateve për objektivin specifik 4.1

IV.1.a. Përqindja në rritje e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin të cilët janë riintegruar në shoqëri.

IV.1.b. Përqindja në rritje e fëmijëve ndaj të cilëve është zbatuar masa alternative e shmangies nga ndjekja penale përkundrejt totalit të fëmijëve që janë proceduar përgjatë një viti.

IV.1.c. Përqindja në rritje e fëmijëve të cilët kanë kaluar përmes shmangies nga procedimi gjyqësor përkundrejt totalit të fëmijëve të ndjekur penalisht përgjatë një viti.

Objektivi specifik 4.2: Programe të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimin të mundësuar për fëmijën në konflikt me ligjin ose viktimë e veprave penale, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Bazuar në analizën e zbatimit të SDM 2018–2021, të dhënat zyrtare të PP-së dhe analiza e bërë për objektivin e mësipërm, rezultojnë se programet e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimin si masa të shmangies nga ndjekja penale ose si detyrim që duhet të përmbushë i mituri ndaj të cilët është zbatuar shmangia nga ndjekja penale ose procesi gjyqësor është zbatuar shumë pak në praktikë. Për



përmbushjen e këtij objektivi synohet zbatimi i programeve të drejtësisë restauruese/ndërmjetësimit me qëllim që të parandalohet mundësia e rifutjes në kryerjen e veprave penale të të miturit, të normalizohen marrëdhëniet autorë-viktimë, i mituri autor të kuptojë gabimin e bërë dhe të shprehë vullnetin për të riparuar dëmet e shkaktuara, si dhe i mituri të mos ripërfshihet në vepra penale.

Rezultatet e pritshme

i. Deri në fund të 2026-s, të gjithë fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin ose viktimë e veprave penale në zonat e targetuara do t'u ofrohen programe të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objekti specifik 4.2 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” nenin 2 dhe me nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat

IV.2.1 Krijimi dhe konsolidimi i strukturave përgjegjëse të dedikuara për fëmijët në polici, që janë njohës të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit në bashkitë të caktuara (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë, Korçë).

IV.2.2 Plotësimi i dhomave vendore të ndërmjetësuesve me ndërmjetësues të trajnuar/specializuar për shërbime miqësore për fëmijët.

IV.2.3 Nxitja, aplikimi dhe zbatimi i masave të tjera alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale që burojnë nga neni 63 dhe 68 të KDPM-së.

Treguesit kryesorë të rezultateve për objektivin specifik 4.2

IV.2.a Numri i fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin ose viktimë e një veprë penale në zonat e targetuara të cilët marrin shërbimin e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit në përputhje me interesin më të lartë të tyre.

IV.2.b Përqindja e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin ose viktimë e një veprë penale në zonat e

targetuara që janë të kënaqur me shërbimin e ndërmjetësimit/drejtësisë restauruese.

Objekti specifik 4.3: Struktura mbikëqyrëse që garantojnë trajtimin miqësor, rishoqërimin, rehabilitimin e fëmijës në konflikt me ligjin.

Për sa i takon strukturave mbikëqyrëse të kufizimit të lirisë së të miturit në konflikt me ligjin synohet të krijohet një arkitekturë e re, që do të përfshijë institucionet zinxhir të zbatimit të drejtësisë penale për të mitur si institucioni për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Rezultatet e pritshme

i. 70 për qind e strukturave mbikëqyrëse do të garantojnë trajtimin miqësor, rishoqërimin, rehabilitimin e fëmijës në konflikt me ligjin deri në fund të vitit 2026.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objekti specifik 4.3 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” nenin 2 dhe me nenin 78 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat

IV.3.1 Ngritja dhe funksionimi i Institucionit për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin.

IV.3.2 Fuqizimi i programeve të formimit profesional, edukuese, ripërtëritëse, rehabilituese dhe riintegruese për fëmijët në institucionin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të miturit.

IV.3.3 Fuqizimi i mekanizmit të sistemit të referimit për riintegrim në shoqëri të të rinjve në konflikt me ligjin, në bashkëpunim me institucione shtetërore përgjegjëse për arsimin, formimin profesional, punësimin, shëndetësinë dhe përkrahjen sociale, bashkitë, shoqërinë civile, komunitetin e biznesit dhe familjen.

IV.3.4 Aplikimi më i gjerë i qasjes i vizitave të specialistit të Shërbimit të Provës për vizita në familje, shkollë, qendra komunitare etj.



IV.3.5 Fuqizimi i bashkëpunimit mes Shërbimit të Provës, organeve të vetëqeverisjes vendore në njësinë administrative, QPKMR, NJMF, dhe IEVP për riintegrimin e të miturit.

IV.3.6 Fuqizimi i bashkëpunimit mes Shërbimit të Provës dhe (IEVP) për zbatimin e masave alternative të dënimit me burgim dhe hartimin e një raporti vlerësimi individual të të miturit.

IV.3.7 Vlerësimi periodik i recedivizmit të fëmijët dhe të rinjtë (18-21 vjeç) dhe përgatitja e një raporti me masa konkrete për parandalimin e kriminalitetit dhe uljen e recidivizimit.

Treguesit kryesorë të rezultateve për objektivin specifik 4.3

IV.3.a Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) në paraburgim.

IV.3.b Përqindja e fëmijëve (14–18 vjeç) në burgim përkundrejt totalit të fëmijëve në institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale përgjatë një viti.

IV.3.c Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të trajtuar nga Shërbimi i Provës.

IV.3.d Përqindja e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin ose viktimë e një veprë penale në zonat e targetuara që janë të kënaqur me drejtësinë miqësore të marrë në institucionet e drejtësisë (polici, prokurori, gjykatë, IEVP, shërbim prove).

IV.3.e Ngritja dhe funksionimi i Institucionit për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Objektiivi specifik 4.4 Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka kapacitetet e duhura në fushën e parandalimit të ripërfshirjes së të miturit në kryerjen e veprave penale.

QPKMR-ja e krijuar në zbatim të KDPM ka një rol kyç në mbështetjen e të miturve dhe të rinjve përgatitjen për lirim e të miturit të dënuar, pas kryerjes së dënimit penal ose të liruuar me kusht, si dhe përgjatë kohëzgjatjes së lirit me kusht. QPKMR-ja luan një rol të rëndësishëm për ndërgjegjësimin e shkollës, familjes dhe komunitetit që do të mirëpresë të miturit e rikthyer pas përfundimit të dënimit. Gjithashtu, QPKMR-ja është përgjegjëse për menaxhimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. Raportprogresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021 thekson se QPKMR-ja me stafin tashmë plotësisht në funksion, duhet të përparojë në kryerjen e mandatit të saj dhe të demonstrojë

efektin e saj në situatën e fëmijëve në konflikt ose në kontakt me ligjin.

Disa sfida që kanë nevojë të adresohen dhe të zgjidhen me zbatimin e strategjisë se re janë:

Ky sistem është operacional, por një nga sfidat e tij është popullimi me të dhëna në kohë nga të gjitha institucionet që kanë detyrimin të mbledhin dhe të përpunojnë të dhëna për drejtësinë penale për të mitur. Në këtë kontekst, parashikohet ky objektivi specifik në SDM 2018–2022, për forcimin dhe rritjen e kapaciteteve të QPKMR-së, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve për mbështetjen e të miturit në përgatitjen për lirim, pas lirit me kusht ose pas kryerjes së dënimit.

Rezultatet e pritshme

i. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, deri në fund të vitit 2026, do të ketë ngritur mjaftueshëm kapacitetet për të funksionuar në fushën e parandalimit të ripërfshirjes së të miturit në kryerjen e veprave penale, si dhe në gjenerimin e statistikave për fëmijë në konflikt/kontakt me ligjin.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektiivi specifik 4.4 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” nenin 2 dhe me nenin 78 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat

IV.4.1 Fuqizimi i kapaciteteve të QPKMR mes trajnimeve në lidhje me zbatimin e dy programeve:

a) mbështetja e të miturit pas lirit me kusht;

b) mbikëqyrja pas kryerjes së dënimit, si dhe teknikat e komunikimit.

IV.4.2 Vlerësimi i nevojave për ndërhyrje në legjislacion dhe përcaktimi i rolit dhe përgjegjësi të QPKMR-së për çështje të përdorimit apo aksesimit të të dhënave në Sistemin e integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

IV.4.3 Funksionimi dhe përdorimi me efikasitet të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur si burim statistikor që i vjen në ndihmë analizimit të problematikave të cilat lidhen



me të drejtat e fëmijëve. (Orientimi i përmirësimit të politikave për një drejtësi të drejtë dhe të shpejtë për çdo fëmijë në kontakt/konflikt me ligjin.)

Treguesit kryesorë të rezultateve për objektivin specifik 4.4

IV.4.a Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara nga QPKMR me të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegrit të të miturve në konflikt me ligjin

IV.4.b Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur në konflikt/kontakt me ligjin funksionon plotësisht dhe gjeneron raporte statistikore të cilat publikohen çdo vit.

Objektivi specifik 4.5 Fuqizimi i rrjetit të bashkëpunimit ndërinstitucional të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijën.

Gjatë zbatimit të “SDM 2018–2021”, një rrjet ndërinstitucional është krijuar në nivel vendor në disa bashki si Berat, Gjirokastrë, Pukë, Shkodër që menaxhon rastet e fëmijëve në konflikt/ kontakt me ligjin bazuar në një qasje ndërdisiplinore. Ky model ka nevojë të vlerësohet dhe në bazë të gjetjeve të përmirësohet, të vlerësohet mundësia e zbatimit të tij në bashki të tjera. Gjatë zbatimit të “SDM 2022–2026” synohet të forcohet rrjeti ndërinstitucional në nivel vendor, në bashkitë ku rrjeti është ngritur, të konsolidohet qasja shumë disiplinare e rastit, të qartësohet roli i çdo institucioni që përfshihet në menaxhimin e të miturit në kontakt/konflikt me ligjin, duke synuar parandalimin e kontakteve të fëmijëve me sistemin e drejtësisë penale.

Gjithashtu bazuar në vlerësimin e përvojave në katër bashkitë, është parashikuar që rrjeti ndërinstitucional do të ngrihet në tre bashki të reja gjatë zbatimit të “SDM 2022–2026”.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4.5 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, nenin 2 dhe nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Rezultatet e pritshme

i. Rrjeti ndërinstitucional në nivel vendor për sistemin e drejtësisë për fëmijën funksionon dhe janë të qarta rolet e gjithsecilit me qëllim menaxhimin ndërdisiplinor të rastit dhe koordinimin efektiv mes tyre.

Masat

4.5.1 Funksionimi i plotë i rrjetit ndërinstitucional në nivel vendor për sistemin e drejtësisë për fëmijën, si dhe përcaktimi i rolit të gjithsecilit me qëllim menaxhimin e rastit dhe koordinimin efektiv mes tyre.

4.5.2 Monitorimi i funksionimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për trajtimin e të miturve në kontakt/konflikt me ligjin në nivel vendor dhe respektimi i memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar nga institucionet kryesore në nivel vendor.

Treguesit kryesorë

IV.5.a Grupi i profesionistëve në nivel vendor që punojnë me dhe për fëmijën, në 7 bashki të vendit, krijuar dhe funksional.

PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

1. Përgjegjësia e institucioneve

Fushat e politikave të përfshira në “SDM 2022–2026” përcaktojnë qartë ministritë e linjës, institucionet në varësi të tyre, si dhe institucionet e tjera të pavarura që janë përgjegjëse për zbatimin e tij. Një sërë institucione janë angazhuar në hartimin dhe konsultimin e strategjisë dhe do të jenë përgjegjëse për zbatimin e saj.

Institucionet e pavarura:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë
- Prokuroria e Përgjithshme
- Avokati i Popullit
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Radio Televizioni Shqiptar
- Autoriteti i Medias Audiovizive
- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
- Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë
- Urdhri i Psikologut
- Urdhri i Punonjësit Social
- Shkolla e Magjistraturës



- Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Ministritë e linjës dhe institucionet varësie:

- Ministria e Drejtësisë

- Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Ministria e Brendshme

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

- Ministria e Arsimit dhe Sportit

- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës

- Akademia e Sigurisë

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

- Shërbimi Social Shtetëror

- Departamenti i Administratës Publike

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

- Instituti i Mjekësisë Ligjore

- Qendra e Botimeve Zyrtare

- Drejtoria e Shërbimit të Provës

- Komiteti Shqiptar i Birësimeve

- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit

- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

- Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve

2. Zbatimi, llogaridhënia dhe koordinimi

Zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i “SDM 2022–2026” do të arrihet përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit.

Kuadri monitorues do të shërbejë për orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e resurseve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për

zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, në bazë të të cilit është ngritur dhe funksionon Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi.

Komiteti Drejtues Sektorial/Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror për çështjet e fëmijëve është grupi ku do të diskutohen çështje të ecurisë së zbatimit të objektivave dhe masave të “SDM 2022–2026” dhe ku do të realizohet bashkëpunimi ndërinstitucional me grupet e interesit.

Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror, do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë dhe do të ketë në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet e tjera ligjzbatuese, që janë përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e treguesve në kompetencën e tyre, duke krahasuar objektivat e treguesve të performancës së planifikuar me ata aktualë. Ky rrjet do të mbështetet në veprimtarinë e tij nga Sekretariati Teknik (ST), i cili do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë.

Sekretariati Teknik krijohet me urdhër të ministrit të drejtësisë duke siguruar përfshirjen e strukturave të duhura. Struktura që është përgjegjëse për monitorimin e strategjive në Ministrinë e Drejtësisë do të ushtrojë funksionin e ST-së të rrjetit ndërinstitucional në nivel qendror për çështjet e fëmijëve.

Sekretariati Teknik do të ketë këto detyra:

a) mbledh, analizon dhe vlerëson kontributin për çdo aktivitet dhe çdo tregues nga institucionet raportuese;

b) komunikon tek institucionet vendimet e Komitetit Drejtues Sektorial së bashku me udhëzimet e lëna nga ky i fundit;

c) harton raportin e zbatimit të integruar çdo gjashtë muaj dhe në bazë vjetore;

d) publikon vendimet e marra dhe dokumentet e miratuara;

e) përgatit agjendat dhe dokumentacionin e duhur për mbledhjet që do të zhvillohen sipas rregullores së brendshme për Monitorimin e Strategjisë dhe Grupin e Punës.

f) harton minutat e mbledhjeve dhe e shpërndan tek të gjithë anëtarët e Rrjetit.

Në aspektin cilësor të monitorimit, ST mund të sugjerojë të përdorë metodat e mëposhtme për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë:



a) përditësimin e përmbushjes apo jo të masave, sipas Planit të Veprimit dhe në bazë të vetëvlerësimit të institucioneve;

b) vlerësime tematike (sipas objektivave specifike të “SDM 2022–2026”), sipas udhëzimeve të mekanizmit vlerësues, lidhur me efektivitetin e veprimeve të ndërmarra;

c) komunikimin me palë të treta dhe shoqërinë civile për vlerësimin e masave të zbatuara;

Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror për zbatimin dhe monitorimin e strategjisë mbledh dhe analizon raportet periodike të masave për zbatimin e Planit të Veprimit të këtij dokumenti strategjik, vlerësimin e ecurisë së treguesve të performancës, propozon rekomandime, bazuar në gjetjet e raporteve periodike etj.

Çdo institucion i përfshirë në Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, raporton çdo 6 muaj dhe në bazë vjetore për nivelin e zbatimit të çdo objekti strategjik dhe aktiviteti, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Një raport përmbledhës i rezultateve të arritura nga zbatimi i “SDM 2022–2026”, analiza e performancës në 5 vite e treguesve, mësimet e nxjerra, histori suksesi etj. do të finalizohet pas përfundimit të afatit kohor të këtij plani, në muajin mars të vitit 2027.

Raportimet periodike të monitorimit të zbatimit të “SDM 2022–2026” do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë.

Rrjeti Ndërinstitucional në Nivel Qendror do të zhvillojë mbledhje të paktën dy herë në vit.

Objekti i mbledhjeve do të jetë kryesisht:

a) Vlerësim i progresit të arritur dhe niveli i zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për përmbushjen e objektivave strategjike të parashikuara.

b) Identifikimin e problematikave të hasura me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohën e duhur për të siguruar realizimin, pajtueshmërinë dhe koordinimet e duhura në lidhje me Planin e Veprimit/aktivitetet/rreziqet/pasaporta e treguesve etj. deri në fund të vitit kalendarik;

c) Miratimin në parim të raporteve të monitorimit të përgatitura nga Sekretariati Teknik.

Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit Ndërinstitucional në nivel qendror do të parashikohen në rregulloren që do të miratohet nga ministri i Drejtësisë pas miratimit të “SDM 2022–2026”.

Grupi koordinues i partnerëve ndërkombëtarë që do të mbështesin zbatimin e “SDM 2022–2026” do të jetë një mekanizëm i fuqishëm i cili do të kontribuojë në shmangien e mbivendosjeve dhe mospërputhjeve gjatë zbatimit të masave të “SDM 2022–2026”. Ky grup do të mbledhet në mënyrë të rregullt dy herë në vit ku partnerët do të diskutojnë masat e implementuara, rezultatet e arritura dhe projektet e ardhshme në mbështetje të SDM-së 2022–2026.

3. Sistemi i monitorimit dhe raportimit të “SDM 2022–2026”

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raporte gjashtë mujore dhe vjetore monitorimi dhe vlerësimi bazuar në standardet IPSIS për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në Planin e Veprimit të “SDM 2022–2026”. Plani i Veprimit si pjesë e këtij dokumenti strategjik, duke marrë në konsideratë shkallën e mobilizimit të burimeve financiare për zbatimin e tij, do të rishikohet çdo 2–3 vjet për të siguruar në këtë mënyrë një vlerësim real për zbatimin e tij.

Ministria e Drejtësisë do të përdorë metodologjinë e monitorimit të bazuar në standardet IPSIS që do të përcaktojnë se si do të kryhet procesi i monitorimit dhe vlerësimit me qëllim krijimin e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit të të dhënave të të gjitha institucioneve të përfshira në zbatimin e sistemit IPSIS.

Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të secilit objektiv dhe masë, mbi buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Për monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, në lidhje me zbatimin e masave, procesi i monitorimit do të realizohet në nivel objekti. Verifikimi i të dhënave të raportuara realizohet pjesërisht online për të garantuar saktësinë e tyre. Përpunimi statistikor i të dhënave kryhet me anë të shifrimit të përgjigjeve sipas raporteve të marra. Këto raporte janë kryesisht të karakterit narrativ, por edhe statistikor duke përdorur treguesit e rezultateve.

Në përputhje me procedurat që do të ndiqen për raportim dhe monitorimin në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë



11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)”, për përgatitjen e raporteve të monitorimit do të ndiqen fazat e mëposhtme.

Faza 1: Marrja e të gjithë kontributeve nga institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit;

Faza 2: Dërgimi i paketës së plotë për vlerësim pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), në Kryeministri në përputhje me standardet e sistemit. Paketa e plotë do të duhet të përfshijë materialet e mëposhtme:

2.1 Raport-Progresin e konsoliduar në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e agjendës së mirëqeverisjes;

2.2 Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën referuese në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e agjendës së mirëqeverisjes;

2.3 Pasaportën e treguesve në përputhje me standardet e sistemit IPSIS për periudhën referuese;

2.4 Bazën e të dhënave për vitin referues në zbatim të raportimit të treguesve të strategjisë;

Faza 3: Konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), në Kryeministri;

Faza 4: Organizimi i mbledhjes së KDS për konsultimin e paketës së konsoliduar dhe marrjen e komenteve nga aktorët;

Faza 5: Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së Raportit të Monitorimit;

Faza 6: Publikimi i raporteve të monitorimit.

Për sa i përket punës për monitorimin e zbatimit të “SDM 2022–2026”, përgjegjës do të jenë pikat e kontaktit për fëmijët në ministritë e linjës, si dhe në institucionet e pavarura, të cilët mbledhin të dhëna dhe identifikojnë boshllëqet e informacionit që nevojiten. Ministria e Drejtësisë ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit. Plani i Veprimit parashikon publikimin e progres raporteve 6-mujore dhe vjetore, mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile.

Përfaqësuesit në ministritë e linjës do të punojnë me përfaqësuesit në nivel rajonal dhe vendor për të përmirësuar cilësinë e të dhënave. Nevojitet ngritja

e kapaciteteve për të garantuar që të gjitha institucionet shtetërore përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të SDM 2022–2026 duke pasur në fokus interesin me të lartë të fëmijëve. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë, përmes Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, që në fillim të vitit 2023 dhe menjëherë pas miratimit të “SDM 2022–2026” do të marrë nismën për hartimin e formularëve të unifikuar dhe procedurat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave sasiore dhe cilësore për të gjithë treguesit e strategjisë, trajnimin dhe mentorimin e personave përgjegjës në çdo institucion raportues, duke përcaktuar qartë rolin dhe përgjegjësitë e tyre në mbledhjen e të dhënave deri në pikën fundore ku këto të dhëna gjenerohen.

Hartimi i formularëve të unifikuar të shoqëruara edhe me metodologjinë e mbledhjes së të dhënave për çdo tregues do të lehtësojë punën e Ministrisë së Drejtësisë për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave cilësore, punën e ministrive të linjës, si dhe institucioneve të pavarura, të cilat janë përgjegjëse për mbledhjen e informacionit të “SDM 2022–2026” dhe konkretizimin e tij në raporte periodike mbi progresin e arritur në drejtim të masave prioritare të parashikuara për periudhën 2022–2026.

Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur (SIDhDPM) është një instrument shumë i mirë për prodhimin e të dhënave statistikore në kohë reale të drejtësisë penale për të mitur. Konsolidimi i mëtejshëm i këtij sistemi të integruar dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve përdoruese të tij është një prioritet i vendosur në këtë strategji. Sfidë në raportimin e kësaj strategjie janë të dhënat për çështjet civile, familjare, administrative ku fëmija merr pjesë ose vendimmarrjet në këto procese ndikojnë te fëmijët. Ato do të kërkojnë unifikimin/standardizimin e formateve të mbledhjes së të dhënave nga të gjithë ofruesit e këtyre shërbimeve. Gjithashtu, të gjitha formularët e unifikuar të plotësuar me të dhëna nga institucionet përgjegjëse do të hidhen në një sistem (database në format Excel), i cili do të lehtësojë konsolidimin e të dhënave statistikore në nivel kombëtar dhe raportimin e ecurisë së treguesve dhe performancën e tyre kundrejt objektivave (*targets*) në mënyrë periodike.



Duke qenë se Ministria e Drejtësisë ka rol koordinues, drejtoria përgjegjëse e politikave dhe strategjive në fushën e drejtësisë brenda kësaj ministrie ka të nevojshme të forcojë kapacitetet e saj në fushën e Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V), në mënyrë që të koordinohet sa më mirë zhvillimi i politikave të drejtësisë miqësore për fëmijët. Kapacitetet në fushën e M&V do të ndihmojnë në:

- ndjekjen e burimit të të dhënave të treguesve;

- reagime mbi ecurinë e SDM-së;
- përmirësimi i efektivitetit të SDM-së;
- vendime bazuar në informacion;
- promovimi i llogaridhënies;
- demonstrimi i impaktit;
- identifikimi i mësimave të nxjerra.

Tabela e mëposhtme përcakton llojin e informacionit që do të mbledhet nga zbatimi i “SDM 2022–2026” dhe burimin e të dhënave:

Informacioni që do të mbledhet	Burimi i të dhënave
Procesi i zbatimit të “SDM 2022–2026” dhe progresi i tij.	- Të dhëna /relacione – të mbledhura në vazhdimësi (raporte, listëprezenca në trajnime, raporte të aktiviteteve ndërgjegjëse me fëmijët në konflikt/kontakt me ligjin, foto të aktiviteteve, relacione zyrtare, formularë me të dhëna sasiore etj.).
Arritja dhe suksesi i ndërhyrjes së “SDM 2022–2026” në cilësinë e shërbimeve të ofruara për fëmijët në çështjet penale, civile, familjare, administrative.	- Sondazhe të vogla me përfituesit kryesorë, siç janë intervistat me përfituesit e shërbimeve ose sondazhe mbi nivelin e kënaqësisë së shërbimit të marrë.
Arritja e ndërhyrjeve të medias të përfshira në “SDM 2022–2026”.	- Të dhëna për vlerësimet e mediave, regjistrat e broadcaster-it, analizat në Google, sondazhe të fëmijëve, prindërve, qytetarëve.
Arritja dhe suksesi i ndërhyrjes së programit në nivelin e popullsisë.	- Sondazhe me përfaqësues vendorë, qytetarë dhe përfitues shërbimesh.
Të dhëna cilësore në lidhje me rezultatet e ndërhyrjes.	- Fokus grupet, intervista të thelluara, diskutime të grupeve të synuara, raste studimore; - Studime – ndërthurja e të dhënave dhe sondazheve, një program kërkimor më sistematik që i përgjigjet një pyetjeje të caktuar; - Histori suksesi – përmbledhje rreth një fëmije apo grup fëmijësh që janë ndikuar pozitivisht nga zbatimi i “SDM 2022–2026”. Do të sigurohen përshkrime të “historive të suksesshme”, që janë shembuj konkret të arritjeve si rezultat i aktiviteteve të SDM-së të cilat dëshmojnë ndryshime ose përmirësime cilësore dhe sasiore drejt një drejtësie miqësore për fëmijët.

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE

Analiza e buxhetit për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026

Në këtë kapitull të strategjisë, paraqitet shpërndarja e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026. Kostimi i Strategjisë është realizuar mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, dhe vlerësimi i kostove indikative është mbështetur gjithashtu në objektivat dhe treguesit e përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në produktet e identifikuar për secilin aktivitet. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS-ja, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Procesi i kostimit u mbështet gjithashtu në konsultimin me Programin Buxhetor Afatmesëm 2023–2025 (faza II), në konsultimet me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit, si dhe në kostot historike nga zbatimi i strategjisë pararendëse, kostot e produkteve të PBA-së ose projekte të ngjashme.

Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i mbështetur në një detajim të hollësishëm të shpenzimeve për çdo aktivitet.

Gjatë procesit të kostimit janë identifikuar shpenzimet për secilin aktivitet dhe ato janë klasifikuar në kategori shpenzuese të paracaktuara, sipas formatit IPSIS mbi metodologjinë e kostimit. Për kategori të caktuara shpenzimesh, si: pagat, shpenzimet e trajnimit, seminarët, shpenzimet e udhëtimeve, shpenzimet e ekspertëve dhe disa kategori pajisjesh janë përdorur kostot standarde të



përcaktuara në metodologjinë e kostimit. Përlllogaritja e kostove është bërë sipas viteve financiare.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e planit të veprimit për zbatimin për zbatimin e Strategjisë të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 është rreth **3.4 miliardë lekë**, ose rreth

28.5 milionë euro. Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 118 lekë për 1 euro.

Tabela e mëposhtme, pasqyron kostot indikative, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 5 viteve të zbatimit të Planit të veprimit 2022–2026.


Qëllimi i Politikave	Natyrat/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2022-2026	Kostot e Planifikuara PBA 2022-2024 Buxheti	Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2025- 2026	Hendeku Financiar 2022-2026
Qëllimi i Politikës 1. Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimi të shoqërisë dhe fëmijëve.	Korente	368,812,459	152,763,233	84,137,568	131,911,658
	Kapitale	3,450,000	1,150,000	2,300,000	
Qëllimi i Politikës 2: Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë.	Korente	155,697,925	62,636,772	42,661,361	50,399,792
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës 3. Garanti i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë.	Korente	156,456,325	40,305,904	49,015,222	177,535,199
	Kapitale	112,378,000	1,288,000	690,000	
Qëllimi i Politikës 4. Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.	Korente	199,250,082	77,220,944	41,171,896	140,857,241
	Kapitale	2,367,838,000	634,388,000	1,673,450,000	
TOTALI [Leke]		3,363,882,790	969,752,853	1,893,426,047	500,703,890
TOTALI [Euro]		28,507,481	8,218,245	16,045,983	4,243,253
1 euro 118 Leke					

Tabela: Kostot indikative të SDM 2022 - 2026


Për periudhën afatmesme 2022–2024, kostoja është vlerësuar rreth 969.7 miliardë lekë, të cilat janë planifikuar në buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2023–2025, të institucioneve përgjegjëse. Për vitin financiar 2022 janë marrë në konsideratë e shpenzimeve e planifikuara.

Për periudhën 2025–2026, kostoja indikative për zbatimin e Strategjisë është 1.8 miliardë lekë. Për këtë periudhë është supozuar që për aktivitete të caktuara në Planin e Veprimit do të jenë në dispozicion fondet nga Buxheti i Shtetit për shpenzime korrente dhe investime. Pas vitit 2025, buxheti i shtetit pritet të financojë projektin e Ngritja dhe funksionimi i Institucionit për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Hendeku financiar për periudhën 2022–2026 është 500.7 milionë lekë ose **14.7% e kostos indikative**. Për periudhën 2022–2024, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën **27.0%**, ndërsa **56.4%** janë shpenzimet e planifikuara për periudhën 2025–2026, ku peshën kryesore e zënë shpenzimet për Institucionit për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin.

NDARJA E SHPENZIMEVE

Shpenzimet kapitale përbëjnë 74.0% të kostos indikative, kostot korrente 26.0%.

NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE
TË
Planit të Veprimit


Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë. Qëllimi i politikës IV, pritët të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e PV, përkatësisht **76.3 %**. Qëllimi i politikës I arrin në vlerën **11.1%**, qëllimi i politikës III **8.0%**, ndërsa qëllimi II **4.6%** të kostos së përgjithshme të planit.

ANNEX 1. PLANI I VEPRIMIT 2022–2026

ANNEX 2. MATRICA E MASAVE DHE AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022–2026

ANNEX 3. PASAPORTA E TREGUESVE



ANNEX 2. MATRICA E MASAVE DHE AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022–2026

LOGJIKA E NDËRHYRJES, INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE, AFATET KOHORE

Qëllimi politik 1:	Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve.			
Objektivi specifik 1.1:	Informim/edukim/ndërgjegjësim në bashkitë e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë.			
Rezultatet e pritshme:	Deri në fund të vitit 2026, 40 për qind më shumë fëmijë dhe prindër do të kenë njohuri mbi çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve për parandalimin e veprave penale ndaj tyre dhe të kryera prej tyre, si dhe të drejtën për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.			
MASA	AKTIVITETE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.1.1 Përmirësimi dhe pasurimi i programeve mësimore të lëndëve të fushës “Shoqëria dhe mjedisi” të arsimit parauniversitar në lidhje me njohuritë për të drejtat e fëmijës, për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, si dhe të drejtën për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.	1.1.1.1 Vlerësimi i programeve mësimore ekzistuese të lëndëve të fushës “Shoqëria dhe mjedisi” të arsimit parauniversitar.	MAS/ASCAP	ZVAP, OSHC, ekspertë	6 M II i 2023
	1.1.1.2 Diskutimi i gjetjeve dhe sugjerimeve me aktorët kryesorë përgjegjës në MAS dhe institucionet e tjera me qëllim kryerjen e përmirësimeve të nevojshme në programet mësimore përkatëse.	MAS/ASCAP	ZVAP, OSHC, ekspertë	6 M I i 2024
	1.1.1.3 Reflektimi i sugjerimeve të pranuar në programet mësimore përkatëse.	MAS/ASCAP	ZVAP, OSHC, ekspertë	6 M II i 2024
	1.1.1.4 Sesione formuese me mësues të angazhuar në zhvillimin e programeve mbi të drejtat e fëmijës në arsimin parauniversitar në bashkitë e targetuara.	MAS/ASCAP	ZVAP, OSHC, ekspertë, partnerë vendës/ndërkombëtarë	2023–2026
	1.1.1.5. Zhvillimi i veprimtarive, informuese/ndërgjegjësuere nga Avokati i Popullit me strukturat përgjegjëse me qëllim zhvillimin e programeve mësimore dhe programeve ekstra kurrikulare në arsimin parauniversitar.	AP, ZVAP	MAS, ASCAP, partnerë vendës/ndërkombëtarë	2022–2026
1.1.2 Monitorimi i zbatimit të programeve mësimore të përmirësuara në lidhje me të drejtat e fëmijës, parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, e drejta e çdo fëmijë për të pasur në çdo kohë qasje te shërbimet e drejtësisë miqësore për ta.	1.1.2.1 Takime/diskutime me mësues për mbledhjen e opinionit të tyre në lidhje me efektivitetin e programeve mësimore të lëndëve të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”.	MAS	ZVAP	2023–2026
	1.1.2.2 Anketa me fëmijë dhe prindër në lidhje me kënaqshmërinë e programeve mësimore.	ZVAP	MAS, OSHC, Partnerë, Senatet e shkollave	2023–2026
	1.1.2.3 Adresimi i gjetjeve dhe rekomandimeve tek organet përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e programeve	MAS/ ASCAP	DPAP, ZVAP	2023–2026



	parauniversitare.			
1.1.3 Programe informuese dhe ndërgjegjësuere që u mundësojnë fëmijëve të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën duke propozuar të ashtuquajturat “strategjitë e daljes”.	1.1.3.1 Programe informuese dhe ndërgjegjësuere që u mundësojnë fëmijëve të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën duke propozuar të ashtuquajturat “strategjitë e daljes”.	MSHRF	AKR, MAS, QPKMR, MB, OSHC	2024–2026
1.1.4 Promovimi dhe fuqizimi i programeve me një fokus të veçantë te prezenca virtuale e fëmijëve/të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta dhe mbrojtja ndaj bullizimit online.	1.1.4.1 Vlerësimi i programeve dhe mekanizmave ekzistues.	MSHRF	AKR, MAS, QPKMR, ASHDMF, OSHC,	2024
	1.1.4.2 Reflektimi i rekomandimeve të raportit të vlerësimit në programet ekzistuese.	MSHRF	MAS, AKCESK, ASHDMF, QPKMR, OSHC	2024
	1.1.4.3 Krijimi i hapësirave të sigurta virtuale dhe mbrojtja ndaj bullizimit online të fëmijëve.	AKCESK	MAS, DPPSH, MD, AKEP, ASHMDF	2024
	1.1.4.4 Takime me bordet e prindërve për informimin e tyre në lidhje me programet informuese.	MAS	ASHDMF, DPAP, ZVAP, QPKMR, DPPSH, OSHC	2024–2026
	1.1.4.5 Programe për parandalimin e formave të ndryshme të bullizimit në rrjetet sociale të zhvilluara në shkolla, në institucionet e kujdesit shoqëror dhe për fëmijët në risk.	MAS	QPKMR, ASHDMF, OSHC	2024–2026
1.1.5 Fuqizimi i sigurisë në shkolla.	1.1.5.1 Hartimi i një kalendari të takimeve dhe tematikave përkatëse nga oficeri i sigurisë në çdo shkollë (jo më pak se 4 takime në një vit shkollor) për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre.	DPPSH, MAS	DPAP, ZVAP, QPKMR, NJMF, UP, UPS, OSHC	2023 – 2026
	1.1.5.2 Takime periodike ndërgjegjësuere të punonjësve të policimit në komunitet me nxënësit, me qëllim informimin e tyre për rreziqet e viktimizimit dhe përfshirjes/shtytjes së fëmijëve në veprimtari kriminale. (Jo më pak se dy takime në një vit shkollor.)	DPPSH, MAS	DPAP, ZVAP, QPKMR, UP, UPS, NJMF, partnerë vendës/ndërkombëtarë	2023 – 2026
1.1.6 Zbatimi i programeve informuese dhe ndërgjegjësuere me fokus fëmijët që nuk ndjekin arsimin dhe prindërit e tyre, si dhe fëmijët në rrezik braktisje të arsimit të detyruar për të drejtat e tyre, për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të	1.1.6.1 Hartimi i një strategjie komunikimi për informimin e fëmijëve dhe prindërve, si dhe fëmijët në rrezik braktisje të arsimit të detyruar me fokus grupet e targetura.	Bashkitë	NJMF, DPPSH, OSHC, shkollat, studentë <i>pro bono</i> të shkencave sociale dhe të ligjit	6 M i I 2023



kryera prej tyre dhe për shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë. ⁵⁶	1.1.6.2 Takime periodike në komunitet të NJMF, SPZ dhe aktorëve të tjerë për të informuar fëmijët dhe prindërit, si dhe fëmijët në rrezik braktisje të arsimit të detyruar në lidhje me parandalimin e kryerjes/përfshirjes në vepra penale ose nga viktimizimi prej tyre.	NJMF	DPPSH, OSHC, shkollat, studentë <i>pro bono</i> të shkencave sociale dhe të ligjit	2023–2026
	1.1.6.3 Takime informuese derë më derë me prindër të fëmijëve të familjeve me probleme social.	NJMF/bashkitë	DPPSH, OSHC, shkollat, studentë <i>pro bono</i> të shkencave sociale dhe të ligjit	2023–2026
Metodologjia bazohet në numërimin e të gjitha vendimeve të ekzekutuar.	Vjetore	Vjetore	Rritës	Direkt	Shumatore e të gjitha vendimeve të ekzekutuar.	Data/Vitë	Gjinia e të mburit	Zona Rurale/Urbane	Trend rritës	2021		2022	10% më shumë se bazelina	2023	20% më shumë se bazelina	2024	30% më shumë se bazelina	2025	40% më shumë se bazelina	2026	50% më shumë se bazelina	Sa vendime të përmirësuar janë ekzekutuar në 2021?	16, 16.a, 16.b Page, drejtësi dhe institucione të forta		Promovimi i shqiptarëve pagjësorë dhe gjuhëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të drejtësisë, të përqendrime dhe gjuhëpërfshirëse në të gjitha rivjetet/Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha rivjetet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve ndërkombëtare.		
Metodologjia bazohet në numërimin (numërimin) në mënyrë manuale çdo viti të rekomandimeve të dhëna për përmirësimin të praktikave të drejtësisë mëgjore për fëmijët të adresuara nga rrejtë i gjyqndorëve/prokurorëve.	Vjetore	Vjetore	Rritës	Direkt	Shumatore e rekomandimeve të adresuara nga rrejtë i prokurorëve/gjyqndorëve.	Lloji i rekomandimit	Penale, civile, familjare, administrative	Adresuar nga prokurorët/gjyqndorët	Trend rritës	2021	0	2022	0	2023	2 rekomandime të adresuara	2024	4 rekomandime të adresuara	2025	6 rekomandime të adresuara	2026	8 rekomandime të adresuara	8 rekomandime të adresuara	0	16, 16.a, 16.b Page, drejtësi dhe institucione të forta		Promovimi i shqiptarëve pagjësorë dhe gjuhëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të drejtësisë, të përqendrime dhe gjuhëpërfshirëse në të gjitha rivjetet/Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha rivjetet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve ndërkombëtare.	
Ky indikator raportohet kur udhëzuesi është hartuar, miratuar dhe publikuar.	Vjetore	Vjetore	Rritës	Direkt	Raportohet "1" kur udhëzuesi është miratuar.	Data/Vitë	Data/Vitë	Data/Vitë	Trend rritës	2021	0	2022	0	2023	0	2024	1	2025	0	2026	0	1	0%	16, 16.a, 16.b Page, drejtësi dhe institucione të forta		Promovimi i shqiptarëve pagjësorë dhe gjuhëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të drejtësisë, të përqendrime dhe gjuhëpërfshirëse në të gjitha rivjetet/Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha rivjetet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve ndërkombëtare.	

Fletorja Zyrtare Viti 2023 – Numri 13



Fletorja Zyrtare  Viti 2023 – Numri 13

Fletorja Zyrtare

Viti 2023 – Numri 13

																								krizimi e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve joshkëmbues.	
Metodologjia bazohet në evidencën, rishikimin e programit fillestar dhe vazhduar të adresave cilësore dhe drejtësi për të mirat, koordinimi dhe bashkëpunimi e veprimet mbi të gjithë aktorët trajnuar në fushën për drejtësi për femijet dhe shkëmbime për femijet në kontakt/konflikt me ligjin me qëllim shtrëngim e mbivendosjeve, moshkoordinimi e veprimtarie dhe mundësitë e kujtimit të sinjerve.	Vjetore	Vjetore	Rritës	Direkt	Shumatore e programeve të formimit fillestar dhe vazhduar të rritësuar dhe të publikuara.	Logji i programit	Grupi i targetuar	Viti i rishikimit	Trend rritës	2021	20 programe	2022	8 programe të rritësuar	2023	8 programe të rritësuar	2024	8 programe të rritësuar	2025	8 programe të rritësuar	2026	8 programe të rritësuar	8 programe të rritësuar	20 programe	16, 16.a, 16.b Page, drejtësi dhe institucione të forta	Promovimi i shqiptive pagatore dhe gjyqësorë për zhvillim të qëndrueshëm, siguri i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të dobishme, të përgjegjëse dhe gjyqësorë në të gjitha nivelet. Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve joshkëmbues.
Ky indikator raportohet kur regjistrimi i profesionistëve të trajnuar/specializuar është kështu dhe është funksional.	Vjetore	Vjetore	Rritës	Direkt	Raportohet një herë kur regjistrimi kryhet.	Data/iti	Data/iti	Data/iti	Trend rritës	2021	0	2022	0	2023	0	2024	1	2025	1	2026	1	1	0	16, 16.a, 16.b Page, drejtësi dhe institucione të forta	Promovimi i shqiptive pagatore dhe gjyqësorë për zhvillim të qëndrueshëm, siguri i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të dobishme, të përgjegjëse dhe gjyqësorë në të gjitha nivelet. Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve joshkëmbues.
Metodologjia bazohet në evidencën në mënyrë manuale të ruajtur si profesionistëve të trajnuar/specializuar në ligjin me drejtësi mëqësore për femijet. Kjo do të bazohet në ligjvencat e përcaktuara në çdo program trajnimi.	Vjetore	Vjetore	Rritës	Direkt	Shumatore e të gjithë profesionistëve të trajnuar/specializuar. Të dhënat konsolidohen bazuar në forma unike të ndodhjes së dhënave të cilat do të hartohen gjatë implementimit/aportimit të strategjisë.	Profesioni	Specializim/ trajnimi	Temat trajnimit/specializimit	Trend rritës	2021	Nuk ka të dhëna për 2021	2022	20% më shumë se bazelini	2023	30% më shumë se bazelini	2024	40% më shumë se bazelini	2025	50% më shumë se bazelini	2026	80% më shumë se bazelini	80% më shumë se bazelini	Sa është ruajtur i profesionalitetit të 2021?	16, 16.a, 16.b Page, drejtësi dhe institucione të forta	Promovimi i shqiptive pagatore dhe gjyqësorë për zhvillim të qëndrueshëm, siguri i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të dobishme, të përgjegjëse dhe gjyqësorë në të gjitha nivelet. Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve joshkëmbues.
Indikatorët raportohen i përmbluar kur të mirat në prokurori dhe në dhomat penale, civile të gjykatave sipas hartës gjyqësore dhe janë funksionale. Kjo do të thotë që në këto seksione janë emëruar prokurorët dhe gjyqtarët të specializuar të drejtësi për femijet, si dhe në secilin nga këto gjykata janë trajnuar mjekësues gjyqtarë në çështjet penale, civile, familjare dhe administrative ku femija meren parasysh vendimmarrja e tyre ndikon në femijë.	Vjetore	Vjetore	Rritës	Direkt	Shumatore e seksioneve për të mirat funksionale.	Prokurori/Gjykatë	Qarku	Viti i krijimit	Trend rritës	2021	39 seksione të ndara në 22 gjykata mëri dhe 6 apeli dhe 11 prokurori	2022		2023		2024		2025		2026			16, 16.a, 16.b Page, drejtësi dhe institucione të forta	Promovimi i shqiptive pagatore dhe gjyqësorë për zhvillim të qëndrueshëm, siguri i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të dobishme, të përgjegjëse dhe gjyqësorë në të gjitha nivelet. Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promovimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve joshkëmbues.	
Indikatorët raportohen i përmbluar kur të pakten 2 staf i MD janë emëruar në krah të plotë dhe që në mënyrë të dedikuar meren me çështjet që lidhen me femijet, koordinimin institucionel për zbatimin e Strategjisë së Drejtësi për të Mirat 2022-2030 dhe gjenerimin e statistikave për të	Vjetore	Vjetore	Rritës	Direkt	Shumatore e stafit të emëruar.	Gjinia	Data/iti	Data/iti	Trend rritës	2021	0	2022	0	2023	2	2024	2	2025	2	2026	2	2	0	16, 16.a, 16.b Page, drejtësi dhe institucione të forta	Promovimi i shqiptive pagatore dhe gjyqësorë për zhvillim të qëndrueshëm, siguri i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të dobishme, të përgjegjëse dhe gjyqësorë në të gjitha nivelet. Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin



Indikator raporton çdo raport statistikor të prodhuar nga burime të ndryshme si ato të gjeneruara nga Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mirat, ato të prodhuara manualisht nga çështjet civile, administrative, familjare, Gjyqësorë indikator raporton edhe ato raporte specifike të cilat publikohen çdo vit nga KSHVAT.	Vjetore	Vjetore	Ritës	Direkt	Shumatore e raporteve statistike prodhuara.	Loji i raportit	Data e prodhimit	Te dhëna të publikuara/ jo të publikuara	Trend ritës	2021	0	2022	0	2023	30 raporte	2024	50 raporte	2025	60 raporte	2026	80 raporte	80 raporte	0	16, 16.a, 16.b Pajp, detyrues dhe institucione të forta	ndërkombëtar, për krijimin e kapaciteteve në të gjitha rrethet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin. Promonimi dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve jodiskriminuese.
---	---------	---------	-------	--------	---	-----------------	------------------	--	-------------	------	---	------	---	------	------------	------	------------	------	------------	------	------------	------------	---	---	---

Lista e indikatorëve/treguesve të dokumenteve strategjike

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	
	Lloji i indikatorit	Kombëtar i indikatorit	Lloji me të Drejtësi në SHK	Qëllimi/Qëllimet të Strategjisë së SHK	Qëllimi i Politikës	Objektivi strategjik në të Drejtësi në SHK	Burimet të dhënash për monitorimin e performancës	Institucionet përgjegjëse për monitorimin e performancës	Monitorimi i Metodikës	Frekuenca e Matjes	Natura e Indikatorit/Objektivi të Monitorimit	Indeksi dhe/ose Metrika	Formata e Strategjisë	Niveli i të dhënave (për treguesin e përzier)				Thëlbësori dhe/ose Niveli i të dhënave	Vlera e Referencës				Vlera e referencës				Vlera e referencës				Vlera e referencës					
1	Output	Përqendrimi në ligje të drejtësisë penale dhe ligje të drejtësisë civile	Demonstrimi i rezultateve të ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	1.3 Detyruesi i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Detyruesi i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Zgjedhja e ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	
2	Output	Përqendrimi në ligje të drejtësisë penale dhe ligje të drejtësisë civile	Demonstrimi i rezultateve të ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	1.3 Detyruesi i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Detyruesi i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Zgjedhja e ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	
3	Output	Përqendrimi në ligje të drejtësisë penale dhe ligje të drejtësisë civile	Demonstrimi i rezultateve të ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	1.3 Detyruesi i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Detyruesi i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Zgjedhja e ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	
4	Output	Niveli i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Demonstrimi i rezultateve të ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	1.3 Detyruesi i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Detyruesi i ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	Zgjedhja e ligjeve të drejtësisë penale dhe ligjeve të drejtësisë civile	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH	SHK, QKSH

[illegible]

Fletorja Zyrtare



Viti 2023 – Numri 13

[illegible]



URDHËR
Nr. 289, datë 29.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 99, DATË 25.5.2021, “PËR
MIRATIMIN E KATALOGUT
KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE
PROFESIONALE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë“, si dhe shkresës nr. 298, datë 28.8.2022, të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

URDHËROJ:

1. Miratimin e ndryshimeve në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale sipas shtojcës 1, të këtij urdhri.

2. Botimin e ndryshimeve të Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

Shtojca 1: Në Shtojcën 1 të Urdhrit nr. 99, dt. 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”, bëhën ndryshimet si më poshtë vijon:

NR	Varianti i mëparshëm i Kualifikimit Profesional JO ekzistues	Kodi i Kualifikimit Profesional	Emërtimi i kualifikimeve	Lloji i kualifikimit profesional	Profesionet LKP	Lidhja me Kodet e LKP/ISCO	Niveli në KSHK
1	A1-III-16	A1-III-22	Teknologji e përpunimit të brumërave	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor i përpunimit të brumërave	7512, 7513, 7514	3
2	B1-III-17	B1-III-21	Muratim dhe suvatim	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Murator, suvatues	7112 dhe 7123	3
3	B3-III-18	B3-III-22	Karpenieri, hekurkthim dhe betonim	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Karpenier	7115	3
4	C1-III-18	C1-III-22	Mobilieri/Tipicieri	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Mobilier/tapicier	752	3
5	E-II-17	E-II-21	Elektroteknikë	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Elektracist në objekte civile/industriale	741	2
6	E1-III-18	E1-III-21	Instalime elektrike civile dhe industriale	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Elektracist në objekte civile/industriale	741	3
7	E2-III-19	E2-III-21	Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët dhe tensionit të lartë	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Specialist për prodhimin e energjisë elektrike	741	3
8	E4-III-19	E4-III-22	Elektromekanikë	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Elektromekanik	741	3
9	F-II-17	F-II-22	Mekanikë	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Profesione të inxhinierisë mekanike	722	2
10	G-II-17	G-II-22	Hoteleri-Turizëm	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Profesione të hotelieri turizmit	9112	2
11	H-II-16	H-II-22	Bujësi	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Fermer	921	2
12	J1-III-16	J1-III-21	Peshkimi	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës peshkimi, gjathtarë dhe vendosës kurthesh	622	3
13	L-II-17	L-II-21	Ekonomi-Biznes	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Arkëtar, Kostoist	411/421	2
14		L1-V-22	Ndërmjetësimi i pasurive të paluajtshme	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Menaxherë dhe agjentë të pasurive të patundshme	3334	5
15	M-II-17	M-II-21	Shërbime mjeteve transporti	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Mekanik në automjete	723	2
16	M1-III-18	M1-III-22	Shërbime motori	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Motorist	7231	3
17	M2-III-18	M2-III-22	Shërbime shenerike	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Automekanik	7231	3
18	M3-III-18	M3-III-22	Shërbime elektro-auto	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor për sisteme elektrike/elektronike në automjete	7231	3
19	N-IV-17	N-IV-21	Veterinari	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Asistent veteriner	3240	4
20	O-IV-16	O-IV-21	Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	Program 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Asistent i punës sociale	3412	4
21	R-IV-17	R-IV-22	Gjeodezi	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Gjeodet i mesëm	3112.17	4
22	S-II-12	S-II-22	Pyje	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Përdorues makinerish pyjore	9215	2
23		V1-III-22	Instalime hidraulike	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Hidraulikë në banesa dhe ujësjellës	7126	3
24		V2-III-22	Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse	7127	3
25		V3-III-22	Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Hidraulikë në banesa dhe ujësjellës	7126	3



URDHËR
Nr. 291, datë 30.12.2022

organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

**PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË
STANDARDIT KOMBËTAR TË
KONTABILITETIT NR. 15, “PËR
KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN
FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE
EKONOMIKE” (SKK 15)**

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike (SKK 15)”.

2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

STANDARDI 15
PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE
EKONOMIKE
I PËRMIRËSUAR
(I ndryshuar)

Tiranë, ~~Janar 2022~~ dhjetor 2022

KËRKESAT BAZË TË DETYRUESHME PËR MIKRONJËSITË

13. Pasqyrat financiare të shkurtuara përgatiten paraqiten dhe publikohen të paktën një herë në vit.

DATA DHE RREGULLAT E HYRJES NË ZBATIM TË KËTIJ STANDARDI

60. Ky standard me ndryshimet përkatëse do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël, që fillon më ose pas datës 1 janar 2022. Ndryshimet e publikuara në prill 2022 ~~duhet do të zbatohet zbatohen~~ në mënyrë prospektive nga data 1 janar ~~2022~~2028, d.m.th pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese të vitit ~~2024~~2027, të cilat janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit. Ndryshimet e publikuara në dhjetor 2022 do të zbatohen nga data 1 janar 2028. Lejohet zbatimi i mëhershëm i ndryshimeve të publikuara në prill 2022 dhe dhjetor 2022 duke e shpjeguar arsyen në shënime shpjeguese.

**URDHËR****Nr. 13, datë 19.1.2023****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Dhimitër Kote nga data 20.1.2023 deri më datën 22.1.2023

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

4. Në ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ose personit që ushtron detyrat e tij në rast mungese. Zëvendësministri ndalohe të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Dhimitër Kote.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

VENDIM**Nr. 40, datë 22.12.2022****NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.12.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (S) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Stefanaq Panariti

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Ministrave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-288(64), datë 21.2.2022, të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 4, 11, 17, 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkesit Stefanaq Panariti, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 228, datë 29.2.2012, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Tiranë–Elbasan’” (VKM nr. 228/2012), bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” (ligji nr. 8561/1999), ka shpronësuar pasuritë e paluajtshme që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë–Elbasan, duke parashikuar edhe masën e shpërblimit të pronarëve të tyre. Një prej pasurive të paluajtshme të shpronësuar, me sipërfaqe 1200 m², në Farkë, Tiranë, e vlerësuar në shumën 3.146.598 lekë, i përkiste kërkesit Stefanaq Panariti. VKM-ja nr. 228/2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 46, datë 2.5.2012, ndërsa vetë kërkesi nuk rezulton të jetë njoftuar drejtpërdrejt individualisht për shpronësimin e pasurisë së tij.

2. Duke mos qenë dakord me masën e shpërblimit, kërkesi në datën 29.3.2013 ka paraqitur padi në gjykatë kundër Këshillit të Ministrave, ARRSH-së dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), me objekt anulimin e pjesshëm të VKM-së nr. 228/2012, duke kërkuar shpërblimin sipas vlerës së tregut, në masën 18.000.000 lekë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1485, datë 4.2.2014, ka shpallur moskompetencën lëndore dhe ia ka dërguar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së

Parë Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 3852, datë 7.7.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë së kërkesit, duke shfuqizuar pjesërisht VKM-në nr. 228/2012 dhe duke detyruar Këshillin e Ministrave dhe MTI-në ta shpërblejnë kërkesin sipas vlerës së përcaktuar në aktet nënligjore për hartën e vlerës dhe, pas zbritjes së shumës monetare të tërhequr prej tij, përfundimisht ta shpërblejnë në masën 10.053.402 lekë.

3. MTI-ja dhe Avokatura e Shtetit kanë paraqitur ankim, me argumentin se VKM-ja nr. 228/2012, në pjesën që parashikonte masën e shpërblimit, ishte bazuar në ligjin nr. 8561/1999 dhe në aktet nënligjore të nxjerra në bazë të tij. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1077, datë 11.5.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

4. Me pretendimin se vendimet e gjykatave ishin të pabazuara në ligj dhe në prova, si dhe metoda e ndjekur për rivlerësimin e pasurisë së shpronësuar ishte e gabuar, Avokatura e Shtetit ka paraqitur rekurs. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 422, datë 28.7.2016, bazuar në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka vendosur pranimin e kërkesës së MTI-së për pezullimin e ekzekutimit të vendimit deri në përfundimin e shqyrtimit të rekursit, duke konsideruar se rekursi i paraqitur nga Avokatura e Shtetit, në thelb, ishte rekurs i MTI-së. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-288(64), datë 21.2.2022, në dhomë këshillimi, ka shqyrtuar rekursin dhe ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të apelit, duke rrëzuar padinë e kërkesit, me arsyetimin se ishte paraqitur në gjykatë jashtë afatit ligjor.

5. Në datën 20.6.2022 kërkesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit përfundimtar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës në datën 15.7.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve.

6. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 504, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, ia ka kaluar MIE-së kompetencat e MTI-së. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi emrat e këtyre institucioneve janë



përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar:

7.1 *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1.1 *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë ka disponuar mbi afatin ligjor dhe parashkrimin e padisë, ndonëse ky shkak nuk është ngritur nga palët e paditura në asnjë nga shkallët e gjykimit dhe, për rrjedhojë, kërkuesit nuk i është krijuar mundësia të mbrohej. Gjykata e Lartë ka tejkaluar kufijtë e gjykimit, të përcaktuara në nenet 58 dhe 63, shkronjat “a” dhe “dh”, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), sepse nuk e ka gjykuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit, të cilat lidheshin vetëm me përcaktimin e vlerës së pronës.

7.1.2. *Parimi i sigurisë juridike*, i cili garanton besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara, pasi Gjykata e Lartë ka disponuar përtej përcaktimeve të nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 8561/1999 dhe nenit 328 të KPC-së, sipas të cilave momenti i lindjes së të drejtës së paraqitjes së padisë është ai i marrjes dijeni për aktin nëpërmjet njoftimit individual dhe jo ai i botimit në Fletoren Zyrtare.

7.1.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë në çështjen e tij ka arsyetuar ndryshe në dallim nga çështjet e tjera të ngjashme të shqyrtuara më parë, duke e vënë kërkuesin përballë dy standardeve të ndryshme gjykimi, në veçanti lidhur me qëndrimin e një prej anëtarëve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues edhe në një çështje të mëparshme, të zgjidhur ndryshe.

7.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar kërkuesit përfitimin e shpërblimit të drejtë për pasurinë e shpronësuar nga shteti.

8. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

8.1. Pretendimi *për cenimin e procesit të rregullt ligjor* është i pabazuar në aspektet e mëposhtme:

8.1.1. Lidhur me *të drejtën e aksesit*, kërkuesi është mjaftuar me parashtrimin e faktit dhe analizën e procedurave të ligjit nr. 8561/1999, që janë çështje që i përkasin juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe jo atij kushtetues. Arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk ka mangësi në këtë drejtim, pasi Kolegji Administrativ i saj ka krijuar praktikë të njësuar për momentin kohor në të cilin subjektet e shpronësuar për interes publik konsiderohen të njoftuara. Argumenti se Gjykata e Lartë ka disponuar në vendim çështje që nuk janë ngritur asnjëherë nga palët, është i paqartë, pasi, në referim të neneve 6 dhe 16 të KPC-së, është detyrë e çdo gjykate, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, të vlerësojë nëse padia është paraqitur brenda afateve procedurale dhe në rast të paraqitjes së saj përtej afatit, të vendosë rrëzimin e padisë.

8.1.2. Lidhur me *parimin e sigurisë juridike*, argumentet e kërkuesit nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë ligji, mund të vendosë për themelin e çështjes nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuar nga gjyqtari i faktit, kur konstaton se ligji është interpretuar në mënyrë të gabuar. Rrjedhimisht, parimi i sigurisë juridike nuk është cenuar, për sa kohë që VKM-ja nr. 228/2012 është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.5.2012 dhe kërkuesi e ka kundërshtuar atë në gjykatë afërsisht pas 10 muajve.

8.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës në aspektin e shpërblimit të drejtë* është i pabazuar, pasi prona është e llojit arë dhe vlera e saj është përlllogaritur në zbatim të ligjit nr. 8561/1999 dhe akteve nënligjore. Masa e shpërblimit për shpronësimin e një prone për interes publik jo domosdoshmërisht duhet të përmbushë interesat ekonomike më të lartë të subjektit të shpronësuar, por duhet të jetë e kënaqshme për standardet ekonomike dhe sociale në kohën e shpronësimit.

9. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka informuar me shkrim se ka të njëjtin qëndrim me Avokaturën e Shtetit.

10. **Subjektet e interesuara, MIE-ja dhe ARRSH-ja**, ndonëse u njoftuan rregullisht, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

12. Gjykata çmon se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar. Duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-288(64), datë 21.2.2022, që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor që ka vendosur për masën e shpërblimit të tij nga shpronësimi, ai ka përmbushur edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues është paraqitur në datën 20.6.2022, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuari ka pretenduar, ndër të tjera, se janë cenuar parimet e sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit, por ai nuk ka paraqitur argumente të qarta kushtetuese që lidhen me gjënë e gjykuar në një proces gjyqësor dhe me shkakun eventual të diskriminimit nga Gjykata e Lartë, krahasuar me mënyrën e zgjidhjes së një çështjeje tjetër të mëparshme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim në mënyrë autonome, por do të analizohen prej saj në kuadër të shqyrtimit të pretendimit për cenimin e së drejtës së procesit të rregullt ligjor në aspektin e aksesit në gjykatë. Kjo e drejtë së bashku me të drejtën e pronës garantohen respektivisht nga nenet 42 dhe 41 të Kushtetutës. Si të tilla, ato hyjnë në juridiksionin kushtetues, prandaj Gjykata në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë

14. Kërkuari, duke parashtruar se është shpronësuar për interes publik dhe se ka kundërshtuar në gjykatë masën e shpërblimit, ka ngritur pretendimin se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë, sepse ka vendosur rrezimin e padisë, pa shqyrtuar themelin e saj, duke verifikuar dhe vlerësuar të parashkruar të drejtën e padisë së tij për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka disponuar në kundërshtim me nenet 58 dhe 63, shkronjat “a” dhe “dh”, të ligjit nr. 49/2012, pasi nuk e ka gjykuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit, të cilat lidheshin vetëm me përcaktimin e vlerës së pasurisë.

15. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se Gjykata e Lartë, sipas një praktike tashmë të njësuar, ka arsyetuar me të drejtë se afati i padisë së kërkuarit fillonte ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe se ai e kishte humbur të drejtën e ankimit në gjykatë për masën e shpërblimit. Njoftimi individual i të shpronësuarit zbatohet në periudhën kohore nga miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave deri në botimin në Fletoren Zyrtare, që do të thotë se nëse gjatë kësaj periudhe i shpronësuari nuk ka marrë njoftim individual, atëherë ai prezumohet se është njoftuar me botimin e VKM-së në Fletoren Zyrtare. Për rrjedhojë, sipas këtij subjekti të interesuar, kërkuarit nuk i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë.

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ndërsa neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*) dhe lejon që ligji të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike (*pika 3*), të cilat lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (*pika 4*). Njëherazi kjo dispozitë e rregullon shprehimisht të drejtën e aksesit në gjykatë për individin e shpronësuar, duke parashikuar se për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankimi në gjykatë (*pika 5*).

17. Gjykata ka pohuar se me anë të shpronësimit një subjekt mund të privohet nga e drejta e pronësisë që ka në favor të një subjekti



tjetër përgjithësisht publik, por jo detyrimisht. Pra, shpronësimi mund të zërë vend edhe në dobi të personave private, i bërë mbi bazën e një politike të llogaritur për të arritur drejtësi shoqërore brenda komunitetit. Shpronësimi kërkohet të realizohet me “ligj” dhe “vetëm për interesa publike”. Ai është i lejueshëm “vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë” (shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Shpronësimi është një marrëdhënie midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyr një interes publik dhe ka të drejtë të ketë pretendime vetëm në lidhje me masën e shpërblimit (shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Gjithashtu, Gjykata është shprehur se e drejta e pronës private është e garantuar nëse në rastet e shpronësimit shteti merr përsipër të respektojë kufizimin në përmbushje të një interesi publik, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe në respektim të së drejtës së ankimit të individit të cenuar për masën e shpërblimit. Në këto raste, për sa i takon së drejtës së aksesit në gjykatë, neni 42 nuk konkurren me nenin 41, pika 5, të Kushtetutës (shih vendimin nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Gjykata ka theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (shih vendimet nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014; nr. 17, datë 19.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Në këtë kuptim, e drejta për t’u njoftuar dhe pjesëmarrja në proces është e lidhur me

vendimmarrjen, sidomos kur ajo ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit (shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016; nr. 68, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Nën dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se e drejta e individit të shpronësuar për të pasur akses në gjykatë, e cila është e parashikuar shprehimisht në nenin 41, pika 5, të Kushtetutës, është garanci specifike e së drejtës së pronës, kur kjo e fundit kufizohet nga shteti me anë të shpronësimit. Me anë të kësaj garancie procedurale të shpronësuarit i jepet mundësia të përmbushë edhe garancinë tjetër kushtetuese me natyrë materiale – atë të shpërblimit të drejtë. Thënë ndryshe, e drejta e aksesit lidhet nga pikëpamja organike dhe funksionale me shpërblimin e drejtë. Për ushtrimin efektiv të këtyre garancive kushtetuese merr rëndësi përcaktuese njoftimi efektiv i individit për vendimin e shpronësimit dhe rezultatin e tij në drejtim të masës së shpërblimit, pasi mungesa e njoftimit do ta vendoste atë në pamundësi për t’u mbrojtur në rast arbitrariteti për masën e shpërblimit për pasurinë e shpronësuar, sepse në thelb do t’i mohonte të shpronësuarit aksesin në gjykatë.

20. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se VKM-ja nr. 228/2012, me të cilën është shpronësuar kërkuesi nga pasuria e tij private, është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 2.5.2012, por nuk ka ndonjë të dhënë që t’i jetë njoftuar drejtpërdrejt kërkuesit nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin. Kërkuesi është ankuar në gjykatë për masën e shpërblimit nga shpronësimi dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së tij. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, me pretendimin se gjykatat nuk kishin vlerësuar në mënyrën e duhur faktet dhe provat, si dhe kishin zbatuar gabim ligjin lidhur me përcaktimin e vlerës së pasurisë së shpronësuar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin dhe ka arritur në përfundimin se ai përmbante shkaqe të parashikuara në ligj, duke vlerësuar në vijim se gjykatat më të ulëta nuk e kanë analizuar çështjen e afatit të ngritjes së padisë për kundërshtimin e aktit administrativ të shpronësimit, llogaritjen e tij në çështjen konkrete dhe tejkalimin



e këtij afati, me pasojë parashkrimin e së drejtës së padisë.

21. Gjykata konstaton se pretendimet dhe prapësimet e palëve lidhen me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka interpretuar dispozitat ligjore për llogaritjen e afatit, brenda të cilit i shpronësuarit ushtron të drejtën e ankimit në gjykatë për masën e shpërblimit nga shpronësimi sipas ligjit nr. 8561/1999. Duke iu referuar përmbajtjes së vendimit të kundërshtuar, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se parashikimi i ligjit nr. 8561/1999 për njoftimin e drejtpërdrejtë të të shpronësuarit nuk zhvlerëson ose përjashton efektet ligjore dhe prezumimin ligjor të marrjes dijeni të palëve të interesuara në momentin e botimit në Fletoren Zyrtare të VKM-së për shpronësim. Botimi në Fletoren Zyrtare është garancia maksimale që ligji ka vendosur për mbrojtjen e të drejtave të të shpronësuarve, pasi nëpërmjet botimit në Fletoren Zyrtare prezumohet njohja e vetë ligjit, për rrjedhojë edhe e akteve të tjera me rëndësi më të ulët ligjore, siç janë aktet individuale. Njoftimi individual gjen zbatim në periudhën e ndërmjetme midis momentit kur miratohet vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësim, i cili hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet me miratimin e tij, dhe momentit kur ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare. Gjykata e Lartë, duke konstatuar se VKM-ja nr. 228/2012 për shpronësimin është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.5.2012, ka vlerësuar se në këtë ditë ka filluar të ecë afati ligjor i paraqitjes së padisë. Si pasojë e këtij interpretimi, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se padia e paraqitur nga kërkuesi ishte jashtë afatit ligjor dhe, për këtë shkak, ka vendosur rrëzimin e padisë së tij pa i dhënë përgjigje përfundimtare pretendimit për masën e shpërblimit nga shpronësimi, duke ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta që kishin shqyrtuar themelin e pretendimeve dhe i kishin pranuar pjesërisht ato.

22. Për sa më lart, Gjykata pranon se, në përputhje me parimin themelor të sigurisë juridike, e drejta e aksesit në gjykatë e individit të shpronësuar është e kufizuar nga afati ligjor brenda të cilit duhet të paraqitet padia. Për rrjedhojë, ajo në vijim do të vlerësojë nga pikëpamja kushtetuese nëse interpretimi i ligjit për mënyrën e njoftimit dhe llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë në çështjen konkrete ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të

kërkuesit për masën e shpërblimit të drejtë nga shpronësimi.

23. Gjykata në jurisprudencë të vazhdueshme ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Megjithatë, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në këtë drejtim, Gjykata ka evidentuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata vëren se, në zbatim të rezervës absolute të nenit 41 të Kushtetutës, rastet, procedurat e shpronësimit dhe detyrat e organeve publike janë parashikuar në ligjin nr. 8561/1999. Sipas këtij ligji dhe në zbatim të garancive kushtetuese, kufizimi i pronës private në formën e shpronësimit kryhet nga autoritetet publike vetëm për interesa publikë dhe realizohet përmes një procesi formal, i cili fillon në rrugë administrative dhe përmbyllet në gjykatë, me rezultatin e shpërblimit të drejtë të të shpronësuarit. Në procesin e shpronësimit, i cili në vetvete e zhvesh individin nga e drejta e pronës, interesi publik mbizotëron ndaj së drejtës kushtetuese individuale të pronës private dhe nga pikëpamja substanciale individit ka akses në gjykatë për masën e



shpërblimit. Në këtë situatë është e qartë që akses i gjykatë i të shpronësuarit duhet të garantojë në nivelin e duhur ushtrimin e të drejtave të tij, si mjeti i vetëm me anë të të cilit ai mund të mbrohet në rast arbitrariteti të ndërhyrjes shtetërore, si dhe për të siguruar që kjo ndërhyrje në të drejtën e pronës private të jetë proporcionale.

26. Në procedurën administrative të shpronësimit, ligji nr. 8561/1999 i ka dhënë të shpronësuarit një sërë të drejtash dhe privilegjes, ku listohet edhe e drejta e njoftimit të drejtpërdrejtë dhe individual të tij (*neni 6*), njoftim i cili realizohet qoftë për kërkesën e shpronësimit (*neni 14*), ashtu edhe për vendimin e shpronësimit (*neni 24*). Njoftimi i drejtpërdrejtë individual i të shpronësuarit nuk është mënyrë e njëjtë veprimi me atë të publikimit të kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, pasi ky i fundit synon të krijojë mundësinë për mbrojtjen e të drejtave edhe të interesave të personave të tretë ndaj ose për shkak të pasurisë private që shpronësohet (*neni 15, pika 1*). Kjo diferencë konfirmohet edhe nga rregullat për trajtimin e konflikteve gjyqësore dhe paraqitjen e pretendimeve, ku sërish flitet për njoftim dhe publikim, duke iu referuar me radhë pronarit dhe personave të tretë (*neni 16, pika 3*). Po kështu, kur rregullon ankimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin, ligji sërish urdhëron njoftimin e drejtpërdrejtë të të shpronësuarit dhe të personave të tretë (*neni 24*).

27. Gjykata vëren se nën të njëjtën logjikë janë hartuar edhe rregullat e përgjithshme të njoftimit në procedurën administrative sipas Kodit të Procedurave Administrative (*nenet 147-163*), të cilat synojnë efektivitetin e njoftimit, mbrojtjen ligjore të interesave të individit, transparencën dhe koston. Në mënyrë të përmbledhur, sipas këtij kodi, përveçse kur parashikohet ndryshe, organi publik e njofton individin personalisht, në vendin ku ndodhet individi ose në vendin ku ai ka njoftuar se e pret njoftimin, si dhe me mjete dhe mënyra të caktuara shprehimisht në ligji. Është e vërtetë se një nga mënyrat e njoftimit të individit sipas këtij kodi është edhe ai publik, sikundër edhe njoftimi përmes botimit zyrtar, por këto mënyra njoftimi janë përjashtime nga rregulli, të cilat zbatohen vetëm në rrethana specifike. Kështu, njoftimi publik zbatohet kur palët janë të panjohura, kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur në një nga vendet ku individi mund të

gjendet (vendbanim, vendqëndrim, vend i punës, vend i ushtrimit të veprimtarisë), kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme ose e pamundur, si dhe në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji. Kurse botimi zyrtar zbatohet kur njoftimi i drejtohet një grupi personash, anëtarët e të cilit janë ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, nëse çdo formë tjetër njoftimi vlerësohet si e pamundur ose e papërshtatshme, si dhe kur një mënyrë e tillë njoftimi është e detyrueshme sipas ligjit.

28. Duke iu rikthyer ligjit nr. 8561/1999, Gjykata vëren se ai nuk ka përcaktuar shprehimisht njoftimin e të shpronësuarit përmes botimit zyrtar, edhe pse parashikon se vendimi i Këshillit të Ministrave hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare (*neni 21, pika 5*). Ky parashikim duket se është në linjë me rregullin e përgjithshëm për botimin e akteve individuale të këtij organi sipas ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” (*neni 29, pika 3*). Ky rregull i shërben transparencës së veprimtarisë shtetërore dhe së drejtës kushtetuese të qytetarëve për informim në kushtet kur sipas nenit 100, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesorë të politikës së përgjithshme shtetërore dhe i zhvillon mbledhjet e tij të mbyllura.

29. Për sa më sipër, Gjykata rithekson se për sa i takon njoftimit të akteve publike të shpronësimit, institucionet shtetërore të përfshira në procesin e shpronësimit duhet të tregojnë kujdes të shtuar dhe duhet të interpretojnë e zbatojnë dispozitat ligjore në atë mënyrë që t'i garantojnë individit garancitë kushtetuese të parashikuara në nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 29, datë 1.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Me fjalë të tjera, në procedurën e shpronësimit, për shkak se e drejta kushtetuese e pronës preket, në funksion të garantimit të aksesit në gjykatë, organet publike kanë detyrimin të realizojnë një njoftim të rregullt efektiv të individit, me qëllim që ai të ketë mundësinë e mbrojtjes për vlerën e pronës në procesin administrativ, përfshirë edhe atë të mbrojtjes gjyqësore në rast të ushtrimit të së drejtës së ankimit për masën e shpërblimit. Për të njëjtat arsye, është e rëndësishme që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kur shqyrtojnë ankime për vlerën e pasurisë së shpronësuar, të verifikojnë realizimin e njoftimit nga organet



publike, për t'i dhënë peshën e duhur vlerës dhe pasojës juridike të tij në drejtim të aksesit të individit në gjykatë, si garanci e posaçme kushtetuese në procedurën e shpronësimit. Një vlerësim i ndryshëm nuk do të garantonte ekuilibrin e drejtë mes të drejtave kushtetuese relevante në një proces shpronësimi, duke krijuar barrë të tepruar mbi individin në favor të shtetit.

30. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata çmon se për sa i përket llogaritjes së afatit të paraqitjes së padisë në gjykatë për shpërblimin nga shpronësimi, Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj ka vënë theksin në njoftimin e aktit të shpronësimit nëpërmjet botimit të tij në Fletoren Zyrtare, duke zbehur vlerën juridike dhe pasojat që shkakton njoftimi i drejtpërdrejtë individual i tij tek i shpronësuar.

31. Përveç sa më sipër, kërkuesi, duke cituar dy vendime gjyqësore të viteve 2011 dhe 2017, ka pretenduar se Gjykata e Lartë ndër vite ka shqyrtuar çështje për masën e shpërblimit të shpronësimit, në të cilat e ka interpretuar ndryshe ligjin nr. 8561/1999 lidhur me llogaritjen e afatit të paraqitjes së ankimit në gjykatë. Sipas tij, për mënyrën e njoftimit dhe llogaritjen e afatit nuk ka pasur ndonjë pretendim nga palët e paditura përgjatë gjithë procesit, për rrjedhojë atij nuk i ishte krijuar mundësia të mbrohej.

32. Për këtë pretendim, subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, duke cituar vetëm një vendim gjyqësor të vitit 2021, që nuk lidhet me procedurat e shpronësimit, ka prapësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë tashmë ka krijuar praktikë të njëzuar për momentin kohor në të cilin subjektet e shpronësuara për interes publik konsiderohen të njoftuara. Sipas këtij subjekti të interesuar nuk qëndron as argumenti i kërkuarit se Gjykata e Lartë ka disponuar për çështje që nuk janë ngritur asnjëherë nga palët, pasi, në referim të neneve 6 dhe 16 të KPC-së, është detyrë e çdo gjykate, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, të vlerësojë nëse padia është paraqitur brenda afateve procedurale dhe në rast të paraqitjes përtej afatit, të vendosë rrëzimin e saj.

33. Gjykata vëren se në çdo fazë dhe shkallë të procesit gjyqësor, asnjë prej palëve ndërgjyqëse nuk ka ngritur pretendime për mënyrën e njoftimit të kërkuarit, llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë në gjykatë dhe mundësinë e parashkrimit të saj. Po kështu, gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë

shqyrtuar pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat, në thelb, lidheshin me vlerën e pasurisë së shpronësuar dhe llojin e zërit kadastral të saj, që do të thotë se njoftimi, afati dhe parashkrimi i padisë nuk janë bërë objekt i debatit gjyqësor dhe as pjesë e vlerësimit të vendimeve gjyqësore. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim me nismën e vet dhe për herë të parë për palët ndërgjyqëse në proces çështjet e afatit të ngritjes së padisë për kundërshtimin e aktit administrativ të shpronësimit, llogaritjen e tij në çështjen konkrete dhe tejkalimin e tij, me pasojë parashkrimin e së drejtës së padisë.

34. Në këtë kontekst faktesh, Gjykata eidenton se sipas nenit 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtrësive të tyre për çështjet e ligjit. Në këto raste, sipas nenit 482/a, pika 1, shkronja “b”, të po këtij kodi, parashikohet se Gjykata e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

35. Në këtë kuptim, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, duke qenë se e ka shqyrtuar çështjen në lidhje me një shkak që nuk është ngritur në rekurs, për të cilin gjykatat më të ulëta nuk janë shprehur, dhe që ka të bëjë me një kuptim të ri të interpretimit të ligjit nr. 8561/1999, për mënyrën e njoftimit të procedurës së shpronësimit, për të garantuar aksesin e individit në gjykatë, duhej të dëgjonte paraprakisht, qoftë edhe me shkrim, palët ndërgjyqëse në proces.

36. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, për shkak të interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, është i bazuar dhe vendimi i saj duhet të shfuqizohet.

37. Në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi ka cenuar procesin e rregullt ligjor në aspektin e aksesit në gjykatë, Gjykata vlerëson të mos të ndalet në analizimin e pretendimit tjetër të kërkuarit për cenimin e së drejtës së pronësisë, për sa kohë që çështja do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë.



38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues i kërkuesit, sipas arsytimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-288(64), datë 21.2.2022, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 22.12.2022.

Shpallur, më 20.1.2023.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska

VENDIM

Nr. 1, datë 18.1.2023

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME, PËR ARKIVAT JO NË VEPRIM, SI DHE PËR INSTITUCIONET QË ADMINISTROJNË DOKUMENTE TË TIPOLOGJISË, OSE QË RUAJNË DOKUMENTACION GJITHNJË PRANË TYRE

Mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 14, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, në nenin 4/1, si dhe në shkronjat “ë” dhe “P”, të pikës 5, të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, për

miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Arkivave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e listës së institucioneve që administrojnë dokumente të tipologjisë, që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autoritetet publike, mund të përdorin kuti dhe dosje me përmasa të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë vendim, vetëm nëse kanë marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet e përmendura në këtë vendim për zbatimin e tij.

5. Vendimi nr. 3, datë 8.2.2021, “Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme, si dhe listës së institucioneve dhe tipologjisë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I ARKIVAVE
Ardit Bido



SHTOJCA 1

STANDARDET E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME, PËR ARKIVAT JO NË VEPRIM, SI DHE PËR INSTITUCIONET QË ADMINISTROJNË DOKUMENTE TË TIPOLOGJISË, OSE QË RUAJNË DOKUMENTACION GJITHNJË PRANË TYRE

Lloji	Përmasat	Specifikimet teknike
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	Kutia: - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramatur 620 g/m² që të lejojë valzueshmërinë. - Faqet anësore të jenë me dy shtresa kartoni (fortësi të dyfishtë), ndërsa faqet e tjera me një shtresë kartoni. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar).
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	- Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm. Dosja: - Kartoni të jetë 330 g/m², me 2 krahë të brenda shkruar të palosura, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar).
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40x70x9	- Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e dosjes duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kutisë. - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm.
Dosje për ruajtje të përhershme	36x24	

Bashkëngjitur skicat me përmasat e kutive dhe dosjeve me ruajtje të përhershme.

SHTOJCA 2

LISTA E INSTITUCIONEVE QË ADMINISTROJNË DOKUMENTE TË TIPOLOGJISË, QË JANË TË DETYRUARA TË ZBATOJNË STANDARDIN E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME

1. Arkivat shtetërorë, të sistemimit, të tipologjisë dhe institucionet e pavarura Kushtetuese, që sipas ligjit i ruajnë dokumentet përherë pranë tyre.

2. Institucionet shtetërore qendrore e të varësisë që administrojnë dokumente të tipologjisë, si më poshtë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (regjistra të gjendjes civile; regjistra të lindjes dhe vdekjes; regjistra për martesat dhe zgjidhje të martesave etj.);

b) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (Kartoteka);

c) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (dosjet me dokumentacion tërësor, për patentat, licencat, mbrojtjen e të drejtës së autorit që ruhen mbi 50 vjet);

d) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (dosjet e lejeve të drejtimit, qarkullimit dhe mjeteve të transportit që ruhen mbi 50 vjet, regjistra etj.);

e) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (regjistra të subjekteve tatim-pagues që ruhen mbi 50 vjet);

f) Instituti i Sigurimeve Shoqërore (librat e pagave, bordero etj.);

g) Agjencia Shtetërore e Kadastrës (dokumente për regjistrimin, shqyrtimin dhe verifikimin e pasurive të paluajtshme që ruhen mbi 50 vjet, regjistra etj.);


h) Spitalet Universitare dhe Rajonale (kartelat shëndetësore që ruhen mbi 50 vjet);

i) Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Parauniversitar (regjistrat e amzave, librat e indekseve etj.);

j) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (për marrëveshjet ndërkombëtare).


3. Institucionet e tjera që ruajnë e administrojnë dokumente tipologjike mbi 50 vjet, i kërkojnë Këshillit të Lartë të Arkivave, përfshirjen në këtë vendim.

Modeli 1: Dimensione perfundimtare 40x28x18 cm






Modeli 2: Dimensione perfundimtare 40x55x18 cm






Modeli 3: Dimensione perfundimtare 40x70x9 cm





Dosja: 36x24 cm



**BIBLIOGRAFIA**

Nr. 268, datë 18.1.2023

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË DREJTORINË E
SHËRBIMEVE QEVERTARE**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar; në VKM-në nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror (KDZH) në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare ka deklasifikuar informacionet e klasifikuara “Konfidencial”, si më poshtë:

a) Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dokumenti me shkresën përcjellëse nr. 11/10 prot., datë 2.12.2019, “Projekt i Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31”, me nivel klasifikimi “Konfidencial”, në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, dhe të vendimi të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, neni 4, germa “a”.

2. Arsytet për deklasifikimin e dokumentit të sipërcituar, si më poshtë vijon:

Referuar shkresës së ardhur nga Ministria e Kulturës me nr. 4904, datë 7.11.2022, “Propozim për bashkëpunim në fushën e kulturës”.

Interesi që ky dokument të deklasifikohet diktohet nga interesa të tjerë të ndryshëm në krahasim me nevojën për të mbajtur dokumentin të klasifikuar.

Në vijim dhe të shkresës së sipërcituar të ardhur nga Ministria e Kulturës, grupet e punës kanë zhvilluar takime të njëpasnjëshme, duke analizuar prioritetet dhe objektivat afatgjatë në mbështetje të programeve kulturore, të cilat do t'i ofrohen një publiku më të gjerë dhe që duhet të zhvillohen në ambientet e Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31.

Interesi për të ridimensionuar/rinovuar ambiente të Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31, në funksion të organizimeve dhe promovimeve të ndryshme artistike, kulturore etj., nga studiues

vendës dhe të huaj, prevalon dhe është në funksion të përmirësimit dhe të zhvillimit të politikave favorizuese në fushën e krijimtarisë artistike për vendin tonë.

Implementimi i zbatimit të projektit në ridimensionimin e ambienteve të Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31, ka për qëllim të ruajë karakterin e saj ceremonial, por njëkohësisht të jetë edhe i hapur për publikun.

Duke qenë se, dokumenti “Projekti i Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31”, i klasifikuar “Konfidencial”, përbën një element të rëndësishëm për zhvillimin e procedurës së hapur të prokurimit publik, me objekt: “Rikonstruksioni i Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31”, ai duhet të deklasifikohet.

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në web të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe në mënyra të tjera, ndërsa një kopje t'i dërgohet zyrtarisht DSIK-së.

DREJTOR

Dhurata Frashëri

VENDIM

Nr. 2, datë 10.1.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“SUNPOWER 2017” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw,
NË POVELÇË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2023, mbasi



shqyrtoi relacionin me nr. 27 prot., datë 6.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Sunpower 2017’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 322, datë 12.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, QARKU Fier, për arsye të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 2013/1, datë 15.12.2022, u njoftua shoqëria për këtë vendimmarrje dhe iu bë me dije dokumentacioni i kërkuar. Po ashtu në këtë shkresë ERE ka informuar shoqërinë, se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të rregullores së licencimit, në rast se do të aplikonte, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurës, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Në përgjigje të shkresës se ERE-s shoqëria, me e-mail-in e datës 30.12.2022, protokolluar në ERE me nr. 2013/2, datë 30.12.2022, ka përcjellë dokumentacionin që lidhet me aplikimin.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A të Rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të Rregullores, për pikën 1.1, germet “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germet “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germet “a”, “b” dhe “c” për pikën 2.1, germet “a”, “b”, “c”. “d”, “e” dhe “f”

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se mungon pjesërisht dokumentacioni si vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për vitin 2019. Gjithashtu, në kuadër të mbështetjes financiare për financimin e projektit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës referuar vlerës së investimit të përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe parashikimeve për mënyrën e financimit (vlerën që disponon në llogari bankare subjekti, ose nëse mbështetja do jetë me kredi bankare të bëhet me dije nëse janë realizuar hapa konkretë në aplikim të kësaj të fundit).

- Shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. duhet të informojë ERE-n mbi arsyet pse parashikon që operimi i veprës do të fillojë 4 muaj (1.5.2024) pas ndërtimit të saj (viti 2023).

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Për dokumentacionin e kërkuar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se, nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 3, datë 10.1.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN
AVENUE” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2 mw, NË POVELÇË,
BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të

“Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 27/1 prot., datë 6.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Sun Avenue’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në Povelçë, Bashkia Fier”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 321, datë 12.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, për arsye të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 1770/3 prot., datë 25.10.2022, u njoftua shoqëria për këtë vendimmarrje dhe iu bë me dije dokumentacioni i munguar. Po ashtu, në këtë shkresë, ERE ka informuar shoqërinë, se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të rregullores së licencimit, në rast se do të aplikonte, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Në përgjigje të shkresës së ERE-s, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2014/2 prot., datë 15.12.2022, ka përcjellë dokumentacionin që lidhet me aplikimin.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar;



si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A të Rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, germa “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germa “a”, “b” dhe “c” për pikën 2.1, germa “a”, “b”, “c”. “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se mungon një pjesë e dokumentacionit si vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

- Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Germa “c”: Nuk rezulton që shoqëria të ketë depozituar dokumentacion në kuadër të mbështetjes financiare, ndaj vlerësohet që pas fillimit të procedurës t’i kërkohej të depozitojë në ERE dokumentacionin vërtetues të aftësisë financiare të realizimit të projektit, referuar përcaktimeve të planit të biznesit, ku parashikohet që investimi do të bëhet 30% me financim të ortakëve dhe 70% me kredi bankare.

- Shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k. duhet të informojë ERE-n mbi arsyet pse parashikon që operimi i veprës do të fillojë 4 muaj (1.5.2024) pas ndërtimit të saj (viti 2023).

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga se nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik rezulton se jetëgjatësia e

prishme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 5, datë 16.1.2023

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUJIN DHJETOR 2022, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të



ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 41/1 prot., datë 11.1.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 16 prot., datë 4.1.2023, protokolluar me tonën me nr. 41 prot., datë 9.1.2023, shoqëria FSHU sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, për muajin dhjetor 2022, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Nga aplikimi i shoqërisë rezulton se çmimi i propozuar për muajin dhjetor 2022 për këtë kategori klientësh është 30.67 lekë/kWh, ku përpos elementeve të çmimit të njohur nga “Metodologjia e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, shoqëria ka përfshirë sërish kostot e disbalancave.

- Në lidhje me kërkesën e shoqërisë për përfshirjen e kostove të disbalancave në përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, me shkresën nr. 2030/1 prot., datë 14.12.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë FSHU sh.a., ku ndër të tjera sqaron, se: Në kuptim të nenit 6, pikës 3 dhe pikës 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori.

- Shoqërisë iu kërkuar që në aplikimet e ardhshme të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja të përfshijë vetëm komponentët përbërës të tij, sikurse përcaktohet në nenin 8 të metodologjisë, sikurse përcaktohet në metodologji, kostot e imbalancave (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca) do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e rregullave të tregut dhe

akteve të tjera në fuqi. Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, kostot e disbalancave nuk njihen si komponent i përlogaritjes së çmimit të FMF-së.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 74, datë 13.4.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike nga shoqëria FSHU sh.a. për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022, janë njohur në vlerën 1.06 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, do të jetë 1.55 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2022, përlogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin dhjetor 2022		
	Njësia	Çmimi
CBEt rruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	26.34
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.79
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		30.59

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezultojnë se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të



furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 30.59 lekë/kwh për muajin dhjetor 2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin dhjetor 2022, prej 30.59 lekësh/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 6, datë 16.1.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 417, SERIA T18, SË SHOQËRISË “RENRGY TRADING GROUP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, si dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit

19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1/1 prot., datë 12.1.2023, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 417, seria T18, të shoqërisë ‘ReNRGY Trading Group’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 163, datë 19.7.2018”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1 prot., datë 4.1.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, përcaktohet se, paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 417, seria T18, është 19.7.2023).

Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 4.1.2023, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar; aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Neni 16, germa “a”. Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1.

- Neni 9, pika 1, germa “a”, plotësuar.

- Neni 16, germa “b”, plotësuar.

- Neni 16, germa “c”, plotësuar.

- Në këtë aplikim konstatohet mungesa e dokumentacionit/informacionit si vijon:

- Neni 16, germa “a”. Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1.



- Neni 9, pika , germa “b”. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE të dhënat sipas kërkesave respektive të formatit të ri të aplikimit.

- Neni 9, pika, germa “c”. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE të dhënat sipas kërkesave respektive të formatit të ri të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 417, seria T18, të shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 20.7.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 7, datë 16.1.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 167, DATË 28.6.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SALILLARI ENERGY TRADE’ SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94 prot., datë 12.1.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 167, datë 28.6.2022, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 209, datë 17.8.2022, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar, shoqëria të informojë ERE-n mbi implementimin konkret të sistemit IT.

3. Shfuqizuar.

4. Shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për disponimin e zyrave, brenda datës 1.3.2023.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 469/8 prot., datë 30.6.2022.

- Me dokumentacionin e depozituar me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/10 prot., datë 10.10.2022, nr. 469/12 prot., datë 30.11.2022, dhe nr. 469/14 prot., datë 6.1.2023, shoqëria ka plotësuar kushtet e vendosura në



pikën 2 dhe pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 167/2022, i ndryshuar, ndaj si të tilla këto kushte vlerësohet të shfuqizohen.

- Duke qenë se me shfuqizimin e pikave 2 dhe 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 167/2022, i ndryshuar, dhe me plotësimin e të gjitha kushteve të këtij vendimi nuk gjen më zbatim as pika 5 e këtij vendimi, vlerësohet edhe shfuqizimi i saj.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2, pikën 4 dhe pikën 5, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45/2015, ‘Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë’, të ndryshuar”, botuar në Fletore Zyrtare nr. 154, datë 17.11.2022, f.18649, bëhet korrigjimi i gabimit material, si më poshtë:

- Pika 2 e nenit 7 të ligjit:

Ishte:

2. Pas fjalës “procese politike” vendoset shprehja “apo dëshmitar i akuzës në proceset politike”; hiqet presja pas fjalës “politike të posaçme”, vendoset presje dhe më pas shtohet fjala “apo denoncues”.

Bëhet:

2. Pas togfjalëshit “procese politike”, fjalët “denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike, të posaçme;”, zëvendësohen me fjalët “dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, apo denoncues;”.

- Pika 2 e nenit 8:

Ishte:

2. Në pikën 2, togfjalëshi “nga mbarimi i afatit” zëvendësohet me togfjalëshin “nga konstatimi i mbarimit të afatit”.

Bëhet:

2. Në pikën 2, togfjalëshi “nga mbarimi i mandatit” zëvendësohet nga togfjalëshi “nga konstatimi i mbarimit të mandatit”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 512 lekë